

GAZETA SHQIPTARE



Kryeredaktor: Erl MURATI
Zv/kryeredaktore - Rezarta DELISULA
Tel:(04)2359-104, Fax:(04) 2359-116 E-mail:gazetashqiptare@hotmail.com



Viti XXIII - Nr. 7344 E diel 5 Nëntor 2017 Çmimi, 50 lekë (1.5 euro)

Opinion

Ditës

105 vjet shtet shqiptar e ne ende vuajmë nga kompleksi i ditës së parë të shtetbërjes. Edi Rama madje e zyrtarizoi këtë sëmundje të rëndë kolektive që ne kemi, ...
Vijon në faqen 21

Nga ARIAN GALDINI

Revolucioni i ndritur ose zgjimi i madh kombëtar



Dje

në "Deutsche Welle"

Nga BARBARA WESEL

Pozicionin solemn nga ai qesharak dihet që i ndan vetëm një hap. Dje duke tundur flamujt në barrikatad e Barcelonës, sot shitës patatesh të skuqura ...
Vijon në faqen 22

Të arratisesh nga Katalonia



Prokuroria, hetim për pastrim parash
Verifikim pasurisë së familjarëve të Qazim Sejdit dhe për 65 njerëz biznesi

Elbasan, kërkesa në Drejtorinë e Tatimeve: Duam informacion për çdo aktivitet tregtar

Prokuroria ka nisur një superhetim për pastrim parash ndaj familjeve kryesore të Elbasanit, ndër të cilat përfshihen edhe afërm të kryebashkiakut Qazim Sejdi. Bëhet fjalë për familje e persona që janë pronarë të bizneseve të ndryshme me miliona euro xhiro e fitime. Prokuroria e Elbasanit ...
Në faqen 7

MANUALI I INSTITUTIT TE SIGURIMEVE, PROCEDURA PER KONTRIBUTIN VULLNETAR

SI MERRET PENSIONI KUR S'KENI VITET E SIGURIMIT

Pagesat dhe përfitimet sipas kategorive për të vetëpunësuarit. Sigurimi vullnetar, si mund të blini vitet e punës me 5 mijë lekë në muaj



(Në foto) Instituti i Sigurimeve Shoqërore

PROVOKIMI

"Hakmarrja" greke për ndërtime në Himarë, bllokun 3 pikat kufitare

Në faqen 4

LISTA E FUNDIT

Të përndjekurit, emrat e 3 mijë trashëgimtarëve që dëmshpërblehen

Në faqet 10-11

OPERACIONI

Sekuestrohen 1.3 tonë hashash, burrë e grua në pranga në Tiranë

Në faqen 6

EMIGRANTET

Propozimi i Majkos: Vota me postë kushton 25 dollarë

Në faqen 5

ANALIZA E KOMUNIZMIT

MILANO

Korrespondenca me Nina Bogdanoviçin që shkruante nga Beogradi në vitin 1951



Kadare: Kishim reputacion të keq, por s'kemi qenë antisemitë

Në faqen 12

Letrat e dashurisë të gruas serbe për Martin Camajn

Në brendësi: Shpëtim Çuçka për Dritëroin, shqipërim proverbash nga Namik Dokle

Nga ARBEN NDRECA

Këto letra i drejtoheshin Martin Camajt në vitin 1951 prej një vajze të re prej Beogradit, e cila po atë vit do të bahej edhe grueja e tij. Bahet fjalë për Nina Bogdanoviçin, e lindun në vitin 1924 në Beograd, në familjen e Do-



broslavit dhe Dragës. I jati ishte avokat dhe nënkryetar i bashkisë së qytetit në vitet 1933-34. Nina mbasi kishte studjue për dy semestra sllavistikë (rusisht, çekisht e serbisht) në universitetin Karlova të Pragës, detyrohet me u kthye në atdhe ...
Suplement

ÇESHTJA "TAHIRI" REAGIMET

Akuza PS-PD, kreu demokrat: 800 mijë eurot janë të ish-ministrit

Basha: Biznesmeni e Tahiri, bashkë jashtë shtetit. Balla: Je bërë si prokuror

Alibeaj: Prokuroria të veprojë menjëherë

Darina Tanushi

Partia Demokratike deklaroj dje, se 800 mijë eurot e gjetura në makinën e shtetasit O.S janë të ish-ministrit Saimir Tahiri. Kryetari i PD-së, Lulzim Basha denoncoi dje, edhe faktin se mjeti lundruer që posedonte Tahiri u zhvendos nga porti i Durrësit më 19 tetor, dy ditë pasi dolën përgjimet e Habilajve. Por, pas këtij reagimi të kreu të PD-së, reagoi kreu i Grupit Parlamentar të PS-së, Taulant Balla, i cili i sugjeroi kreu të PD-së të flasë për kryebashkiakun e dënuar për vjedhje dhe të mos bëjë prokurorin. "Burime të sigurta informojnë se: 1. E gjithë shuma prej 800 mijë eurosh është e Saimir Tahirit, ashtu si dy patentat për drejtimit mjeteve lundrimi të tonazhit 20 deri 100 tonë. 2. Njëri prej këtyre mjeteve lundruese u zhvendos nga porti i Durrësit më 19 tetor, dy ditë pasi dolën përgjimet e Habilajve.

3. O.S. ka mohuar njohjen me Tahirin, ndërkohë që rezultoni se me këtë makinë kanë lëvizur disa herë jashtë shtetit bashkë", u shpreh dje, Basha. Sipas tij, "Me urdhër të Çakos dhe Fatmir Xhafes dhe me porosi të Edi Ramës është fshehur nga njoftimi paraprak i policisë, shuma e parave dhe kapja e dy lejeve të drejtimit për mjete lundruese 20 dhe 100 tonë, në emër të Saimir Tahirit." Më vonë reagoi edhe deputeti i PD-së, Enkelejd Alibeaj. Sipas tij, të dhënat e ndalimit të shtetasit O.S. u fshehën me urdhër të Edi Ramës. "Vetëm pas tre ditësh, dhe pas denoncimit të kryetarit të opozitës, policia u detyrua të pranojë publikisht shumën prej 863 mijë euro, bashkë me dy patentat e lundrimit të Saimir Tahirit. 25-vjeçarit O.S. ka deklaruar se 863 mijë euro i duheshin për të blerë hekur të "Kurum". Por ky version ka rënë poshtë, sepse "Kurum" nuk pranon para cash, e në veçanti jo për sasi të tilla, që do të blinin të paktën 70 kamionë të mëdhenj me hekur. Ndërkohë, kompania e 25-vjeçarit Sota dhe e babait të tij, nuk i justifikojnë me dokumente këto para", u shpreh Alibeaj. "Atëherë, të kujt janë 863 mijë euro? Pse Edi Rama, Fatmir Xhafaj dhe Haki Çako urdhëruan policinë t'i fshehtë të dhënat nga komunikata? Të gjitha rrethanat tregojnë se këto para i përkasin të njëjtit person që i përkasin edhe patentat e lundrimit. Janë të Saimir Tahirit.

863 mijë eurot dhe patentat e lundrimit, janë pikë-



Kreu i PD-së, Lulzim Basha

Kreu i Grupit Parlamentar të PS-së, Taulant Balla

Kreu i Grupit të LSI-së: Pse heshti MB për 863 mijë eurot?

Vasili: Policia fshehu ngjarjen në mënyrë të turpshme dhe mafioze

Kryetari i Grupit Parlamentar të LSI-së, Petrit Vasili ngriti dyshimin se përse Ministria e Brendshme heshti për ditë me radhë për 863 mijë eurot që iu gjetën shtetasit O.S. në një makinë, pak ditë më parë. "Pse heshti(!)..... për ditë të tëra Ministria e Brendshme për 863 mijë eurot? Banditizmi u shfaq sheshit me 863 mijë euro të pista nëpër makina, shtatë patentat e ish-ministrit etj....", shkroi dje, në një status në rrjetin social, "Facebook", Vasili. Sipas tij, "Ngjarja u fsheh në mënyrë të turpshme dhe mafioze për ditë të tëra nga policia. Ministria e Brendshme heshti. Është palë! Apo mbron pushte-



Kryetari i Grupit Parlamentar të LSI-së, Petrit Vasili

tin e kryeministrit dhe ish-ministrit është duke shkelur ligjin? Ka presion që të mos flasë? Do vazhdojë të bashkëjetojë me këtë polici të kapur kokë e këmbë nga krimi? Duke mos folur a mos ndihmon të fshehin provat?", ngriti dje, pyetjet kreu i Grupit Parlamentar të LSI-së, Petrit Vasili. "Përgjigja e qartë dhe me veprime të for-

REAGIMI I PS

Akuzave të kreu të opozitës Basha në lidhje me sekuestrimin e 800 mijë eurove nga policia në Elbasan, sekretari i Përgjithshëm i Partisë Socialiste, Taulant Balla, thotë se kreu demokrat prej tri ditësh nuk flet për krye-

SPARTAK NGJELA

"Kudo ku ka ligj dhe normalitet, ky kryeministër duhej të kishte rënë. Kryeministri Rama nuk ka rënë deri tani, sepse po pret të krijojë gënjeshtër. Por, a do ta krijojë dot? Unë ju thashë para disa ditësh: Nuk ka një çështje "Tahiri", por ka një çështje "Rama" - tha dje, avokati i njohur.

Sali Berisha: Tahiri, plan për t'u arratisur me miratimin e Ramës

Ish-kryeministri, Sali Berisha deklaroi dje, se në bazë të denoncimeve që i kishin ardhur nga "qytetari dixhital", Tahiri kishte bërë në plan të arratisjes nga Shqipëria. "Saimir Trafiku me miratimin e Ramës po përgatit arratisjen! Oficeri dixhital denoncon: Saimir Trafiku me miratim të Ramës kishte bërë plan të arratisjes nga vendi! Paratë që u gjetën në makinën e O.S. janë të Saimir Trafikut. O.S. i ka marrë paratë dhe patentat me porosi të Saimirit në kasafortën e jahtit të tij. Jahti luksoz i Saimir Trafikut është dhuratë që Habilajt i bënë atij beharin që kaloi", citon Berisha "qytetarin dixhital". Sipas këtij denoncimi, ndaj patentat ndodhen aty, sepse ai e dërgoi me nxitim se mos ja gjenin në jahtin e tij prokurorët. "Në fakt, prokuroria ka rënë në erë që Saimir Tahiri përveç gomones posedon dhe një jaht tjetër luksoz. Prandaj ka dy patenta, një për gomonen që nuk peshon më shumë se 20 tonë, dhe një për jahtin që është diku të 50-60 tonë", citon qytetari.



Pasaportat e Saimir Tahirit që u gjetën nga policia

Denoncimi, Këlliçi: Sota pa përvojë, fitoi tenderin 1 mld lekë dy muaj më parë

Kreu i FRPD-së Belind Këlliçi tha dje, se "O.S. pa asnjë eksperiencë në biznesin e tij, ia doli të fitojë tenderin mbi 1 miliard lekë vetëm dy muaj më parë". Sipas tij, S. është i njohur për lidhjet e veçanta dhe me kryeministrin Edi Rama. "Kjo lidhje i ka mundësuar kompanisë së O.S. të përfitojë ndonëse pa asnjë eksperiencë dhe një tender prej 1 miliard e 106 milion lekësh me datë 05.09.2017 nga OSHEE sh.a Vlorë për: "Ndërtim fidieri i ri, N/St Mifol, për zonën Novoselë - Akërnë - Bishan si dhe rrjetet TU me ABC". Kompania nuk ka në bilancin e saj asnjë punë dhe asnjë aktivitet tjetër përveç këtij tenderi", tha Këlliçi. "ECO CONSTRUCTION & PARTNERS sh.p.k është themeluar më 16.02.2015 në 100% pronësi të shtetasit O.S. Deri më 13.12.2016 shoqëria quhej IKONA CONSTRUCTION sh.p.k dhe më pas ka ndryshuar emrin në ECO CONSTRUCTION & PARTNERS sh.p.k, serish në pronësi 100% të shtetasit O.S., bëri me dije Këlliçi.

si për këtë", -tha dje, Balla. Sipas tij, "Kryetari i Partisë së Agron Kapllanajt flet edhe 10 herë në ditë për të tjerët, për krimin dhe të inkriminuarit, por ka 3 ditë që nuk flet për të dënuarin për "vjedhje", të cilin Basha e mbrojti duke shkelur ligjin në KQZ".



TIRANË - Pas akuzave të opozitës në lidhje me arrestimin e biznesmenit me 800 mijë euro cash dhe 2 patenta të ish-ministrit të Brendshëm, ka ardhur edhe reagimi nga uniformat blu. Policia e Shtetit shpreh keqardhjen për akuzat politike dhe i quan ato pa asnjë bazë ligjore apo faktike, mbi ndalimin e shtetasit O.S. "Policia e Shtetit rithekson se ka kryer detyrën dhe respektuar procedurën ligjore pikë për pikë. Pretendimet e opozitës janë spekulime politike dhe s'kanë asnjë lidhje me të vërtetën e punës së bërë. Policia e Shtetit ka ndaluar në flagrancë autorin, ka mbajtur të plotë procesverbalin në vendngjarje dhe ia ka përcjellë menjëherë prokurorisë dosjen e plotë të rastit për arrestin në flagrancë", thuhet në deklaratë. Më tej Policia e Shtetit i siguron të gjithë qytetarët se ajo ka bërë

"Spekulime politike, dosjen ia dërguam prokurorisë"

Opozita e akuzon për fshehje informacioni, reagon policia: Zbatuam procedurën ligjore



DEKLARATA E QATOS

Drejtori i komanduar i policisë së Elbasanit, Altin Qato ka reaguar ndaj sulmeve të opozitës ndaj policisë lidhur me arrestimin e biznesmenit 25-vjeçar O.S. Qato theksoi se policia nuk ka fshehur provat. "Shqetësimi mediatik për Orest Sota është i ekzagjeruar. Në mjetin e Sotës u gjetën para dhe patentat e Tahirit. Janë sekuestruar provat materiale. Të gjitha materialet janë dërguar në prokurori, policia nuk ka fshehur asgjë. Për çdo veprim është vënë në dijeni edhe prokurori i çështjes", -ka thënë Qato.

detyrën, po bën detyrën dhe do të bëjë detyrën e saj, pa asnjë ndikim politik në luftën me krimin e organizuar, krimin ekonomik e çdo lloj tjetër kriminaliteti. "Pas përmbylljes me sukses të plotë të luftës për çrënjosjen

e kanabisit nga territori i vendit, Policia e Shtetit ka hyrë në fazën e dytë të kësaj lufte, e cila do të përkrahë zotëzuesit e pasurisë. Edhe arrestimi sot (dje) i një rrjeti trafikantësh në Tiranë e tregon qartë vullnetin e Poli-

cisë së Shtetit, për të goditur rrjetet dhe elementet kriminale që janë përfshirë në trafikje, si edhe sekuestruar asetet financiare të përfituara nga aktiviteti kriminal", citohet në deklaratën në fjalë.

Gjykata lë në burg 25-vjeçarin për akuzat: "Mosbindje ndaj urdhrit të policisë" dhe "Fshehje të të ardhurave"

"Nuk e njoh personalisht Tahirin, eurot janë të mia"

Biznesmeni O.S.: Do bëja një pagesë për blerje hekuri te kompania "Kurum"

ELBASAN

Eurot që u gjetën në makinë janë të mia. Do bëja një pagesë për blerje hekuri pranë kompanisë "Kurum". Saimir Tahiri nuk e njoh personalisht, por thjeshtë si ish-ministër dhe deputet. Patentat e Tahirit dhe gruas së tij mund të jenë lënë në automjet nga shoferi i Saimir Tahirit, me të cilin kam miqësi". Kështu ka deklaruar gjatë marrjes në pyetje nga prokuroria biznesmeni nga Vlora, O.S., i cili u arrestua tri ditë më parë në rrugën nacionale Elbasan-Peqin në fshatin Balldren duke drejtuar automjetin pa leje drejtimi. Në makinë, 25-vjeçarit iu gjetën 843 mijë euro dhe dy patenta për drejtimin e mjeteve lundruese në emër të ish-ministrit të Brendshëm, Saimir Tahiri dhe një të bashkëshortes së këtij të fundit. Ndërkaq, dje Gjykata e Shkallës së Parë e Elbasanit vendosi masën e sigurisë arrest me burg pa afat. Masa e arrestit u dha



GJURMËT E GISHTAVE

Lidhur me hetimin për arrestimin e biznesmenit me 863 mijë euro dhe dy patentat të ish-ministrit Saimir Tahiri, burime pranë prokurorisë së Elbasanit janë shprehur për "Top Channel" se policia ka bërë vetë numërimin e parave, duke shtuar gjurmët e gishtave që mund të identifikoheshin në kartëmonedhat e sekuestruara. Hetimi për paratë e gjetura pritet t'i kalojë Prokurorisë së Krimeve të Rënda sepse prokuroria e Elbasanit nuk ka kompetencën për të zhvilluar hetimin pasuror ndaj të riut dhe për të verifikuar mënyrën se si ka gjeneruar 863 mijë euro kesh të pashoqërur me asnjë faturë apo mandat.

mëngjesin e djeshëm nga gjyqtarja Miranda Konica, e cila e ka vlerësuar të ligjshëm urdhrin e ndalimit të prokurorisë. I riu, i cili u kap në flagrancë akuzohet për tri vepra penale dhe

konkretisht: "Drejtim mjete në mënyrë të parregullt"; "Mosbindje ndaj urdhrit të policisë" dhe "Fshehje të të ardhurave". Mësohet se, për shkak të shkeljeve të vazhdueshme të rregullave të

qarkullimit rrugor, biznesmenit O.S. i ishte hequr leja e drejtimit. Gjithashtu, me urdhrë të prokurorisë është vendosur sekuestro e shumës prej 843 mijë euro, pasi biznesmeni nuk justifi-

fikon burimin e të ardhurave dhe destinacionin e tyre.

DËSHMIA NË GJYQ E BIZNESMIT

Ndonëse gjykata e Elbasanit pranoi kërkesën e prokurorisë dhe e la në burg deri në sqarimin e gjithë ngjarjes, biznesmeni O.S., ashtu si në momentin pas arrestimit, e ka justifikuar shumën e 843 mijë eurove si pagesë që duhet të bënte për blerje hekuri pranë kompanisë "Kurum". Ndërsa, për dy patentat në emër të Saimir Tahirit, ai tha se: "Ato mund të jenë lënë aty nga shoferi i Tahirit, me të cilin kam miqësi". I riu ka mohuar të ketë lidhje me Saimir Tahirin, ndërsa ka theksuar se thjesht e njihte si ministër dhe deputet. Për llogari të hetimit është marrë edhe dëshmia e babait të tij, L.S., i cili ka konfirmuar thënie të të birit. Ka bërë deklarimeve prokuroria ka nisur dhe një hetim pasuror për këtë rast, pasi me ligjin shqiptar nuk lejohet që pagesa me kështu lloj shifrash të bëhen jashtë sistemit ban-

kar. Hetimi për paratë e gjetura, pritet t'i kalojë Prokurorisë së Krimeve të Rënda, sepse prokuroria e Elbasanit nuk ka kompetencën për të zhvilluar hetimin pasuror ndaj të riut dhe për të verifikuar mënyrën se si ka gjeneruar 863 mijë euro cash të pashoqërur me asnjë faturë apo mandat.

ARRESTIMI

25-vjeçari O.S. u arrestua të mërkurën. Policia ka deklaruar zyrtarisht se arrestimi i tij është bërë, pasi më datë 1 nëntor, në rrugën nacionale, në fshatin Balldren, u kap duke drejtuar pa leje drejtimin mjeteve "Land Rover". Ndërsa nga kontrolli në mjet, iu gjetën e bllokuan një sasi e madhe eurosh, i cili pretendonte se do t'i përdorte për likuidimin e faturave, por të pashoqërura me dokumentin e origjinës. Megjithatë, në një hetim zyrtar policia nuk e përmend shumën e eurove të sekuestruara dhe as patentat në emrin e ish-ministrit të Brendshëm Saimir Tahiri.

Përmbasuesi gjyqësor Genti Bushati nxjerr për shitje në ankand pasurine :
a) Tokë are e regjistruar në regjistrin hipotekor me nr pasurie 11122, volumn 5, Faqe 27, ne zonen kadastrale nr 1898, me sipërfaqe totale 5990 m², e ndodhur ne adresen Gur i Zi Shkoder
b) Tokë are e regjistruar ne regjistrin hipotekor me nr pasurie 11454, volumn 7, Faqe 48, ne zonen kadastrale nr 1898, me sipërfaqe totale 3492 m², e ndodhur ne adresen Gur i Zi Shkoder
1. Cmimi me të cilin do të fillojë shitja ne ankand eshte ne masen sic caktojme me poshte
a) për pasurine "Tokë Are" me sip 5990 m², eshte ne vleren 1,920,000 leke
b) Për pasurine "Tokë Are" me sip 3492 m², eshte ne vleren 1,400,000 leke
Shitja e pasurise do te behet (zhvillohet) me date 14.11.2017 ora 16.16 ne Zyren e permbasuesit gjyqësor Genti Bushati me adrese Rruga Don Bosko, Perballë Gjykatës së rethit Gjyqësor Shkoder. Personat e interesuar duhet te dorëdhin perpara fillimit te ankandit 10 % te vleres si garanci ne Tirana Bank me nr IBAN AL74 2065 1017 0000 6003 1383 9100.

Përmbasuesi gjyqësor Genti Bushati nxjerr për shitje në ankand pasurine :
"Apartament" me sip 127.7 m², e regjistruar ne regjistrin hipotekor me nr 82 date 02.06.2011 me volumn 5 faqe 108 me nr pasurie 16130-1-8, ne Zonen Kadastrale 8597 me adrese, lagja "Pazari", Shkoder
2. Cmimi me të cilin do të fillojë shitja ne Ankand për pasurine e sipërshkruar, eshte ne vleren 3,124,800 (tre mijë e njëqinda e njëzetatë mijë e tetëqinda) leke .
Shitja e pasurise do te behet (zhvillohet) me date 15.11.2017 ora 16.16 ne Zyren e permbasuesit gjyqësor Genti Bushati me adrese Rruga Don Bosko, Perballë Gjykatës së rethit Gjyqësor Shkoder. Personat e interesuar duhet te dorëdhin perpara fillimit te ankandit 10 % te vleres si garanci ne Bankon BKT dëga Shkoder me nr llogarie 41064051, ose ne Tirane Bank me nr IBAN AL74 2065 1017 0000 6003 1383 9100 .

Përmbasuesi gjyqësor Genti Bushati nxjerr për shitje në ankand pasurine :
a) Tokë are e regjistruar ne regjistrin hipotekor me nr pasurie 582/1, volumn 10, Faqe 248, ne zonen kadastrale nr 1100, me sipërfaqe totale 3230 m², e ndodhur ne adresen Barbullush Shkoder
b) Tokë are e regjistruar ne regjistrin hipotekor me nr pasurie 523/1, volumn 9, Faqe 3, ne zonen kadastrale nr 1100, me sipërfaqe totale 42360 m², e ndodhur ne adresen Barbullush Shkoder
1. Cmimi me të cilin do të fillojë shitja ne ankand eshte ne masen sic caktojme me poshte
a) për pasurine "Tokë Are" me sip 3230 m², eshte ne vleren 697,680 leke
b) Për pasurine "Tokë Are" me sip 2360 m², eshte ne vleren 509,760 leke
Shitja e pasurise do te behet (zhvillohet) me date 08.11.2017 ora 16.16 ne Zyren e permbasuesit gjyqësor Genti Bushati me adrese Rruga Don Bosko, Perballë Gjykatës së rethit Gjyqësor Shkoder. Personat e interesuar duhet te dorëdhin perpara fillimit te ankandit 10 % te vleres si garanci ne Tirana Bank me nr IBAN AL74 2065 1017 0000 6003 1383 9100.

KUFIRI ME GREQINE BLLOKIMI

Probleme në sistemin kompjuterik, qytetarët: Hakmarrje ndaj "Himarës"

Blokohet për 14 orë kalimi në 3 pika me Greqinë, Bushati flet me Kotzias

Ministri i Jashtëm: Të jemi të duruar. Situata jo e qëllimshme

Një defekt në serverin qendror të policisë greke ka ndërprerë punën në pikat e kalimit kufitar të Kakavijës, Kapshiticës dhe Qafë Botës për orë të tëra. Lëvizja u zhblllokua rreth orës 14:00 të ditës së djeshme, pas 14 orësh bllokimi dhe pas ndërhyrjes së ministrit të Jashtëm Ditmir Bushati, i cili kontaktoi me homologun grek Nikos Kotzias. Pika e kalimit Kakavijë në Gjirokastër bllokoj punën mbrëmjen e së premtes, ndërsa ajo e Kapshiticës në orë të para të mëngjesit të kësaj të shtune.

Në këtë situatë, në të dy pikat kufitare u lejuan të hyjnë në territorin grek vetëm shtetasit me pasaportë greke dhe të vendeve të tjera të Bashkimit Evropian, sipas policisë kufitare. Kështu që qindra udhëtarë u detyruan ta kalojnë natën në radhë dhe në pritje. Rradhë të gjata u krijuan edhe në pikën kufitare të Kapshiticës në Korçë. Qytetarët e konsideruan këtë situatë "hakmarrje" për çështjen e Himarës. Nga ana e saj, Ministria e Jashtëm sqaroi se sistemi kompjuterik i bllokua për shkaqe teknike, gjë që ndodhi në të gjitha pikat e kalimit kufitar të Greqisë, përfshirë edhe ato me Maqedoninë dhe Turqinë. Vetë ministri Ditmir Bushati shkoi në Kakavijë për të parë situatën. Ai siguroi se ngjarja nuk ishte e qëllimshme, pasi pati një komunikim intensiv me homologun e tij grek, Nikos Kotzias, dhe me ministrin e Brendshëm grek, Nikos Toskas, mbi zgjidhjen e situatës në pikat kufitare me Greqinë. "Ka një rënie të sistemit Shengen që prek pikat kufitare që ka Greqia me Shqipërinë, Maqedoninë dhe Turqinë, e kemi të verifikuar këtë gjë edhe me pikat e tjera", tha Bushati. Për shkak të problematikës me rënien e sistemit në të gjithë Greqinë, mes ministrit Bushati dhe ministrit Toskas u ra dakord që të nisë lëvizja, duke mundësuar skanimin e pasaportave. Ndërkohë, përfaqësuesi i



Ministri i Jashtëm Ditmir Bushati dhe ministrja e Kulturës Mirela Kumbaro dje në Kakavijë

Qytetarja-Kumbaros: Mos më prek me dorë edhe pse je ministre

Ministrja e Kulturës Mirela Kumbaro edhe si deputete e zonës u përball dje me qytetarët e bllokuar në Kakavijë. Por jo gjithçka ka shkuar mirë. Mes Kumbaros dhe një qytetareje ka patur edhe një incident. Ministria duke parë humbjen e durimit të qytetares, e cila kishte orë të tëra që priste në radhë për të kaluar pikën kufitare, kur ministrja është përpjekur ta qetësojë i ka thënë të mos ta prekte me dorë. "Mos më prek me dorë, nuk të lejoj të më prekësh me dorë, nuk po më respekton, po më prek me dorë, nuk të lejoj të më prekësh ti mua me dorë, dëgjovje? Le të jesh ministre mos më prek me dorë se nuk ke ti më shumë kulturë se unë. Nga bishti i fundit i kavallit je", -i është drejtuar qytetarja ministres Kumbaro.



MEPJ-së, Glevin Dervishi ishte vet në pikën e kalimit kufitar të Kakavijës, kur njoftoi arritjen e zgjidhjes provizore. "Ju konfirmojmë edhe nga burimet tona se është një problem sistemi në të gjitha anët ku Greqia ka hyrje-dalje me zonat jo 'Schengen', pra edhe me Maqedoninë dhe Turqinë. Megjithatë kemi arritur të gjejmë një zgjidhje provizore. Që nga ky moment ka filluar lëvizja. Ju mund të vazhdoni në pikën e kalimit kufitar do të mbahen shënim pasaportat tuaja, do të regjistrohen e më pas kur

sistemi të fillojë me kapacitet të plotë, ato do të regjistrohen. Kjo është një zgjidhje teknike gjatë kësaj periudhe, derisa të marrë një zgjidhje përfundimtare", është shprehur Glevin Dervishi.

TAKIMI
Nisur nga apeli i qytetarëve, ministri i Jashtëm Ditmir Bushati ka shkuar në Kakavijë ku është takuar me qytetarët bashkë me ministrin Mirela Kumbaro. Qytetarët të indinjuar kanë rrethuar ministrin Bushati duke i kërkuar llogari për situatën. Ata kanë deklaruar

QYTETARI AMERIKAN

Mes qytetarëve të bllokuar në pikën e kalimit kufitar të Kakavijës është edhe një shqiptaro-amerikan. Ai u shpreh se nuk është lejuar nga autoritetet greke që të udhëtojë në drejtim të Greqisë për një rast vdekjeje, pavarësisht se ka qenë i pajisur me pasaportë amerikane.



Rradhë e gjata dje në Kakavijë

BUSHATI NË DERVIÇAN

Ministri i Jashtëm Ditmir Bushati dhe ministrja Mirela Kumbaro u pritën dje, në Dervican me parrulla në gjuhën greke. Shkak është bërë prishja e disa ndërtimeve të banorëve të Himarës, një çështje e bërë së fundmi 'mollë shëri' mes Shqipërisë dhe Greqisë, por edhe fokusi i debatit të parlamentit në seancën e fundit. "Rama-Bushati jo në ligjet e shtetit grek"; "Mbështetje për Himarën", -shkruhet në parullat e vendosura në ballë të kinemasë së zonës.

Policia: Sistemi kompjuterik, i bllokuar edhe me Maqedoninë, Turqinë dhe Bullgarinë

Policia e Shtetit bëri një sqarim në lidhje me situatën e krijuar në Pikat e Kalimit Kufitar për në Greqi. Sipas saj, Policia Kufitare ka komunikuar në mënyrë të vazhdueshme me policinë kufitare greke, ku nga komunikimi me autoritetet policore greke, rezultoi se që prej mbrëmjes së djeshme, sistemi kompjuterik i palës greke ka shfaqur probleme teknike deri në bllokimin e plotë të tij. "Sistemi kompjuterik është bllokuar për shkaqe teknike, jo vetëm në kufirin me Shqipërinë, por edhe me shtetet e tjera si me Maqedoninë, Turqinë dhe Bullgarinë. Për këtë arsye shtetasit që nuk kanë dokument udhëtimi të një vendi të BE-së e kanë të pamundur të kalojnë deri në rregullimin e defektit në sistemin. Policia Kufitare ka mbajtur kontakt të pandërprerë me policinë greke, ku është marrë përgjigje se po punohet për rregullimin sa më shpejt të sistemit", -thuhet në reagimin e policisë. Policia Kufitare kërkoi mirëkuptimin e qytetarëve dhe të drejtuesve të mjeteve që të mos dynden në pikat e kalimit duke krijuar radhë e konfuzion.



ar se duhet të ishin njoftuar që prej ditës së djeshme dhe të mos prisnin sot gjithë ditën. Nga ana tjetër, Bushati iu ka kërkuar të bëjnë durim. "Nuk dua të bëj avokatin e askujt. Pala greke ka thënë se ka rënë sistemi. Duhet të kuptojmë dhe të tregohemi të duruar. Nuk besoj se situata është e qëllimshme", -iu ka thënë Bushati qytetarëve. Në këtë takim me qytetarët ishte edhe konsulli shqiptar në

Janinë, Pervin Gjukuria, i cili tha se shkak për këtë problem është bërë rënia e sistemit të kontrollit të pasaportave të Greqisë. Sipas konsullit Gjukuria, kjo situatë është me të gjitha pikat kufitare dhe jo vetëm në Kakavijë. "Komunikimi me zyrat nga ana greke është se ka rënë sistemi me Shqipërinë për të gjitha pikat kufitare. Na vjen keq për situatën, po punojmë për ta zgjidhur", -tha ai.

Poeti i njohur: Qeveria ime fle gjumë, greku tallet me ne

Pjesë e qytetarëve që kanë pritur me orë të tëra në Kakavijë ka qenë dje, edhe poeti e publicisti Agim Doçi, i cili shprehu indinjatën për mos reagimin e shtetit shqiptar. "Po sensibilizoj qeverinë time që po fle gjumë, policia jonë ka vënë vula, po ato janë vula me patate të pjekura. S'ka stimul, vullnet e adrenalinë për t'u përballur me retorikën e Athinës, janë politikuajt, jo politikanë, njëri kishite 24 orë që priste, i kishite fëmijët pa bukë", -tha Doçi në një komunikim me "News 24". Ai e konsideroi fyes vendimin e palës shqiptare që vijon të lejojë kalimin e rregullt të shtetasve grekë, në një kohë që shqiptarët penalizohen. "Sa të duash ka lëvizje nga Greqia në Shqipëri. Agjencitë tona turistike kujt i shërbejnë? Do rri këtu deri sa t'i teket grekut, ose se deri sa këta tanët të vendosin t'ju mbyllin traun. Ne jemi 13 autobusë që presim këtu...kjo s'është normale. Më ndjeni për tonin e zërit se jam malësor, unë s'mund të flas me zë të tredhur, por greku po tallet me ne", -tha ai.

Sekretari i PD: Stinë protestash

Ristani: Kjo qeveri krimi vështirë të rrëzohet në rrugë demokratike

Sekretari i Përgjithshëm i Partisë Demokratike, Arben Ristani i ftuar dje, në emisionin "Kjo javë" në "News 24" tregoi me detaje analizën që do të nisë forca më e madhe opozitare për të kuptuar pse u humbën zgjedhjet parlamentare. Ai foli për një stinë protestash, ndërsa argumentoi se një gjë e tillë do ndodhë pasi të merren garancitë nga strukturat. "Bashkë me analizën do testojmë gatishmërinë e strukturave për të nisur një stinë protestash. Do nisë një stinë e fuqishme protestash që do i lërë në rutinë këto çështjet politike", tha ai. I pyetur se kur mund të nisnin konkretisht protestat, sekretari i Përgjithshëm i PD-së, shtoi se: "Pritet një organizim. Tashmë jemi në kushte më të vështira nga ç'ishim para zgjedhjeve. Tani po analizojmë situatën për gatishmërinë e strukturave". Ish-deputeti shtoi se, protestat janë e vetmja mënyrë për të rrëzuar qeverinë, që mori pushtetin me paratë e krimin dhe drogës, siç tha ai. "Kjo qeveri banditeske që kemi është e vështirë të rrëzohet me rrugë demokratike. Kur në pushtet ke një bandë krimi, që krahasohet me kartelet e drogës kolumbiane, vështirë se mund t'i rrëzosh nëpërmjet zgjedhjeve, se s'janë të lira e të ndershme", tha Ristani.



Ministri i Shtetit për Diasporën dorëzon dokumentin në Kuvend

Majko: Emigrantët të shprehin vetë dëshirën për të votuar

"25 USD, një votë me postë"

Darina Tanushi

Ministri i Shtetit për Diasporën, Pandeli Majko, ka depozituar pranë çdo anëtar të komisionit të reformës elektorale informacionin dhe opinionin për të drejtën e votimit të shtetasve jashtë kufijve të vendit. Në këtë material prej 27 faqesh bëhet një krahasim i metodave që mund të sigurojnë votimin e emigrantëve. "Eksperiencat e shumë vendeve kanë treguar se sa më të vështira e të ndërlikuar të jenë procedurat e regjistrimit për votuesit jashtë vendit, aq më e ulët është pjesëmarrja e tyre në votime. Për të garantuar mundësinë e votimit një numri sa më të madh shtetasish jashtë vendit do të duhet që procedurat e regjistrimit të jenë sa më të thjeshta, pa anashkaluar kriteret që nevojiten për sigurinë e procesit; thuhet në dokument. "Shteti shqiptar nuk disponon ende të dhëna të sakta për shtetasit e tij jashtë atdheut dhe vendbanimet e tyre. Në këtë proces është e nevojshme që këta shtetas të shprehin vetë dëshirën e tyre për të votuar: 1. duke bërë një kërkesë për këtë qëllim me



Ministri i Shtetit për Diasporën, Pandeli Majko

anë të postës 2. nëpërmjet postës elektronike duke iu drejtuar një strukturë të posaçme të krijuar pranë institucionit përgjegjës (pranë KQZ-së), cili do të merret me procesin e regjistrimit të votuesve. 3. duke paraqitur në misionet diplomatike të Shqipërisë kërkesën për t'u regjistruar, duhet t'i bashkëngjitet adresa postare dhe mundësisht një adresë email", sugjerohet në materialin që Majko ia ka paraqitur anëtarëve të komisionit të reformës zgjedhore. Në dokument sugjerohet edhe rrugët e votimit. "Për mundësimin e

votimit jashtë vendit mundësohen dy procedura votimi: 1) votimi i drejtpërdrejtë në qendra të posaçme votimi, 2) votimi me postë". Kostoja e votimit me postë është më e ulët se sa e votimit të drejtpërdrejtë. Nga vlerësimi i përparësive e kostos së votimit jashtë vendit me postë rezultojnë se ky proces do të kushtonte midis 20 - 25 dollarë për çdo "votues të jashtëm". Kostoja mund të ulët me rritjen e pjesëmarrjes së votuesve. Nëse kihet parasysh kontributi ekonomik që japin shtetasit jashtë vendit një kosto e tillë është e arsyeshme. Ajo bëhet e pranueshme nëse merret parasysh fakti se për zgjedhjet brenda territorit të Shqipërisë kostoja shkon rreth 22 dollarë për votues, thuhet në material. Sipas Majkos "Për çështjet e emigracionit dhe diasporës do të bashkëpunohet sidomos me shtetet fqinje. Do të ishte ironike që organizimi i shqiptarëve në diasporë të ndahej me kufijtë e shteteve ku ata jetojnë dhe nga vinë. E drejta e votës është një kërkesë që vjen nga qendra më të organizuara të emigracionit shqiptar në Greqi, Itali, Britani, Shtetet e Bashkuara të Amerikës, Gjermani, Zvicër, Belgjikë, Kanada e deri në Australi".

REQUEST FOR EXPRESSIONS OF INTEREST (CONSULTING COMPANY)

ALBANIA

CITIZEN - CENTRIC SERVICE DELIVERY PROJECT
Loan Agreement Project ID No. 8521

Assignment Title: **Advisory Support for the Validation of e-Services**

Ref. No. ALB-8521/CS/CQ/3.10.01

Under the Innovative Good Governance priority, the Program "Innovation against Corruption: Building a Citizen Centric Service Delivery Model in Albania" (ISDA), launched in April 2014 and led by the Minister of State of Innovation and Public Administration (MIPA), entails a multilayered reform that focuses on key administrative central government public services to reduce the time and burden for citizens and businesses and improve service delivery quality, transparency and efficiency by using innovative solutions and ICT.

As part of the reform, in October 2014, ADISA, the Agency for the Delivery of Integrated Services in Albania, was created by a Decision of the Council of the Ministers.

To support ISDA Program implementation, the Government of Albania has received key financing from the World Bank under the Citizen Centric Service Delivery (CCSD) Project.

The program aims to improve public service delivery in Albania through a citizen-centric model where central government public services will be provided in an integrated fashion. In terms of the face-to-face channel, the model of the service delivery includes (under ADISA's management) **citizen service centers** established in municipalities, with the largest to be established in Tirana, to offer centralized access to 300+ public services of 15+ public institutions in a single location. Results of key activities linked to the project development objective will be measured through five Disbursement Linked Indicators (DLIs).

DLI #1 (Number of online services with Level 3 automation) measures the number of transactional administrative services provided online with two-way communication, including e-payment and e-filing.

In this framework, ADISA is seeking to hire a qualified Consulting Firm experienced in validating the status of Level 3 (and Level 4) services, and in assessing e-Government programs and ICT implementation in the public sector, with a focus on e-Gov portal applications and online services (further on referred to as 'Consultant'). The Consultant will be responsible for:

- Reviewing and validating the status of online services provided through e-Albania Portal using the UN 2014 framework
- Assessing the performance of several key services through interactions with service providers (government institutions) and beneficiaries (citizens and/or businesses); and
- Reviewing the "e-Service registers" maintained by NAIS and ADISA, and providing a comparative analysis of key findings of this assessment and registry contents to suggest possible improvements.

The Project Management Unit now invite eligible "Consultant" to indicate their interest in providing the Services. Interested Consultants should provide information demonstrating that they have the required qualifications and relevant experience to perform the Services.

The Consultant team will consist of one **Team Leader**, who will also work as a key expert (e-Government Specialist and ICT Auditor) a **Key Expert**, and a **Legal Expert** to perform the activities highlighted in this ToR. The consulting firm will have the following qualifications:

1. At least seven (7) years of consulting experience with a focus on e-Government/ICT system design, implementation and assessments, and IT Audit assignments;
2. At least two (2) similar contracts successfully carried out within the last five years with certificates of satisfaction issued by the contracting authority;
3. In-depth knowledge and understanding of ICT and e-Government development issues;
4. Proven experience in the development of large ICT projects and design of e-Government architecture (including portals and online services);
5. Strong skills and knowledge of international standards and control frameworks (e.g., Cobit, ISO 27001/27002) and will be essential;
6. Experience in World Bank funded projects related to this assignment will be an advantage;
7. Fluency in English language, spoken and written (for all members of the team); and
8. Key staff with necessary qualifications and experience to successfully carry out all the tasks and deliverables of this assignment. These include but not limited to the following:

The **Team Leader** (e-Gov Specialist and ICT Auditor) shall possess the following qualifications:

1. Masters degree or demonstrated experience in informatics, engineering or related fields;
2. Minimum of ten (10) years professional experience;
3. Minimum of seven (7) years of experience in the design, implementation, and assessment of e-Gov portals for online service delivery (especially transactional and connected services) working with Government institutions;
4. At least five (5) years of experience of ICT Audit in corporate or public sector; and
5. ICT Audit qualification (Certified Information Systems Auditor or equivalent).

The **Key Expert** shall possess the following qualifications:

1. University degree in informatics, engineering, or related fields;
2. Minimum of five (5) years of experience in dealing with e-Gov portals for online service delivery (especially transactional and connected services) and assessment of service provider performance and citizen feedback; and

The **Legal Expert** shall possess the following qualifications:

1. University degree in law.
2. Minimum of five (3) years of experience in the IT related fields and /or e-services

The attention of interested Consultants is drawn to paragraph 1.9 of the World Bank's Guidelines: Selection and Employment of Consultants under IBRD Loans and IDA Credits & Grants by World Bank Borrowers (January 2011 edition, revised July 2014) ("Consultant Guidelines"), setting forth the World Bank's policy on conflict of interest.

The Consultant will be selected in accordance with Consultant Qualifications method set out in the Consultant Guidelines.

Further information can be obtained at the address below during office hours from 08:00 to 16:00, Mondays to Thursdays, and from 08:00 to 14:00 on Fridays

The notification is posted on the website of the Agency for the Delivery of Integrated Services in Albania (ADISA): www.adisa.gov.al.

Expressions of interest (CVs, Letter of Interest and documentary evidence for fulfilling the qualifications) must be delivered in a written form to the address below in person, or by mail, or by e-mail by November 17, 2017, at 12:00 local time

Project Management Unit
Blvd: Zhan d'Ark,
Ish shtëpia e oficerave, Kati V-te
Tirana, Albania
E-mail: roland.larashi@inovacioni.gov.al
and ccsdprojectalbania@gmail.com

BURREL - Një shpërthim i fuqishëm me eksploziv ka tronditur banorët e qytetit të Burrelit. Burime zyrtare nga policia lokale bënë me dije se ngjarja ndodhi pas mesnate (rreth orës 00:40) në katin e katërt të një pallati, në lagjen "Drita" të këtij qyteti. Mësohet se lënda plasëse ishte vendosur në pjesën e shesh pushimit, 2 m larg banesës së kryetarit të bashkisë Mat, Nezir Rizvani dhe 160 cm larg banesës së një 55-vjeçari me iniciale M.B. Fatmirësisht nga shpërthimi janë shënuar vetëm dyëse materiale, pasi në dy banesa nuk ka pasur njeri. Pas sinjalizimit për shpërthimin, policia ka shkruar shpejt në vendngjarje dhe ka nisur hetimin. Sipas bluve nga shpërthimi si pa-

Nezir Rizvani: Nuk kam konflikte me askënd

Tronditet qyteti i Burrelit, shpërthim me eksploziv para derës së kryebashkiakut

sojë e shpërthimit me eksploziv janë dëmtuar pjesërisht dy dyert e banesave të shtetasve të lartpërmendur. Dyshohet se sasia e lëndës plasëse të ketë qenë rreth 50 deri në 100 gr. Grupi hetimor vijon hetimet në vendin e ngjarjes, si dhe po punohet në mënyrë intensive për identifikimin dhe kapjen e autorit/ëve. I kontaktuar dje në linjë telefonike, kryebashkiaku i Burrelit, Nezir Rizvani deklaroi se nuk ka pasur asnjë lloj kërcënimi apo konflikti dhe

se nuk ka dyshime te ndonjë person për vendosjen e eksplozivit pranë apartamentit të tij.

Zoti Rizvani përshëndetje, ju nuk keni qenë në banesë. A keni indicie se nga ka ardhur?

Ka ndodhur një shpërthim në hyrjen e pallatit ku banoj dhe unë. Nuk kam qenë në apartament, akoma nuk kam shkruar në shtëpi.

Kur jeni njoftuar për shpërthimin?

Mbrëmë pas shpërthimit

jam njoftuar.

Ju ka marrë policia, keni dëshmuar për persona që mund të kenë lidhje me ngjarjen?

Jo, nuk kam qenë. Tani do shkoj.

Mendon se jeni ju objektivi i këtij sulmi?

Unë nuk kam asnjë lloj konflikti. Është policia që do e sqarojë. Edhe familja tjetër përballë është familje emigrantësh, nuk besoj të ketë konflikte. Është një familje punëtore.



Kryebashkiaku Nezir Rizvani

Në katin e katërt ku ka ndodhur shpërthimi jeni 2 familje?

Janë 4 familje. Është vendosur më afër banesës sime dhe të fqinjit.

A keni pasur ju konflikte?

Jo, nuk kam pasur asnjë

lloj konflikti. Jo konflikte që mund të çojnë deri këtu, por as konflikte më të thejeshta. Nuk gjej arsye.

A keni pasur ndonjë kërcënim?

Jo, absolutisht. Nuk kam asnjë lloj dyshimi.

Kapen dhe 4 persona të tjerë që shpërmdanin hashash në Kamzë, Paskuqan e Babrru

TIRANË

Sekuestrohet 1.3 tonë kanabis në Rinas, arrestohen bashkëshortët Sula

Droga u gjet në papafingo, në kërkim 2 djemtë e çiftit



Droga e sekuestruar në Rinas

Një sasi prej 1.3 tonë kanabis sativa është sekuestruar nga policia e Tiranës gjatë dy operacioneve antidrogë të zhvilluara gjatë 24 orëve të fundit, ndërsa kanë përfunduar në pranga 6 persona dhe janë shpallur në kërkim 3 të tjerë. Mësohet se sasia e madhe e lëndës narkotike u gjetën banesën e shtetasit Hasan Sula në Rinas. Pas sekuestrimit të drogës, blutë kanë arrestuar 50-vjeçarën dhe bashkëshortin e tij 45-vjeçarë Merita Sula, ndërsa kanë shpallur në kërkim dy djemtë e çiftit, Klodian dhe Saimir Sula, përkatësisht 25 dhe 26-vjeç. Ka qenë drejtori i policisë së Tiranës, Ardi Veliu që ka dhënë detaje për dy operacionet e koduara "Befasia" dhe "Papafingo". Gjithçka nisi rreth orës 21:30 të së premtës pas një informacioni se një grup shpërndante lëndë narkotike në sasi të mëdha në zonën e Kamzës, Institutit të Kamzës, Paskuqanit dhe Babrrusë.

OPERACIONI "BEFASIA"

Burime zyrtare nga policia e kryeqytetit dje bënë me dije, se gjatë operacionit të koduar "Befasia" u arrestuan në flagrancë shtetasit: Fatjon Mesi, 31 vjeç, banues në Nikël-Çerek; Ilir Ferati 31 vjeç, banues në fshatin Bardhoc, Kukës; Izmir Muja 32 vjeç, banues në Lum Kukës (i dënuar me parë) dhe Saimir Grosha 33 vjeç, banues në Bardhoc i Ri, Kukës (i dënuar me parë). Ndërsa, është shpallur në kërkim shtetasit: A.Ç., 38 vjeç, banues në Tiranë (i dënuar me parë). Sipas bluve, këta persona u kapën në orët e mbrëmjes të së premtës në rrugën "Unaza e re" pas marrjes së informacioneve në rrugë operative për një grup që kryente veprimtari kriminale në këtë fushë. Mbi bazën e këtyre informacion-

eve, automjetit, me të cilin lëviznin personat e dyshuar (Fatjon Mesi dhe A.Ç.), me targa "TR 0244 S", u është bërë shenjë për të ndaluar nga shërbimet e policisë me xhupa me mbishkrimin "POLICIA" dhe duke e paralajmëruar "Ndal Policia", por automjetit nuk ka ndaluar. Gjatë kësaj kohe shtetasit A.Ç. është larguar me vrap duke dalë nga mjete, ndërsa drejtuesi ka vazhduar dhe në shpejtësi e sipër për t'i shpëtuar shërbimeve të policisë. Ai ka devijuar rrugën kryesore, duke hipur në trotuar ku dhe është përplasur me një shtyllë. Në atë moment është neutralizuar dhe pranësor shtetasit Fatjon Mesi. Në bagazhin e automjetit dhe në sediljen e pasme janë gjetur gjithsej 8 thasë me kanabis. Ndërkaq, blutë kanë neu-

tralizuar edhe 3 personat e tjerë, të cilët qëndronin në kryqëzimin e Paskuqanit duke ruajtur lëvizjen e automjetit tip "Volksvagen Polo". Gjithashtu, janë sekuestruar në cilësinë e provës materiale 2 automjete dhe 4 telefona celularë. Materialet procedurale do t'i kalojnë Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë, për veprime të mëtejshme hetimore për veprat penale të "Prodhimit dhe shitjes së lëndëve narkotike në bashkëpunim", "Shkelje të rregullave të qarkullimit rrugor" dhe "Mosbindje ndaj urdhrave të punonjësit të policisë", në ngarkim të shtetasve Fatjon Mesi, Ilir Ferati, Izmir Muja dhe Saimir Grosha, si dhe është shpallur në kërkim shtetasit A. Ç., për veprat penale "Prodhim dhe shitje

të narkotikëve të kryer në bashkëpunim".

OPERACIONI "PAPAFINGO"

Në operacionin e dytë të koduar "Papafingo" u arrestuan shtetasit: Hasan Sula, 50 vjeç, banues në Rinas dhe bashkëshortja e tij Merita Sula. Ndërsa u shpallën në kërkim dy djemtë e tyre K.S. dhe S.S. Arrestimi i çiftit Sula si dhe shpallja në kërkim e dy djemve të tyre u bë pasi, specialistët e Seksionit për Hetimin e Narkotikëve në bazë të informacioneve të siguruar në rrugë operative të dokumentuara në operacionin e parë "Befasia", se një sasi lëndë narkotike e sjellë në Tiranë për shitje, e cila u bllokua nga policia ka rezultuar të jetë marrë nga shtetasit Hasan Sula. Pas ushtrimit të kontrollit të

banesës ka rezultuar se kryesisht në katin e dytë, në papafingo, janë gjetur dhe sekuestruar në cilësinë e provës materiale gjithsej: 170 thasë me sistem vakumi të mbushur me kanabis; 1 pushkë model 56, 25 fishekë dhe 1 peshore elektronike (e cila përdorej për peshimin e lëndës së dyshuar si narkotike). Sasia e lëndës narkotike rezultoi me peshë totale 1 ton e 239,5 kg. Materialet procedurale do t'i kalojnë Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë për veprime të mëtejshme në ngarkim të shtetasve Hasan Sula, Merita Sula, K.S. dhe S.S., për veprat penale "Prodhim dhe shitje të narkotikeve të kryer në bashkëpunim" dhe "Mbajtja pa leje dhe prodhimi i armëve, lëndëve shpërthyes dhe i municionit".

SHKURTE

Nëna ndërroj jetë 20 ditë pas lindjes,

familjarët akuza mjekëve KORÇË - Një 20-vjeçare nga Korça, nënë e një foshnje 20 ditësh ka ndërruar dje jetë në spitalin e këtij qyteti. Bëhet fjalë për Grejsi Pritin, e cila kishte shfaqur komplikacione shëndetësore pas lindjes në një nga maternitetet e Tiranës. Mësohet se e reja ka pasur një shtatzëni me probleme, ndërsa ishin theksuar edhe më pas lindjes. Ditën e djeshme, gjendja e saj shëndetësore është përkëqësuar, ndaj është dërguar urgjentisht në spitalin e Korçës me tension të lartë. Pavarësisht ndihmës së dhënë nga bluzat e bardha, Grejsi Priti nuk i ka shpëtuar vdekjes. Pas ngjarjes kanë reaguar menjëherë familjarët e të resë, të cilët jashtë kamerës fajësojnë mjekët për mjekim të pakujdesshëm.

45-vjeçarja i vë flakën vetes, rëndë në spital

LEZHË - Mesditën e djeshme, rreth orës 13:00, në spitalin e Lezhës ka mbërritur një grua me plagë të rënda në trup të shkaktuar nga djegia. Burime nga policia lokale pohuan se dyshohet që 45-vjeçarja Bardhe Përrond nga fshati Tresh i ka vënë flakën vetes pasi është lyer me benzinë. Mësohet se ajo vuante nga probleme mendore, e se kishte tentuar edhe para disa vitesh t'i jepte fund jetës. Burimet e mësipërme bënë me dije se gjendja e saj ishte rënduar pas humbjes së prindërve, çka e kishte detyruar të jetonte e vetme. Disa vite kishte jetuar në shtëpitë e motrave, por me kthimin e vëllait nga Belgjika, ishte kthyer sërish në shtëpinë e vajzërisë, gjë që e ka rënduar situatën e saj. Në momentin që i ka vënë flakën vetes, raportohet të ketë qenë krejt e vetme.

Prokuroria e Elbasanit troket në Drejtorinë e Tatimeve: Kërkojmë informacion

"Në sitë" pasuria e 67 personave, mes tyre edhe familjarët e Sejditit

Regjistrohet procedimi penal për pastrim parash

Prokuroria ka nisur një superhetim për pastrim parash ndaj familjeve kryesore të Elbasanit, ndër të cilat përfshihen edhe afërm të kryebashkiakut Qazim Sejditit. Bëhet fjalë për familje e persona që janë pronarë të bizneseve të ndryshme me miliona euro xhiro e fitime. Prokuroria e Elbasanit i kërkon Drejtorisë Rajonale të Tatimeve që të japë informacion për 66 persona, nëse janë të regjistruar si subjekte, a i kanë paguar detyrimet dhe çfarë fitimi kanë pasur ndër vite.

Shtetasit e mëposhtëm janë të regjistruar si subjekt tatimpagues dhe nëse po, të na dërgoni informacion të detajuar në lidhje me objektin e veprimtarisë, vendin e ushtrimit, statusin, faktin nëse është debitor në pagesat e detyrimeve fiskale, masat



Prokuroria e Elbasanit

administrative të marra, sa aktivitete janë të regjistruar në emër të tyre, fitimet që kanë realizuar ndër vite. Shefi i prokurorisë së Elbasanit Dritan Gina, ka deleguar drejtuesin e seksionit Erida Kokonozi, për të ndjekur dosjen voluminoze. Kërkesa për Drejtorinë Tati-

more mban datën 27 tetor 2017 dhe ajo vjen pas regjistrimit të procedimit penal me nr 1542 për veprën penale të "Pastrimit të produkteve të veprës penale dhe veprimtarisë kriminale", të parashikuar nga neni 287, i Kodit Penal. Prokuroria e Përgjithshme e pyetur për këtë çështje nuk



PROCEDIMI PER PASTRIM PARASH

Kërkesa për Drejtorinë Tatimore mban datën 27 tetor 2017 dhe ajo vjen pas regjistrimit të procedimit penal me nr 1542 për veprën penale të "Pastrimit të produkteve të veprës penale dhe veprimtarisë kriminale", të parashikuar nga neni 287, i Kodit Penal.

pranoi të bënte komente. Por burime pranë organit të akuzës pohuan lidhjen e këtij superhetimi me ngjarjen e mesit të muajit shtator në Elbasan, kur një makinë "Audi" goditi mjetin e policisë gjatë një aksioni pranë tregut të qytetit. Hetimet duket se janë zgjedhur në një

67 TE HETUARIT PER PASURINE	
■ Sokol Sanxhaktari	■ Jorgo Zhidro
■ Astrit Sanxhaktari	■ Zariida Zhidro
■ Lindita Sanxhaktari	■ Kristian Zhidro
■ Orel (Aurel) Mehja	■ Leo Zhidro
■ Imelda Sejdiu	■ Misir Hoxha
■ Martin Klauz Hasa	■ Teuta Hoxha
■ Marjeta Serjani	■ Nelson Hoxha
■ Marjuz Lulaj (Suel Çela)	■ Kaona Hoxha
■ Petrit Çela	■ Themistokli Bebi
■ Hene Çela	■ Ermira Urupi
■ Mario Çela	■ Kejsi Bebi
■ Nafiz Bajrami	■ Nikola Bebi
■ Anduena Bajrami	■ Hysen Tafa
■ Gentian Çerraga	■ Dorina Tafa
■ Valbona Çerraga	■ Agron (Kamer) Mehja
■ Xhoen Çerraga	■ Ksenja Meha
■ Admir Çerraga	■ Iva Mehja
■ Brikena Çerraga	■ Metin Mehja
■ Ervis Sula	■ Mirjan Dedja
■ Haxhi Sula	■ Pali Dedja
■ Hyri Sula	■ Alban Dedja
■ Julian Sula	■ Sonila Dedja
■ Alban Sula	■ Erald Sejdiu
■ Brisida Sula	■ Ornela Guranjaku
■ Nuri Balla	■ Mimoza Sejdiu
■ Afërdita Balla	■ Elton Sejdiu
■ Ergi Balla	■ Marsida Sejdiu
■ Jona Balla	■ Agron Roka
■ Arben Asllani	■ Fatbardha Roka
■ Asterio Asllani	■ Marsel Roka
■ Ardan Zhidro	■ Xhino Roka
■ Kastriot Zhidro	■ Ermir Kendezi (Bitozhi)
■ Marinela Zhidro	■ Juliana Ajdini
■ Margarita Zhidro	

përmasë të paparashikuar në nisje të dosjes. Ato përfshijnë emrat më të njohur në Elbasan dhe jo vetëm. Mes tyre është vajza e kryebashkiakut Qazim Sejditit dhe bashkëshorti i saj, dhëndri i kryebashkiakut dhëndri i Sejditit dhe babai i tij si dhe Suel Çela dhe i ati i tij Petrit Çela, të bërë të njohur pas incidentit me policinë në hyrje të tregut të qytetit. Sipas "Vision Plus", nën hetim për pastrim parash janë edhe persona që kanë qendra tregtare, kompani ndërtime, ko-

mpani transporti, lokale e biznese nga më të ndryshmet. Bie në sy fakti se shumë prej emrave përbëjnë familje të tëra. Prokuroria dyshon se pronat janë transferuar mes antarëve të të njëjtës familje me qëllim fshehjen e të ardhurave. Ky hetim që për elitën ekonomike të Elbasanit vjen në kohën kur procesi i vetingut në drejtësi sapo ka nisur, por ai do të përfshijë sigurisht edhe lidhjet e biznesit dhe krimin dhe drejtuesit politike në nivel lokal dhe që qendror.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA KUSHTETUESE
KOLEGJI I POSAÇEM I APELIMIT

SHPLLJE E VENDEVE VAKANTE

Kolegji i Posaçëm i Apelit (KPA) pranë Gjykatës Kushtetuese, bazuar në ligjin nr. 84/2016, "Për rivlerësimin kalimtar të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve në Republikën e Shqipërisë" dhe Vendimin e Kuvendit nr.92/2017 "Për miratimin e strukturës organizative, organikës dhe klasifikimit të pagave të personelit të kolegjit të Posaçëm të Apelit", shpall vendet vakante për pozicionet:

1. SPECIALIST FINANÇË/BUXHET

Kandidati duhet të plotësojë kërkesat e posacme si vijon:

- Të zotërojë diplomë të nivelit "Master Shkencor" në Ekonomi, Dega Financë.
- Të ketë njohuri shumë të mira të gjuhës angleze.
- Të ketë të paktën 5 vite përvojë pune në profesion.
- Të ketë njohuri në programet financiare si: Alpha/Financa 5 etj.

2. SPECIALIST I BURIMEVE NJERËZORE

Kandidati duhet të plotësojë kërkesat e posacme si vijon:

- Të zotërojë diplomë të nivelit "Master Shkencor".
- Të ketë njohuri shumë të mira të gjuhës angleze.
- Të ketë të paktën 3 vite përvojë pune në fushën e burimeve njerëzore.

3. SPECIALIST IT

Kandidati duhet të plotësojë kërkesat e posacme si vijon:

- Të zotërojë diplomë të nivelit "Master Shkencor" në Inxhinieri Informatike, Informatike, Teknologji informacioni etj.
- Të ketë të paktën 3 vite eksperience pune në fushën e teknologjisë së informacionit.
- Të ketë njohuri shumë të mira në administrimin e sistemeve si Active Directory, Outlook Mail Client
- Të ketë njohuri bazë mbi pajisjet e rrjetit dhe infrastrukturën e rrjetit.
- Të ketë njohuri bazë për panelet e administrimit të faqeve web (Wordpress, Drupal, Joomla etj).
- Të ketë njohuri shumë të mira të gjuhës angleze.

4. SPECIALIST PROTOKOLL/ARKIVE

Kandidati duhet të plotësojë këto kritere:

- Të zotërojë diplomë të nivelit "Master Shkencor".
- Të ketë njohuri shumë të mira të gjuhës angleze

- Të ketë të paktën 3 vite përvojë pune në profesion.

KUSHTE TË PËRGJITHSHME

- Kandidatët duhet të sigurohen se plotësojnë kriteret për tu pajisur me Certifikate Sigurie, sipas Vendimit Këshillit Ministrave nr.188, datë 4.3.2015.
- Kandidatët duhet të kenë aftësi për tu përshtatur e punuar në grup, nën presion si dhe në afate kohore të limituara.

Të gjithë aplikimet duhet të dorëzohen nga data 6 Nëntor deri më 10 Nëntor 2017 në një formë format e dhëna më poshtë:

- Paraqitjes së Kërkesës nga aplikanti, së bashku me dokumentet përkatëse, pranë institucionit të KPA-së, në adresën: **Bulevardi "Dëshmorët e Kombit, Pallati i Kongreseve, Tiranë, nga e Hëna në të Premte, ora: 09:00-16:00.**
- Dërgimin e kërkesës së bashku me dokumentet përkatëse, me anë të postës zyrtare pranë institucionit të KPA-së në adresën: **"Bulevardi "Dëshmorët e Kombit, Pallati i Kongreseve, Tiranë.** Aplikimi në rrugë postare duhet të kryhet brenda datës 10 Nëntor 2017, i cili duhet të vërtetohet me fletë-mandatit e lëshuar nga institucioni përkatës postar. KPA-ja do të konfirmojë nëpërmjet postës elektronike marrjen e aplikimit përkatës.
- Dërgimin e kërkesës së bashku me dokumentacionin përkatës me anë të postës elektronike nga data 6 Nëntor deri më 10 Nëntor 2017 në adresën: **info@kpa.al.** KPA konfirmon nëpërmjet postës elektronike marrjen e aplikimit përkatës.

Në kërkesën që paraqet, kandidati përcakton vendin vakant, për të cilin është i interesuar të aplikojë. Bashkëlidhur me kërkesën, kandidati dorëzon 1 kopje të dokumenteve të mëposhtme:

- Jetëshkrim profesional, përfshirë të dhënat e kontaktit, postën elektronike zyrtare dhe adresën postare;
- Kopje të dokumentave (diplomë, letërnjoftimi (ID), librezë pune) original ose të noterizuar. Diplomati që janë marrë jashtë vendit, duhet të jenë njohur paraprakisht pranë institucionit përgjegjës për njehësimin e diplomave, sipas legjislacionit në fuqi.
- Dokument që vërteton se në ngarkim të tij nuk është regjistruar një procedim penal;
- Dëshmi e gjendjes gjyqësore;
- Vërtetim nga Institucioni që nuk ka masë disiplinore në fuqi;
- Vlerësimin e fundit nga Eprori Direkt;
- Cdo dokumentacion tjetër që vërteton plotësimin e kushteve të mësipërme, si dhe trajnime, kualifikime, arsimin shtesë, vlerësimet pozitive apo të tjera të përmendura në jetëshkrim.

Ornela Manjani

Personat që janë pranë moshës së daljes në pension dhe nuk plotësojnë vitet e sigurimit mund të bëhen pjesë e skemës së sigurimit vullnetar. Instituti i Sigurimeve Shoqërore publikon një manual ku bëhen të ditura të gjitha hapat që duhet të ndjekin të vetëpunësuarit jo vetëm në bujqësi, por edhe në sektorë të tjerë për të përfitur pension pleqërie. Sigurimi vullnetar, një mundësi për të gjithë shtetasit shqiptarë kudo që ndodhen, brenda territorit të Shqipërisë dhe jashtë saj. Instituti i Sigurimeve Shoqërore ka përgatitur një manual, i cili u vjen në ndihmë emigrantëve për të kontribuar në skemën e sigurimeve shoqërore me qëllim që kur të mbushin moshën e pensionit të jenë përfitur.

VITET E KALUARA

Pagesa aktuale për të mbuluar periudha të kaluara, bëhet vetëm në kuotën minimale dhe është 5 184 lekë për një muaj sigurim vullnetar. ISSH e ilustron edhe me shembuj mënyrën e pagesës. Kështu një person që është në prag të mbushjes së moshës ose e ka mbushur moshën që të jetë në kushte përfitim, minimalisht duhet të ketë 15 vjet periudhë kontributive të siguruar. Në rast se personi ka 12 vjet periudhë kontributive, ka të drejtë të plotësojë 15 vitet e nevojshme duke blerë 3 vjet sigurim nëpërmjet skemës vullnetare. Masa e kontributit që do të paguhet nga shtetasi do të jetë e barabartë me pagesën aktuale mujore për sigurim vullnetar, e cila aplikohet e tillë për gjithë periudhën tre-vjeçare. Masa kontributive që do të derdhë qytetari për këtë periudhë është 5 184 lekë për një muaj.

KONTRIBUTI VULLNETAR

Kontributi vullnetar llogaritet në kufijtë e pagës minimale dhe maksimale të caktuar nga Këshilli i Ministrave dhe paguhet nga personi i siguruar në shumën dhe afatin e përcaktuar në kontratën e sigurimit vullnetar. Kontributi vullnetar llogaritet në kufijtë e pagës minimale dhe maksimale të caktuar nga Këshilli i Ministrave dhe ka të njëjtin rregull me kontributin e detyrueshëm.

PËRFITUESIT

Procedurat për sigurimin vullnetar mund të kryhen pranë Agjencive Lokale të Sigurimeve Shoqërore, në çdo qytet. Të drejtën për të përfitur nga kjo skemë e kanë jo vetëm emigrantët, po të gjithë shtetasit shqiptarë, që nuk plotësojnë vitet e punës. Me kontraktin në këtë skemë përfshihen të gjithë shtetasit shqiptarë që: Kanë mbushur moshën 18 vjeç dhe akoma nuk iu ka lindur e drejta për ndonjë përfitim nga skema e sigurimit të detyrueshëm; Për një kohë dhe shkakë të caktuara nuk mund të sigurohen nga skema e sigurimit të detyrueshëm apo ata që janë të siguruar në skemën e sigurimit

Manuali i Institutit të Sigurimeve Shoqërore publikon procedurat për kontributet vullnetare

ISSH: S'plotësoni vitet me sigurime, ja si të merrni pension pleqërie

Të vetëpunësuarit pagesat dhe përfitimet sipas kategorive



ISSH

Sigurimi vullnetar, një mundësi për të gjithë shtetasit shqiptarë kudo që ndodhen, brenda territorit të Shqipërisë dhe jashtë saj. ISSH ka përgatitur një manual, i cili u vjen në ndihmë emigrantëve për të kontribuar në skemën e sigurimeve shoqërore me qëllim që kur të mbushin moshën e pensionit të jenë përfitur.

(me kusht që pagesat të realizohen brenda muajit Janar); 3% mbi shumën për efekt të llogaritjes së kontributeve të sigurimeve shoqërore kuota mujore e sigurimit vullnetar pritet të shkojë 5 184 lekë ose 432 lekë më tepër se aktualisht.

të detyrueshëm dhe kërkojnë që nëpërmjet sigurimit vullnetar të rrisin të ardhurat e tyre. Gjithashtu, të drejtën e kanë edhe ata persona që nuk janë pjesëmarrës në skemën e të vetëpunësuarve në bujqësi, ndërkohë që kur personi i interesuar ka lënë shtetësinë

shqiptare, mund të bëjë sigurim vullnetar vetëm për periudhën nga 1.1.1994 deri në datën që ka lënë shtetësinë shqiptare.

KONTRIBUTET

Masa e kontributit që duhet të paguhet për sigurimin vullnetar nga personi i in-

teresuar, është e barabartë me masën që paguhet për degën e pensioneve, sipas pagës minimale të miratuar në periudhën kur bëhet pagesa. Kuota mujore e sigurimit vullnetar për vitin 2017, është 4 752 lekë, që i korrespondon pagës minimale

mujore (24 000 lekë x 21.6%). Ndërkaq, për pagesat paradhënie, aplikohen zbritje në varësi të kohës kur kryhet pagesa. Kështu, nëse do të parapaguani për vitin në vijim në fillim të periudhës, do të ketë zbritje: 6% mbi shumën për një pagesë vje-

SIGURIMI VULLNETAR PËR VITIN KORENT

Sigurim vullnetar për vitin korent mund të paguhet gjithë shtetasit shqiptarë që:

- Kanë mbushur moshën 18 vjeç, deri në arritjen e moshës për pension;
- Nuk mund të sigurohen në sistemin e sigurimit të detyrueshëm;
- Nuk mund të sigurohen në sistemin e të vetëpunësuarve në bujqësi;
- Nuk iu ka lindur e drejta për ndonjë përfitim nga skema e sistemit të detyruar.

Sa është masa e kontributit për sigurim vullnetar për vitin korent?

1. Masa e kontributit që duhet të paguhet për sigurimin vullnetar nga personi i interesuar, është e barabartë me masën që paguhet për degën e pensioneve, sipas pagës për efekt kontributësh të miratuar në periudhën kur bëhet pagesa.
2. Pagesa aktuale për një muaj sigurim vullnetar është 5 184 lekë, që i korrespondon pagës minimale mujore: 24 000 lekë x 21.6%. Për pagesat paradhënie, aplikohen zbritje në Institutin të Sigurimeve Shoqërore varësi të kohës kur kryhet pagesa. Kështu, nëse do të parapaguani për vitin në vijim në fillim të periudhës, do të ketë zbritje:
 1. 6% mbi shumën për një pagesë vjetore (me kusht që pagesat të realizohen brenda muajit Janar);
 2. 3% mbi shumën për një pagesë 6-mujore (me kusht që pagesat të realizohen përpara fillimit të periudhës 6-mujore, që do të mbulohet me sigurim vullnetar);
 3. 1.5% mbi shumën për një pagesë 3-mujore (me kusht që pagesat të realizohen përpara fillimit të periudhës 3-mujore, që do të mbulohet me sigurim vullnetar).
3. Por pagesat e vitit korent mund të bëhen edhe me shumëfishin e kuotës minimale mujore, 5 184 lekë, deri në kufijtë e pagës maksimale. Përfitimet nga sigurimi vullnetar për vitin korent:
 - Pensione minimale pleqërie, invaliditeti dhe familjar;
 - Pensione më të larta se niveli minimal, sipas llogaritjeve mbi shumëfishin e pagave të paguara.

II. Sigurim vullnetar për periudha të kaluara.

1. Shtetasit shqiptarë që kanë mbushur moshën 18 vjeç dhe që nuk iu ka lindur e drejta për ndonjë përfitim nga skema e sistemit të detyruar.
2. Shtetasit shqiptarë meshkuj për periudhën e studimeve universitare, pasi periudha e studimeve pasuniversitare është me pagesë.
3. Shtetasit shqiptarë që kanë periudha të pambuluar nga sistemi i sigurimit të detyrueshëm dhe dëshirojnë t'i plotësojnë ato nëpërmjet sigurimit vullnetar.
4. Personat që kanë lënë shtetësinë shqiptare mund të bëjnë sigurim vullnetar për mbulimin e periudhave të kaluara nga data 01.01.1994 deri në datën që kanë lënë shtetësinë.

Sa është masa e kontributit për sigurim vullnetar për periudhat e kaluara?

1. Masa e kontributit që duhet të paguhet për sigurim vullnetar nga personi i interesuar për mbulimin e periudhave të kaluara përcaktohet nga koha kur bëhet pagesa (aplikohet masa që është në fuqi në momentin e kryerjes së pagesës, masë e cila miratohet me VKM, për degën e pensioneve).
2. Pagesa aktuale për të mbuluar periudha të kaluara, bëhet vetëm në kuotën minimale dhe është 5 184 lekë për një muaj sigurim vullnetar. Kjo kuotë i

korrespondon pagës minimale mujore: 24 000 x 21.6%. Në këto pagesa nuk aplikohen zbritje. Përfitimet nga sigurimi vullnetar për periudhat e kaluara: - Vjetërsi pune, e cila influencën në plotësimin e kushteve për të përfitur një pension; - Pension pleqërie, invaliditeti dhe familjar, në nivel minimal.

III. Sigurim vullnetar për më shumë të ardhura.

Kush mund të paguajë sigurim vullnetar për më shumë të ardhura?

1. Të gjithë personat ekonomikisht aktivë të vetëpunësuar, të punësuar dhe punëdhënësit, të cilët duhet të jenë të siguruar si të tillë në skemën e detyrueshme të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore.
2. Ky sigurim bëhet vetëm për vitin korent.

Sa duhet të paguhet për sigurim vullnetar për më shumë të ardhura: Instituti i Sigurimeve Shoqërore

- a) Personat e vetëpunësuar - sigurohen me pagë minimale mujore 24 000 lekë ose shumëfishi i asaj mbi të cilin do të paguhet kontributet dhe kjo pagë shumëzohet me 21.6%, pra është sigurim me kuotë fikse 5 184 lekë ose shumëfishi i kësaj kuote;
- b) Të punësuarit-sigurohen me pagë minimale mujore 24 000 lekë ose shumëfishi i asaj mbi të cilin do të paguhet kontributet dhe kjo pagë shumëzohet me 21.6%, pra sigurim me kuotë fikse 5 184 lekë ose shumëfishi i kësaj kuote;
- c) Punëdhënësit-sigurohen me pagë minimale mujore 24 000 lekë ose shumëfishi i asaj mbi të cilin do të paguhet kontributet dhe kjo pagë shumëzohet me 21.6%, d.m.th. sigurim me kuotë fikse 5 184 lekë ose shumëfishi i kësaj kuote.

Përfitimet nga sigurimi vullnetar për më shumë të ardhura:

- Pensione më të larta pleqërie, invaliditeti dhe familjar sipas llogaritjeve mbi shumëfishin e pagave të paguara.

Dokumentacioni dhe procedurat për t'u siguruar.

1. Personi i interesuar, paraqitet në Agjencinë Lokale të Sigurimeve Shoqërore të vendit ku ai banon dhe merr kontakt me inspektorin e sigurimit vullnetar.
2. Personi i interesuar duhet të ketë me vete dokumentet e mëposhtme:
 - a) Fotokopje të librezës së punës, ku pasqyrohen periudhat e sigurimit;
 - b) Fotokopje të librezës së kontributeve, në rast se e disponon;
 - c) Fotokopje të letërnjoftimit elektronik / kartës së identitetit.
3. Nëse personi i interesuar bie dakord për t'u siguruar vullnetarisht, do të marrë dokumentin tip "Urdhër veprimi", i cili plotësohet nga inspektori i sigurimit vullnetar të Agjencisë Lokale të Sigurimeve Shoqërore.
4. Duke disponuar këtë "Urdhër veprimi" personi i interesuar paraqitet në bankë për të bërë pagesën. Me kryerjen e pagesës ai pajiset nga banka me "Mandat arkëtim".
5. Pas marrjes së mandatit arkëtim, personi i interesuar rikthehet tek inspektori i sigurimit vullnetar të Agjencisë Lokale të Sigurimeve Shoqërore, me të cilin lidh marrëveshjen e sigurimit vullnetar, që nënshkruhet nga personi i interesuar dhe inspektori i sigurimit vullnetar të Agjencisë Lokale të Sigurimeve Shoqërore (mandat arkëtim në asnjë rast nuk i dorëzohet punonjësit të sigurimeve shoqërore. Ai është personal dhe mbahet nga vetë personi i interesuar).
6. Pas nënshkrimit të marrëveshjes, inspektori i sigurimit vullnetar të Agjencisë Lokale të Sigurimeve Shoqërore është i detyruar të bëjë pasqyrimin në librezë të kontributeve të personit të interesuar, ose të hapë librezë të re në qoftë se nuk ka.

Opinion **i** Ditës

Nga Zija Lika

Përfshirja e rreth 10.000 subjekteve të biznesit të vogël me xhiro vjetore mbi 2 deri 5 milionë lekë të rinj, në skemën ligjore të TVSh-së, duke filluar prej datës 01.01.2018 e në vazhdim, do të kërkojë përveç të tjerash, shtimin e organikanë së administratës tatimore qendrore mbi numrin 1586 që ajo është aktualisht, në mënyrë që të bëhet i mundur jo vetëm përpunimi, azhurnimi, gjurmimi dhe ndjekja e informacionit përkatës tatimor, por edhe kontrolli i vazhdueshëm tatimor i tyre në përputhje me legjislacionin tatimor në fuqi.

Është plotësisht e mundur që kjo shtesë organike, jo vetëm të mos cenojë aspak me kosto shtesë financiare buxhetin e shtetit, por përkundrazi të gjenerojë të ardhura shtesë të konsiderueshme për të. **Si mund të realizohet një gjë e tillë?**

Aktualisht janë rreth 300 ish-punonjësit të sistemit tatimor të larguar nga puna pas vitit 2000, për të cilët ekzistojnë vendimet përkatëse gjyqësore të formës së prerë në favor të tyre, por që ende figurojnë të pakthyer në punën e mëparshme. Ky fakt, për një gjë të madh ekonomik të përvitshëm që i bëhet buxhetit të shtetit dhe takspaguesve shqiptarë, pasi secili prej tyre ka përfunduar dhe përfundon, do vit, në vartësi me pagën përkatëse që ka pasur, një shumë prej 9-10 milionë lekësh të vjetër, pa dhënë asnjë lloj kontributi në punë.

Duke qenë kështu, kuptohet fare qartë që shumicës së tyre apo ndoshta të gjithëve, nuk i intereson rikthimi në punën e mëparshme, madje mund ta konsiderojnë si një nga fatkeqësitë më të mëdha, nëse një gjë e tillë u ndodh, pasi ata mund të bëjnë punë të tjera (qoftë edhe në sektorin publik) dhe paguhen për to, të merren me biznese, e tjera, apo të emigrojnë jashtë vendit për vite të tjera dhe deri sa të arrijnë moshën e pensionistose të jetë gjallë (gjë e cila nuk përbën aspak çudi), të paguhen duke shtuar çdo vit në logarinë bankare të çdonjërit prej tyre, shumën prej rreth 10 milionë lekësh. Përvoja e deritanishme ka treguar se kjo pagë, mund të vazhdojë pa ndërprerje deri në më shumë se 40 vjet rrosht, duke kapur shifrën e mbi 400 milion lekëve. Këto miliona euro, që jepen çdo vit krejt në mënyrë inproduktive (pa punuar) në formë dëmshpërblimi, pa përgjegjësiar ligjorë as askënd, është momenti të shpenzohen si paga + sigurime shoqërore e të tjera, për rikthimin dhe vazhdimin në punën e mëparshme të këtyre ish-punonjësve, ndërkohe që produktiviteti i punës së tyre, do të gjenerojë pa dyshim të ardhura shtesë për buxhetin e shtetit, disa herë më shumë, se sa shtesa përkatëse e kostos që i korrespondon kësaj shtese organike.

Në këtë situatë, rikthimi i tyre në punë sa më shpejtë që të jetë e mundur, qoftë edhe me shtesë organike, e cila është plotësisht e justifikueshme në situatën e krijuar, me hyrjen e pritshme prej datës 01.01.2018 e në vazhdim, të rreth 10 mijë subjekteve të biznesit të vogël në skemën e TVSh-së, jo vetëm që e ndërpret efektin përkatës negativ të dëmshpërblimeve financiare të sipërpërmendura në buxhetin e shtetit, por përkundrazi mundëson lëvizjen e tij drejt kahut pozitiv, pasi kontributi (produktiviteti) i punës së tyre në sistemin tatimor, i cili ende karakterizohet nga një nivel i lartë evazioni fiskal, do të shoqërohet me shtim në kushtet e mirëmenaxhimit të këtij sistemi, me një rritje të ardhurash për buxhetin e shtetit disa herë më shumë se rrogat përkatëse të tyre, të cilat vazhdojnë t'i marrin sistematikisht në periudha periodike vjetore, në mënyrë inproduktive e parazitare, madje dhe pa zbritur më parë kontributin e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore, sikurse ndodh me të punësuarit.

Në lidhje me sa më sipër, për të gjithë ish-punonjësit tatimor, të larguar më parë nga puna dhe për të cilët aktualisht ekzistojnë vendimet përkatëse gjyqësore të formës së prerë në favor të tyre, duhet të fillojnë menjëherë nga ana e DPT-së dhe DAP-it Tiranë, procedurat e rikthimit të tyre në punë, duke i kërkuar paraprakisht qeverisë në mënyrë të argumentuar, miratimin e një shtese organike për aq sa nevojitet, në përmbushje të detyrimit përkatës gjyqësor, që rrjedh edhe nga zbatimi i ligjit 152 / 2013 "Për nëpunësin civil", të ndryshuar, nenit 7, pika 2, shkronja gj. Sqarohet në se kushtet e reja, që

Koha për ekzekutimin e vendimeve gjyqësore për ish-punonjësit tatimorë

do të krijohen në sistemin tatimor, me hyrjen në skemën ligjore të TVSh-së, të rreth 10 mijë subjekteve të biznesit të vogël me xhiro vjetore mbi 2 deri në 5 milion lekë të reja dhe me qëllim që të bëhet e mundur përmbushja e detyrimit përkatës ligjor, për ekzekutimin e vendimeve gjyqësore të formës së prerë ende të pa ekzekutuara, në lidhje me rikthimin në punën e mëparshme të ish-punonjësve tatimorë të larguar më parë padrejtësisht nga puna, është e nevojshme që kjo shtesë organike të jetë jo më e vogël se numri përkatës i këtyre të fundit.

Menjëherë pas këtij miratimi, Ministria e Financave konform procedurave përkatëse ligjore, duhet të transferojë fondin përkatës të parashkuar në buxhetin e shtetit për dëmshpërblime të kësaj natyre, në fond pagash për logaritë të DPT-Tiranë, duke shtuar pjesën kontributive të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore, që do të paguhet nga punëdhënësi (shteti) dhe rritjen totale respektive të pagës bruto krahasuar me më parë.

Ky transferim është tepër i rëndësishëm, pasi ai bën të mundur zëvendësimin e shpenzimeve buxhetore inproduktive me ato produktive, pasi këto të fundit në çdo rast do të krijonin të ardhura shtesë nga punësimi për logaritë të buxhetit të shtetit, ndërkohe që ndryshesa (ritja/ulja) e shpenzimeve faktike në kuadrin e këtij buxheti, do të jetë e barabartë me pjesën e kontributit të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore, që do të paguaj punëdhënësi (shteti) në zbatim të legjislacionit përkatës, plus rritjen totale respektive të pagës bruto, krahasuar me më parë për të gjithë ish-punonjësit e rikthyer faktikisht në punë, minus pjesën e dëmshpërblimit financiar të ndërprerë për ata ish-punonjës, të cilët sikurse themi më poshtë lirohen apo largohen nga shërbimi civil.

Përlogaritët se vlera e çdo dëmshpërblimi financiar të ndërprerë, është përafërsisht e mjaftueshme për të mbuluar koston shtesë buxhetore të rikthimit dhe vazhdimin në punën e mëparshme, të katër ish-punonjësve zotërues të vendimeve gjyqësore të formës së prerë, të cilat e konfirmonin më parë këtë të drejtë. Kjo do të thotë se vlera e dëmshpërblimit, që i korrespondon 20% të numrit total të ish-punonjësve tatimorë të kësaj kategorie, të cilëve për shkaqet e përmendura më poshtë lu nën dërritjet dëmshpërblimi financiar, është e mjaftueshme për të përballuar koston shtesë buxhetore të rikthimit dhe vazhdimin në punën e mëparshme, të të gjithë pjesës tjetër të barabartë me 80% të numrit total të tyre, ndërkohe që nëse shifra e më sipërme e daljes nga skema e dëmshpërblimit financiar është mbi 20%, atëherë gjenerohet përfitim shtesë buxhetor në formën e kursimit të shpenzimeve përkatëse të këtij buxheti.

Nëse për këtë kategori ish-punonjësish, kryhen procedurat përkatëse ligjore të rikthimit në punë dhe për këtë bëhet njoftimi zyrtar i secilit prej tyre, atëherë ndërpritet menjëherë dëmshpërblimi financiar i sipërpërmendur, pasi në këtë moment madje edhe kur ekzistojnë arsye të justifikueshme ligjore për mosparaqitjen në punë, efektet e vendimeve gjyqësore të formës së prerë nullifikohen (zerohen), ndërsa të gjithë ata që paraqesin aktin e dorëheqjes me shkrim, apo për arsye të ndryshme të pajustificuara ligjore nuk e respektojnë këtë vendimarrje, lirohen apo largohen respektivisht nga shërbimi civil dhe numri i tyre në varësi me rastin konkret (kur shtesa organike në fjalë, është më e madhe nga sa nevojitet, në fakt) i zbritet atij të strukturës së shtuar organike të personelit, duke e fiksuar atë përkoheqsisht në përputhje me rregullat përkatëse ligjore.

Pra, zbatimi i kësaj skeme ekonomiko-ligjore në çdo lloj rasti dhe rrethanë, do të rezultojë me efektin financiar pozitiv për buxhetin e shtetit dhe do të ulë nga ana tjetër, treguesin në % që të kostoja reale vjetore e mbajtjes së personelit të administratës tatimore qendrore, (të cilin i shtohet edhe dëmshpërblimi vjetor i sipërcituar), ndaj totalit të të ardhurave vjetore që vilen prej kësaj administrate, ndërkohe që vonesat subjektive të pajustificuara nga ana ligjore, lidhur me ekzekutimin e vendimeve gjyqësore të formës së prerë (për sa i takon rikthimit në vendin e mëparshëm të punës, të ish-punonjësve përkatës të larguar më parë nga puna), apo akoma më keq mosekzekutimi fare i tyre, do të vazhdojnë të ndëshkojnë financiarisht këtë buxhet dhe takspaguesit shqiptarë.

Do të ishte shkëlqej e rëndë e legjislacionit dhe do të për-



bënte konsumim veprash penale përkatëse, fakti që kjo shtesë organike e nevojshme (sikurse themi më sipër) në administratën tatimore qendrore, të plotësojë me rekrutime punonjësis të tjerë nga jashtë sistemit tatimor, pa ezartuar më parë ekzekutimin e të gjitha vendimeve gjyqësore të formës së prerë ende të pa ekzekutuara, në lidhje me të gjithë ish-punonjësit tatimorë të larguar më parë padrejtësisht nga puna. Në lidhje me këtë, duhet të bëhet rregullimi përkatës ligjor, duke ngarkuar me përgjegjësi financiare, administrative dhe/ose penale autoritetet përkatëse vendimmarrëse, për largime të padrejta nga puna, të konfirmuara përmes vendimeve përkatëse gjyqësore të formës së prerë, që lidhen me periudhat respektive nga datat e largimit, deri tek ato të marrjes formë të prerë të vendimeve gjyqësore dhe për mosekzekutim në kohë të këtyre të fundit, prej datave përkatëse që duhet të realizohet përmbushja e këtij detyrimi ligjor, deri në ato të ekzekutimit të këtyre vendimeve, apo në vazhdim për pjesën e mbetur të tyre ende të pa ekzekutuar.

Gjykoj se duke vepruar në këtë mënyrë, bëhet e mundur që të merren një sërë përfitimshëm në drejtime dhe aspekte të ndryshme, të cilat padyshim do të jenë në interes të mbarë publikut dhe vlerësohen pozitivisht prej tij.

Në aspektin ligjor, ekzekutimi i vendimeve gjyqësore të formës së prerë, merr një rëndësi edhe më të madhe në kushtet e some të implementimit të reformës në drejtësi dhe çeljes së pritshme të negociatave për anëtarësim të vendit tonë në Bashkimin Europian. Në të gjitha vendet e botës ku funksionon realisht shteti ligjor i së drejtës, jo vetëm që ekzekutohen në kohën e duhur këto vendime, por aktualisht në disa prej tyre si SHBA, Gjermani e tjera, legjislacioni përkatës me qëllim minimizimin e pagesave inproduktive, kushtëzohet dhënie e asistencës ekonomike për të gjithë individët përfitues në moshë ligjore pune dhe të aftë për punë, me kryerjen përçatë çdo muaji të një numri të caktuar orësh pune në doli të komunitetit.

Në aspektin ekonomik, sikurse e shpjeguar më sipër, bëhet e mundur të shmangen ose të paktën minimizohen, pagesat e majme, sistema-

tike, inproduktive e parazitare, që kapin çdo vit në total shifra prej disa milionë euro për këtë kategori ish-punonjësish të sipërpërmendur, të cilët mund t'i përfitojnë ato në vazhdimësi deri në më shumë se 40 vjet, nëse nuk kryhen procedurat përkatëse ligjore të rikthimit në punën e mëparshme.

Në aspektin social, rikthimi sa më shpejtë të jetë e mundur në vendet e mëparshme të punës konform vendimeve përkatëse gjyqësore të formës së prerë, të shtang në të ardhmen, aferat korruptive që mund të jenë praktikuar në të kaluarën në sistemin gjyqësor, lidhur me dhënie e së drejtës së pamertuar (të disa prej ish-punonjësve të larguar nga puna), kundrejt shpërblimeve korruptive të dhëna, pasi çdo vendim i kësaj natyre lu ka siguruar dhe siguron atyre, çdo vit në vazhdimësi mesatarisht rreth 10 milionë lekë të vjetër.

Në aspektin moral, shoqëror e politik, duke vepruar si më sipër, kontribuohet pozitivisht në drejtim të dhënies fund, jo vetëm të pagesave të majme parazitare që shpesh zgjaten pa limit kohor në dëm të interesit publik, por edhe të spekulimeve hipokrite të një pjese të ish-punonjësve të kësaj kategorie, që ndërsa hiqen çuditërisht "të persekutuar", (megjithëse trajtohen me rroga të larta papunuar), tundi jo rrallë herë flumuj e opozitarizmit, në pritje dhe me ëndërrin për t'u katapultuar në të ardhmen, në poste drejtorësh në mënyrë të pamertuar.

Vetëm kështu, aq më tepër të ndodhur përball implementimit të shumëpritur të reformës në drejtësi dhe çeljes së negociatave për anëtarësim të vendit tonë në bashkimin europian, bëhet i mundur zbatimi korrekt i legjislacionit mbi ekzekutimin e detyrueshëm të vendimeve gjyqësore të formës së prerë, shmangia ose minimizimi i pagesave inproduktive e parazitare, të cilat kapin vlera monetare relativisht shumë të larta, eliminimi i mundësisë të emërimeve të reja të pamertuara dhe dublura, përmirësimi i efikasitetit ekonomik në sistemin tatimor e tjera, duke kontribuar pozitivisht në rritjen e mirëqenies ekonomike e sociale të mbarë publikut. Shpresoj që këto mendime, kështu dhe sugjerime të karakterit ekonomik - ligjor, të merren në konsideratë dhe implementohen nga institucionet përkatëse ligjzbatuese dhe ligjëvendësit shqiptarë, pasi ato përveç të tjerash, do të rezultojnë çdo vit në të ardhmen me efekte financiare pozitive, prej disa milion euro në favor të buxhetit të shtetit dhe interesit publik.

REPUBLIKA E SHQIPERISE
BANKA E SHQIPERISE
 DEPARTAMENTI I ADMINISTRIMIT
 SEKTORI I PROKURIMIT

TENDER I HAPUR KOMBËTAR

Banka e Shqipërisë kërkon të realizojë objektin e prokurimit: **"Blerje e një pajisje pirun elektrik, për nevojat e Bankës së Shqipërisë"**.

Banka e Shqipërisë fton kandidatët e interesuar, të marrin pjesë në procedurën e prokurimit "Tender i hapur kombëtar", për realizimin e objektit të prokurimit si më sipër, me **fond limit 1.970.000 Lekë**.

Dokumentet e tenderit mund të tërhiqen pranë Sektorit të Prokurimeve të Departamentit të Administrimit, të Bankës së Shqipërisë, me adresë: Rruga e Dibrës, Kompleksi "Hallili", Kulla A, Tiranë, Tel. 042419411(ext.4251), çdo ditë nga ora 10.00 – 13.00 nga çdo person i autorizuar, me paraqitjen e një kërkesë me shkrim. Tërheqja e dokumenteve mund të bëhet vetëm pasi të keni bërë paraprakisht pagesën e pakthyeshme prej 500 Lekë, pranë një banke tregtare në llogarinë e Bankës së Shqipërisë sipas detajeve të mëposhtme:

Përfutuesi: Banka e Shqipërisë
 BIC: STANALTR
 IBAN: AL68 1011 1008 0000 0000 2222 222L; BIC

Përkshkrimi: Blerje dokumente tenderi për tenderin me objekt: **"Blerje e një pajisje pirun elektrik, për nevojat e Bankës së Shqipërisë"**

Oferta duhet të paraqitet në zyrën e Sektorit të Prokurimeve, pranë Departamentit të Administrimit, në Bankën e Shqipërisë, deri më datë **30 Nëntor 2017, ora 14.00**, kohë në të cilën do të hapet edhe tenderi, ku ftohen të marrin pjesë kandidatët ose përfaqësuesit e autorizuar të tyre.

Shoqëria përbërëse "AFA-2010" sh.p.k
 shpall Ankandin për shitjen e pasurisë së paluajtshme:

Pasurisë me Nr.3/369 e llojit "Trulli + Banesë 3 katëshe" me sip. trulli 350 m2 dhe sip. banesë 191,9 m2. (katërrëzë 91,9 m2, katë i 1.269,03 dhe katë i 69 m2) ndodhur në L. "1 Janari" ZK 2310. Kuzhë në pronësi Agim Isa Zeqja. Çmimi fillestar në ankandin e dytë është 11.200.000 Lekë. Ankandi zhvillohet në datë 09.11.2017, ditën e Enjte ora 15.30 në ambientin e Shoqërisë Përbërëse "AFA-2010" sh.p.k në adresën Rruga "Sulejman Delvina", Nd.51, H.9, Ap.1, Tiranë. Për info. Tel:044503458 ose E-mail: shqogeriapebarmimoreafa2010@gmail.com

DEKLARATA

Ismail Kadare: Komunizmi u mund nga mizoria e tij

Nga Silvana Palazzo*

“Për Marks-in nuk duhej të kishte mëshirë”, Ismail Kadare, poeti dhe shkrimtari shqiptar, në lidhje me fundin e komunizmit ka thënë se: “Është mundur nga mizoritë e veta. Për Marks-in nuk duhej të kishte mëshirë, as për fituesit”.

Revolucioni humbi prej tejkalimit të mizorisë: në luftën e klasave të pandarë nga koncepti marksist nuk kishte mëshirë. E ka shpjeguar Ismail Kadare, i cili foli për Revolucionin e Tetorit, fazë vendimtare e revolucionit rus që shënoi rënien e ruse dhe krijimin e Republikës Sovjetike. “Marks e bazon doktrinën e tij ekonomike dhe sociale në idenë se nuk duhet të ketë keqardhje për të mundurit”-tha shkrimtari shqiptar, duke shtuar se “Komunizmi u rrëzua për shkak se njerëzimi nuk mundi ta pranojë gjithë këtë mizori”. Vetë Kadareja besonte në komunizëm, derisa gjeti ‘trazimin shpirtëror’. Në Evropë tani

po ngrihen pikëpyetje nëse ka qenë parakohshëm zgjerimi- me ato vende të Evropës Lindore që sot kanë qeveri autoritare, ndoshta për shkak se ato nuk janë ende gati për demokracinë liberale, por Shqipëria duhet të shkojë në këtë drejtim për Ismail Kadarenë. “Trendi është atje, njerëzit shprehimisht duan Evropën. Kjo rrugë mund të pengohet vetëm nga trashëgimia jonë kulturore. Por, le të vazhdojmë përpara”,- tha shkrimtari shqiptar në intervistën e botuar në “La Stampa”.

RIZGJIMI ISLAMIK DHE ANTISEMITIZMI SHQIPTAR

Një nga pasojat e rënies së diktaturës së madhe komuniste në Shqipëri është ringjallja fetare, veçanërisht ajo e islamit- për Ismail Kadarenë, shpjegimi duhet të kërkohej nga ateizmi shtetëror i imponuar nga regjimi. Megjithatë, ai nuk beson se trazirat në Ballkan janë të rrezikshme: “Në Shqipëri, komunizmi nuk hodhi vërtetë rrenjë, ai u prit ftohtë për shkak se morali tradicional ishte ndryshe, nuk ka qenë kur-

Media italiane artikull për shkrimtarin shqiptar, komunizmin, fenë dhe Europën



Ismail Kadare

rë mënyrë e të qenit”. Familja tradicionale në Shqipëri ka pasur gjithmonë një rëndësi më të madhe se kolektivizmi. Ky vend, ndër të tjera, është një përjashtim në marrëdhëniet me hebrejtë, sepse i ka

kursyer dëbimet. Antisemitizmi ka qenë gjithmonë larg: “Shqipëria kishte një reputacion të keq në botë, por të paktën nuk ishim antisemitë. Të qenit me hebrejtë për ne është një gjë e njohur”,-shpjegoi

Ismail Kadare në një intervistë me La Stampa. Madje, as një mbret reaksionar, si Zogu nuk ishte antisemit, po kështu edhe Hoxha, i cili kishte zemërguri”.

DËSHIRA E

SHQIPËRISË PËR TË HYRË NË EUROPE

Ismail Kadare është i bindur se populli shqiptar është më evropian midis popujve të Ballkanit, për këtë, beson se Europa duhet ta mbështesë këtë komb për emancipimin e Gadishullit Ballkanik. Dëshira e Shqipërisë për t'u bashkuar me Evropën pikërisht në një kohë kur Bashkimi Europian duket të jetë në krizë, ngjan pothuajse paradoksale, por për shkrimtarin, “një krizë kontinentale është ndryshe nga kriza e vendeve të vogla”. Problemi megjithatë është se prozelitizmi i ekstremizmit islamik mund të ketë ndikim të të rinjtë e Kosovës dhe Shqipërisë, por për Ismail Kadarenë do të jetë një “ndikim i kufizuar dhe për një periudhë të kufizuar kohore”. Vetëm një valë kalimi për një akumulim keqkuptimesh: “Disa e afrojnë shpjegimin me problemet sociale, por unë nuk besoj të kjo, sepse shkaqet sociale zmadhohen, kur nuk domi të shihni të vërtetën”,-thaa në një intervistë së fundmi për “La Repubblica”.

*“*Tisusdiario.net*”

KUMBARO ‘PAJTON’ SHQIPTARËT E GREKËT, NGA DROPULLI NË JANINË

Duke iu përgjigjur in teresit të dropullitëve në takimin e zhvilluar ditën e djeshme në Derivcan, ministrja e Kulturës, Mirela Kumbaro njerëresh edhe deputetja e qarkut të Gjirokastrës tha se kufijtë ekzistojnë vetëm në kokat e disa individëve që duan të bëjnë biznes politik. “Si ministre e Kulturës dua të them se fusha që unë mbuloj, kultura është dëshmitari më i mirë i një hapësire pa kufij. Ndaj dua të them se nëse ekzistojnë kufij, ata ekzistojnë në kokat e disa njerëzve. Prandaj ne jemi këtu për të folur me njëri-tjetrin dhe për t'i thyer këta kufij me punë dhe komunikim”,-tha ministrja Kumbaro në takimin që u zhvillua si pjesë e vizitës në qark së bashku me Ministrin e Punëve të Jashtme dhe Europës Ditmir Bushati si dhe zvmministres Artemis Dralo. Më tej Kumbaro u ndal tek investimet që qeveria



po kryen dhe që do të vijojnë Dropull me qëllim zhvillimin e integruar të kësaj zone. “Dropulli është pjesë e një programi të madh siç është rilindja rurale, si një zonë me potencial të madh zhvillimi ekonomik dhe turistik”,-vijoi më tej Kumbaro duke theksuar se Dropulli merite investime që kanë perspektivë europiane. Pas Dropullit, Mirela Kumbaro, shoqëruar nga ministri Ditmir Bushati ka udhëtuar drejt Janinës për t'u takuar me emigrantët shqiptarë që jetojnë në shtetin fqinj. Kumbaro fillimisht falënderoi emigrantët dhe theksoi rolin e rëndësishëm të komunikimit dhe dialogut mes dy vendeve, duke qenë se në

shtetin grek jeton edhe numri më i madh i emigrantëve shqiptarë. “Duke qenë se në Greqi jeton dhe numri më i madh i emigrantëve shqiptarë, interesi jonë është mbarëvajtja dhe komunikimi duke menduar një hapësirë të përbashkët brenda Bashkimit Europian”,-tha Kumbaro. Deputetja e qarkut të Gjirokastrës prezantoi disa nga projektet e mëdha që qeveria “Rama 2” do të zhvillojë në qark, investime në rilindjen rurale të shumë zonave të harruara për t'i kthyer ato në atraksione turistike, duke krijuar kështu një model të qëndrueshëm zhvillimi.

KUR PRODHOHESHIN ARMË ZJARRI NË ELBASAN MË 1670

Në kuadër të 105-vjetorit të shpalljes së Pavarësisë së Shqipërisë, në hollin kryesor të Muzeut Historik Kombëtar u organizua ekspozita “Armë të mjesh-tërve shqiptarë”. Në këtë ekspozitë janë ekspozuar 47 objekte: 21 kobure, 8 pushkë, 10 vezme, 2 harbi dhe 6 jataganë. Armët ilustrohen edhe me gravura, me anën e të cilave pasqyrohet puna artistike e armëtarëve shqiptarë. Për të pranishmit në çeljen e ekspozitës dr.Dorian Koçi, Drejtori i Muzeut Historik Kombëtar shpjegoi se, nëpër vitrinat Muzeut Historik Kombëtar janë të ekspozuara mjaft armë origjinale, pushkë, kobure, jataganë, vezme etj., të prodhuara dhe zbuluara në mënyrë artizanale prej armëtarëve të kohës. Bukuria dhe teknika e punimit të armëve sh-



qiptarëve ka tërhequr vëmendjen e udhëtarëve të huaj por dhe figurave të rëndësishme të kulturës kombëtare. Eruditi dhe studiuesi i njohur i kulturës shqiptare, Faik Konica kur përshkruan zejtaritë e shqiptarëve ka thënë: “Dy kanë qenë mjeshtrit më të mira të shqiptarëve - argjendaria dhe qëndistaria. Armët e tyre ishin të punuara me argjend, por edhe të lara me ar”. Në fund të shek. XVIII dhe në fillim të shek. XIX pati një zhvillim të gjithanshëm të zejtarisë, përfshirë edhe zejtarinë e prodhimit të armëve. Disa nga qendrat më të rëndësishme të prodhimit

të armëve ishin në Shkodër, Prizren, Dibër, Berat, Elbasan dhe Janinë. Në Shqipëri të Shkodrës, Gjakovës dhe të Prizrenit qenë mjeshtrë në punimin e armëve dhe të objekteve të tjera prej metali. Por, duket se fama e armëve të prodhuara prej shqiptarëve ka shkuar shumë larg. Në Konkursin e Londrës, në vitin 1866, ato armë morën tituj nderi. Në Ekspozitën Universale të Parisit, në vitin 1867 pati armë dhe disa punime filigrani, të prodhuara në punishtet e Prizrenit, të cilat nuk qëndronin më poshtë se ato të armëpunuesve më të kualifikuar të Europës. Ndërsa në Ekspozitën Universale të Çikagos, të vitit 1894, që vendosur edhe një martinë, e punuar me mjeshtri të hollë nga dora e një armëtarit të talentuar nga Tetova. Ekspozita “Armë të mjeshtrëve shqiptarë” do të jetë e hapur në hollin kryesor të Muzeut Historik Kombëtar nga data 3 nëntor deri më 13 nëntor 2017.



NGA ARBEN NDRECA

Këto letra i drejto heshin Martin Camajt në vitin 1951 prej një vajze të re prej Beogradit, e cila po atë vit do të bahej edhe grueja e tij. Bahet fjalë për Nina Bogdanoviæ, e lindun në vitin 1924 në Beograd, në familjen e Dobroslavit dhe Dragës. I jati ishte avokat dhe nënkryetar i bashkisë së qytetit në vitet 1933-34.

Nina mbasi kishte studjue për dy semestra sllavistikë (rusisht, çekisht e serbisht) në universitetin Karlova të Pragës, detyrohet me u kthye në atdhe prej autoriteteve jugosllave dhe me vijue studimet në Beograd, ku edhe laurohet në vitin 1950. Po atë vit njihet me Martin Camajn, i cili studioonte romanistikë dhe thellohej në albanologji, i ndihmuem prej prof. Henrik Baria.

Martini dhe Nina martohen në qershor të vitit 1951 në Beograd, së pari në bashki e në fund në kishën katolike të Krishtit Mbret, tue pasë si dëshmitar martese Ndue Gjomarkajn dhe Skënder Kastratin.

Krijimtaria dhe puna kërkimore e Martinit në Beograd jan të pengueme prej autoriteteve komuniste, madje, mbas botimit të dy vëllimeve të para poetike, kritika e quen poet dekadent që tematizon gjana anakronike. Kjo gjë e vret shumë poetin e ri, e kështu çifti i ri vendos me shkue në Itali. Camaj mbërrin me kalue i pari në Romë, e atje i ndihmuem kryesisht prej ish-mësuesve të vet të kolegjit jezuit të Shkodrës, Atë Luigi Rosa dhe Atë Zef Valentinit, i përkrahun prej Ernest Koliqit, nis studimet në Universitetin e Romës.

Nina, e mbetun në Beograd, e sëmurë randë me veshka, vendos mbas gati një viti, në 1956, me shkue pranë të shoqit. E kështu, edhe pse në gjendje të keqe shëndetsore, mbërrin në kryeqytetin italian. Me ndihmën e Kishës katolike i mundësohet operacioni i kushtueshëm i heqjes së njenës veshkë. Jeta e çiftit të ri vijon, megjithë vështirësitë e mëdha ekonomike. Martini studjon në Romë, viziton kantundet arbëreshe për me hu-



Disa letra të panjohuna dashunie drejtue Martin Camajt

lumtue rreth gjuhës së tyre dhe bashkëpunon me *Shëjzat* e Koliqit. Ndërkaq nis me u afirmue si shkrimtar në rrethet kulturore të emigracionit. Në fundin e vitit 1961 shpërngulen në Milano, ku Martini mendonte se me ndihmëm

e Atë Luigi Rosa-ës do të mund të çante në botën akademike. Në pamundësi me u sistemue, vendos me shkue në München, ndërkaq Nina ndalet në Milano, ku do të japë gjuhën ruse, si asistente, në semestrin 1961-1962 në Bocconi. Në vitin

1962 do të shkojë pranë Martinit në München, ku ajo do të punojë për pak vite pranë *München American Elementary School* si mësuese dhe bibliotekare. Ndamja përfundimtare me Martinin ndodh në vitin 1968, dhe mbas

kësaj date Nina kthehet në Milano ku do të jetojë deri në nandor të vitit 1987. Mbas një parenteze njimbëdhjetëvjeçare në Beograd, në prag të luftës civile, ajo do të shkojë me jetue në München.



Vijon në faqen 14

Në këtë numër: Arben Ndreca, Shpëtim Çuçka për Dritëro Agollin, Derek Walcott sjellë nga Kujtim Morina, Feride Papeka, Aleksandar Qotriq sjellë nga Namik Dokle, Vasil Premçi...

A

ARGUMENT

Këto letra i përkasin pushimeve të kalueme në Zlatibor, një vend malor, në maj të vitit 1951, pak para martesës, ku Nina dhe Martini kishin shkue për arsye shëndetsore. Ajo tue qenë se viente prej veshkave, ndërsa Martini në të ri të vet, kur ishte nxanës në kolegjin jezuit të Shkodrës kishte vuejtë prej tuberkulozit. Letrat kanë një frymë të pastër e të freskët dashunijet. Dishmojnë për ndjeshmëninë e hollë të një vajze të re, që po bahej gati të ndante fatin e saj me shkrimtarin e madh shqiptar. Ato janë të shoqueme me disa vizatime të thjeshta e skofiare, që shprehin ambëlsinë e shpirtit të vajzës së re të dashnueme.

Letrat e vajzës së re

Këto letra i drejtoheshin Martin Camajit në vitin 1951 prej një vajze të re prej Beogradit, e cila po atë vit do të bahej edhe grueja e tij. Bahet fjalë për Nina Bogdanoviç, e lindun në vitin 1924 në Beograd, në familjen e Dobroslavit dhe Dragës. I jati ishte avokat dhe nënkryetar i bashkisë së qytetit në vitet 1933-34. Nina mbasi kishte studjue për dy semestra silavistikë (rusisht, çekisht e serbisht) në universitetin Karlova të Pragës, detyrohet me u kthye në atdhe prej autoriteteve jugosllave dhe me vijue studimet në Beograd, ku edhe laurohet në vitin 1950. Po atë vit njihet me Martin Camajin, i cili studiointe romanistikë dhe thellohej në albanologji, i ndihmuem prej prof. Henrik Bariae.



Çifti i ri

Jeta e çiftit të ri vijon, megjithë vështirësitë e mëdha ekonomike. Martini studjon në Romë, viziton katundet arbëreshe për me hulumtue rreth gjuhës së tyre dhe bashkëpunon me Shëjzat e Koliqit. Ndërkaq nis me u afirmue si shkrimtar në rrethet kulturore të emigracionit. Në fundin e vitit 1961 shpërngulen në Milano, ku Martini mendonte se me ndihmë e Atë Luigi Rosa-ës do të mund të çante në botën akademike.

NGA ARBEN NDRECA

Jeta e saj me shkrimtarin Martin Camaj ka mbetë pothuajse e panjohun, mbasi ajo vetë ka jetue e shmangun e në hije, por tue shfletue vëllimin poetik *Kanga e vërrin-ër* të vitit 1954, shohim kushtimin e Camajit për të: *Dhimbës s'ëme, Ninës. Martin*.

Ajo vetë nuk ka mbërrijit kurrë me e kuptue se çka ka dashtë me thanë me këtë kushtim, por i vjen ndër mend një shprehje e Dostojevskit: *Iubov stradanje*.

Ndoshta dashunia asht kryesisht dhimbë!

Këto letra i përkasin pushimeve të kalueme në Zlatibor, një vend malor, në maj të vitit 1951, pak para martesës, ku Nina dhe Martini kishin shkue për arsye shëndetsore. Ajo tue qenë se viente prej veshkave, ndërsa Martini në të ri të vet, kur ishte nxanës në kolegjin jezuit të Shkodrës kishte vuejtë prej tuberkulozit.

Letrat kanë një frymë të pastër e të freskët dashunijet. Dishmojnë për ndjeshmëninë e hollë të një vajze të re, që po bahej gati të ndante fatin e saj me shkrimtarin e madh shqiptar. Ato janë të shoqueme me disa vizatime të thjeshta e skofiare, që shprehin ambëlsinë e shpirtit të vajzës së re të dashnueme.

Këto letra, me sa kemi marrë vesh, i ka ruejt për shumë kohë i ndershmi dom Prenk Ndreveshaj, mik dhe bashkëpunor i Martinit në familjen e Shëjzave.

Zlatibor, Maj 1951

Prej këtu, prej postës të cilën e vizitoj shpesh, shihet ma qartë dritarja e tij. Jam përpjekë edhe me vizatue tue qenë se e shoh kaq shpesh. E si jo? Këtu ai ka kalue plot tre muej. Këtu për herë të parë ka fillue me mendue për me dhe të ndiejnë për me. Kam besim se ka me i pëlqye me e kuptue këtë shtëpi e atë dritare. Fatkeqësisht nuk kam aparat fotografik, por gjithsesi kështu ka me i pëlqye ma tepër.

Zlatibor, 11.5.1951

Vështroj shpesh prej dritares vilën nga ana tjetër e rrugës. Vështroj e si me qenë tue pritë që në dritare ose në shtegun që vjen kah ne të shfaqet ndokush mungesën

Disa letra të panjohuna dashunie drejtue Martin Camajit

e të cilit e ndjej kaq shumë. Asht dikush pa të cilin ajo dritare e ai shteg m'i bajnë sytë me lotue. A e kam parandie atëherë, në shtator, se shikimi do të m'u ndalte në dritaren nga ana tjetër e rrugës e në shtegun që vjen këtej. A e kam parandie se do të vinte dita që do t'i vështrojshe me kaq shumë mall?

Ky vizatim i jemi nuk doli gja aspak. Por megjithatë për të, vetëm për të, ka me pasë pak vlerë sepse ka me i kujtue "zabelin", e unë ma bukur nuk di me e vizatue. Sikur të kisha pasë ngjyra, atëherë do të kishte dalë diçka tjetër. Ndoshta do të kishte dalë shumë ma i bukur. Atë çka i mungon këtij vizatimi, e di se ka me ia plotësue krejtësisht kujtesa e tij.

N.

V. 1951 Zlatibor

... Dielli tashma perëndoi. Hana asht ba gjithnjë e ma e verdhë. Dolëm në lëndinën prej nga shikimi hapet drejt Çigotës. Ti m'a pate kallëzue njatë lëndinë. U pata mrekullue. Isha aq e qetë pranë teje, Tini.

Kur kemi me u ngjité së bashku në atë majë që kaq shumë të josh prej fushë! Dëshiroj që me ty me i ngjité gjithmonë në maja të nalta, gjithnjë e ma tepër...

Nina

Prej këtij vendi shihet një pjesë e liqenit dhe e malit, ato vila të bukura në Palisadë të cilat me catitë e tyne të kuqe në të gjelbrën e errët të pishave duken si me qenë shtëpi përallash. Njëpër atë rrugë që ndrën djathas patëm shtetit një mbramje kur përpara kthimit na zuni një shi i ngrohtë i kandshëm.

A e mban mend Tini?

N.



U pata lodhë. U ulëm në bar. Ti nxorre një fjalor të vogël frëngjisht-italisht dhe fillove me më lexue parathanien në italisht. Mbas teje u përpoqa edhe unë. E kur lexova nuk di për të satën herë "s" në vend të "z"-së, shpërtheva prej marazit me vetveten. Ti qeshe lehtas. Për herë të parë të ndigjova se qeshë kaq shumë.

Mandje pamë larg. U mrekulluem të dy prej atij perëndimi të bukur e të bekuem. Befas u ktheve e më the: "A don që çdo mbramje të shohim së bashku perëndimin e diellit?"...

A e mban mend Tini se si të dy përnjheri u patëm ngazëlye me pamjen e tufës së denve të bardha të shpërndame nëpër fushat e blerita dhe me tingëllimën e ambël të kumbonëve? Në këto ka diçka me të vërtetë të bekueme dhe qetësuese, kaq ngushlluese e kaq të dlijrës... pikërisht si njitash në kujtesën teme kur sjell ndër mend castet e kalueme me ty.

N.

Gjatë kthimeve prej shetitjeve shpesh i patëm ra nëpër këtë shteg, pranë hoteleve dhe pyjeve me pisha. U kthejshim tue lanë mbrapa çaste të mbushuna plot me bise- da me pak fjalë por me shumë mirëkuptim, çaste të bukura dhe të pastra siç janë të bukura edhe këto pamje të gjana të Zlatiborit, ky qielli i thellë i paskaj.

N.

Më kujtohet çasti kur për herë të parë pashe sytë e tu. Më ke vështrime me shumë vëmendje, me një shikim hetues dhe në atë shikim tandin kishte edhe mosbesim dhe shumë mbyllje në vetvete, e më vjen keq me e pranue, - por kishte edhe pak ironi. Kjo e fundit sigurisht si pasqyrim i mendimit tand të deriatëhershëm për gratë e ndoshta edhe si mbrojtje e përgatitun qysh ma përpara. A i kam ra në të?

Ai cast kaloi në terracën e kësaj vile. Prandaj edhe e vizatova. Por

edhe që të shohish këto dy dritare dhe të kujtohesh për atë vajzën të cilën nuk dëshiroje me e dashunue.

N.

Kemi ardhë disa herë nën këtë pemë. Njëherë, ndërsa ishim shtri nën këtë pemë dhe po shikojshim nalt nëpër degë qiellin, njëherë, këndoi një zog në rrem. Unë të thashë: Ndigjo, e ti vune në dukje: "Po a e ndigjon? Asht pak i trishtuem." Me të vërtetë ai za ishte pak i trishtuem. E porsa ma the, edhe unë vuna re se zogu ishte pak i trishtuem, vuna re se edhe ti je pak i trishtuem, e atëherë edhe në zemër teme zuni vend trishtimi... sepse në atë çast ndjeva sesa i afërt je për me e sa i largët.

N.

Kjo asht pamja prej vendit ma të skajshëm të shtetitjes sonë të fundit, Tini.

...Patëm heshtë tue shikue malet e largëta, të cilat gjithnjë e ma shumë u tretin në errësinë. Hesh-tën tue e ndi se diçka po kalonte e se duhej të thoshim lamtumirë, ndoshta përgjithmonë? O jo, jo përgjithmonë. Unë nuk dëshirojshe që ky të ishte fundi. Unë e dijshe se ky nuk ishte fundi...

Gjatë kthimit më the: "Ky muej këtu në Zlatibor dhe njohja me ty ka me më mbetë si kujtimi ma i dashun." Pse më pat dhimbë aq shumë ajo fjala e jote e fundit? T'u pata përgjigje me çiltërsi të trishtueme e krenare: "Nuk dëshiroj të jem kujtim për ty."

E tashti shikoj nga malet e nalta dhe prej shpirtit më del kujt lutje: "Jo, kurrë mos qofshim kujtim për njëri-tjetrin, por gjithëherë, përgjithmonë e tashme e gjallë dhe e bukur!"

Nina

Përktheu prej serbo-kroatish-

P

POEZIA

Diplomati dhe përkthyesi Morina na ka propozuar Walcott, me një përkthim aspak të lehtë nga origjinali. Autori na vjen me një cikël, ku duket lartësia e veprës së tij, por edhe figuracioni disi i vështirë për publikun tonë...

NGA DEREK WALCOTT*

Dashuri pas dashurie

Do të vijë koha
kur me një gëzim të papërshtuar
do të përhëndesësh veten tekta mbërrin
tek dera jote, në pasqyrën tënde
dhe secili do të buzëqeshë për ardhjen e tjetrit

dhe të thuash, ulu këtu. Ha, pi.
Dhe ta duash përsëri të panjohurin
që ishte vetja jote.
T'i japësh verë, bukë. T'i japësh zemrën tënde
kësaj vetje, të panjohurit që të ka dashur.

të gjithë jetën, të cilin e ke shpërfillur
për një tjetër, ai që të njeh përmendësh
Merri letrat e dashurisë nga rafti,

fotografitë, shënimet e dëshpërimit,
qëroje imazhin tënd nga pasqyra.
Ulu. Gëzoju jetës tënde.

Grushti

Grushti shtrëngohet rreth zemrës time.
Lirohet pakëz dhe i hap pak sytë
por ai shtrëngohet përsëri.
Kur nuk e kam dashur
dhimbjen e dashurisë? Por ky e ka kthyer

dashurinë e shkuar në mani. Ka mbërthimin
e fortë të një të çmenduri, kjo është
kapja pas tehut të paarsyeshmes, përpara
se të zhytet me ulërimë në humnerë.

Mbahu fort zemër. Kështu të paktën ti jeton.

Vdekja e një qyteti nga zjarri

Pasi puritani i ekzaltuar rrafshoi gjithçka përveç qiellit të kishëzuar
shkrova historinë prej dhjami të vdekjes së qytetit nga zjarri
nën një dritë qiri, që tymoste në lotë,
Doja të tregoja, në më shumë sesa dyll, besimet që u thyen si teli.
Gjithë ditën eca jashtë në mes të rrëfenjave të gërmadhave
I tronditur nga secili mur që qëndronte në rrugë si gënjeshhtar;
Lart ndrinte qielli i zogjve të gurëzuar, të gjithë retë ishin dengje
të shqyera nga plaçkitja dhe të bardha pavarësisht nga zjarri.
Pranë detit të vagëlluar kur Krishti ecte, unë pyesja veten përse
duhet që një njeri të derdhë lotë, kur bota e tij e pyllit dështon?
Në qytet, gjethet ishin letra por kodrat ishin një grumbull besimesh;
për një djale që ecte gjithë ditën, çdo gjethë ishte një frymë e gjelbër
Të rindërtosh një dashuri, mendova, ishte aq e pamundur sa
të bekohesh vdekjen dhe pagëzimin nga zjarri.

Mes vere, Tobago

Plazhë të gjera ku piqet guri.

Vapë e bardhë
Lumë i gjelbër

Një urë,
palma të përcëlluara të zverdhura

Nga shtëpia e gjumit të verës
duke u kotur në gusht

Ditë që kam fiksuar,
ditë që kam humbur,

Ditë që rriten, si bijat,
krahë që më mbajnë.

Një klithmë e largët nga Afrika

Era valëzon gëzofin e mushkëllyer
të Afrikës, Kikuyu , të shpejtë si mizat,
zdrahen në rrjedhat e savanës.
Kufoma të shpërndara si në një vend parajse
vetëm krimbi, koloneli i kërmës, klith:
Nuk shpreh asnjë dhembshuri mbi këta të vdekur të ndarë!
Statistikat justifikojnë dhe studiuesit nxjerrin
veçoritë e politikës koloniale.

Derek Walcott (1930-2017)

I lindur në ishullin Saint Lucia, një ish koloni britanike në Inditë Perëndimore në Karaibe, poeti dhe dramaturgu Derek Walcott ndoqi studimet fillimisht për pikturë por iu kthye letërsisë që në rininë e tij. Vepra e tij e parë që i siguroi njohje ndërkombëtare ishte përmbledhja e poezive "In a Green Night: Poems 1948-1960" (1962) (Në një natë të gjelbër), një libër që sjell Karaibet dhe historinë e tyre si dhe thellohet në plagët e kolonializmit dhe neokolonializmit. Përmes një karriere të gjatë dhe të shquar, Walcott iu rikthye vazhdimisht temave të tij të gjuhës, fuqisë dhe vendit. Më 1992, Walcott fitoi Çmimin Nobel për Letërsi me motivacionin "një veprë poetike plot shkëlqim, që mbështetet në një vision historik dhe është produkt i një angazhimi multikulturor". Që nga vitet 50 të shekullit të kaluar, ai e ndante kohën ndërmjet Bostonit, Nju Jorkut dhe Saint Lucia dhe ka punuar për shumë kohë si pedagog në Columbia University, Yale University, Rutgers University, dhe Essex University në Angli. Walcott ishte një dramaturg i njohur gjithashtu. Më 1971, ai fitoi çmimin Obie Aëard për dramën e tij "Dream on Monkey Mountain" (Ëndrra në Malin e Majmunit).



Çfarë po i ngjiet fëmijës së bardhë të capërlyer në shtrat?
të egërve, të përdorurve si hebrejtë?
Të bërë shoshë nga rrahjet, turrat e gjata ndërpritën
nga pluhuri i bardhë i ibises , klithmat e të cilëve
na kanë shoqëruar që nga agui i qytetërimit.
Nga lumi i tharë apo pllaja që gëlon nga bishat
dhuna e bishës mbi bishën kuptohet
si ligj i natyrës, por njeriu i drejtë
e kërkon hyjnimin nga dhimbja e pësuar.
Delirante si këto bisha nervoze, luftërat e tij
hovin drejt plëndicit të tendosur të daulles
ndërsa bën thirrje për guxim, ende ajo frikë e brendshme
e paqes së bardhë i ka hyrë në palcë nga të vdekurit.

Përsëri nevoja brutale i fshin duart
me pecetën e një kauze të ndyrë, përsëri
një humbje e ndjeshmërisë tonë, si me Spanjën,
gorilla përleshet me supermenin.
Unë që jam i helmuar me gjakun e të dyve,
nga t'ia mbaj, i përcarë në vena?
Unë që kam mallkuar
oficerin e pirë të sundimit britanik, si të zgjedh
ndërmjet kësaj Afrike dhe gjuhës anglishte që dua?
T'i tradhëtoj të dyja, apo të kthej çfarë ata më japin?
Si mund të rri përballë kësaj kasaphane dhe të jem gjakftohtë
Si mund të kthehem nga Afrika dhe të jetoj?

Blues

Ata pesë apo gjashtë të rinj,
që po hanin drekë, të kërrusur,
në atë natë vere saç të nxehtë
më fishkëllyen. Të këndshëm
dhe miqësorë. Kështu unë ndalova.
MacDougal apo Christopher,
rrugë në vargonjtë e dritës.

Një festival vere. Apo një ditë
shenjti. Nuk isha shumë larg
shtëpisë, por jo me shumë dritë
për një nigger³, as shumë e errët
Kuptova se ishim të gjithë një,
uop⁴, nigger, ciftut, përveç kësaj,

aty nuk ishte Central Park⁵
A po krekosem shumë?
E kuptoni drejt!
Ata e rrahin këtë nigger të verdhë,
të zi dhe të trishtuar.

Po. Gjatë gjithë kësaj skene, i trembur,
njëri përdori një thikë.
Unë vara pallton time të sapoblerë
sportive, jeshile në ulli
në një reklamë të ndriçuar.
Nuk bëra asgjë. Ata luftonin
me njëri-tjetrin, me të vërtetë.
Jeta u jepte ca shqelma.
Kjo është e gjitha, thika, hanxharë!

Fytyra ime e copëtuar, filxhani im i përgjakur
duke u derdhur. Xhaketa ime me degë ulliri
shpëtoi pa u grisur.
U zvarritta katër shkallë përpjetë
duke u kapur në një ulluk uji.
Kujtoj disa roje që ma bënin me dorë
duke thirrur, dhe nënën e një fëmije duke klithur
si "Jackie" apo "Terry"
"Mjaft më tani!"
Kjo nuk është asgjë, vërtet
Ata nuk marrin mjaft dashuri.

Ju e dini, ata nuk do t'ju vrasin.
Vetëm luajnë keq,
sic bëjnë të rinjtë amerikanë.
Por kjo më mësoi mua diçka
rreth dashurisë. Është e mundimshme.
Harroje atë.

Pas stuhisë

Kaq shumë ishuj!
Aq shumë ishuj sa ka një natën
në atë pemë nga e cila tunden meteorët
si frutat që bien përreth Schooner Flight⁶.
Por gjërat duhet të bien, kështu ka qenë gjithmonë,
në njërin anë Venusi, në tjetrën Marsi;
bien dhe janë një, tamam siç kjo tokë është
një ishull në arkipelagun e yjeve.
Miku im i parë ishte deti, tani ai është i fundit.
Pushoj së foluri tani. Punoj, pastaj lexoj,
nën dritën e një feneri të varur në direk të anijes.
Përqipem të harroj çfarë ishte lumturia
dhe kur nuk mundem, studioj yjet.
Nga njëherë jam vetëm unë dhe valët e shkumbëzuara
ndërsa kuverta bëhet e bardhë dhe hëna del nga një rë
si nga një derë dhe drita sipër meje
është një rrugë në dritën e hënës që më çon në shtëpi.
Shabina këndonte për ju nga thellësitë e detit.

Natën në kopshtet e Portit të Spanjës

Natën, vera e zezë i thjeshtëzon aromat
në fshat, mendon të paimagjinueshmen.

Myshku i zezakut, fshihet si djersa,
rrugicat kundërmojnë guackat e gocës së detit

Portokaj të vyshkur ngjyrë ari, mangallë me pjepër
Tregtia dhe dajret e shtojnë vapën.

Zjarr ferri apo bordell kur kalon në Park Street
Tallazi i batocës në fytërin e marinarit ka kaluar

me fosforeshencën e detit, dritat e një klubi nate
feksin si xixëllonjat në flokët e saj të trashë.

Të verbuar nga dritat e makinave, të shurdhët nga boritë e tak-
sive,
ajo ngre fytërin nga llamba e dobët e karbitit të zi

drejt yjeve të bardha, si qytetet, neonet vezulluese
që digjen për t'u bërë kurva si ajo.

Në agshol, hamalli e kthen qerren
e arrave të vjedhura të kokosit drejt shtëpisë.

*Përktheu Kujtim Morina

(Footnotes)

¹ Grupi më i madh etnik në Kenia

² Shpend uji në vendet tropikale

³ Nigger: emërtim pozhorativ për afrikanët.

⁴ Një fjalë shumë fyese për një person nga Evropa jugore vecanërisht për italianët

⁵ Parku Oëdor në Nju Jork.

⁶ I referohet një poeme të Walcott me subjekt udhë
timin e një burri (Shabine) me anije reth Karaibeve.

A

ARGUMENT

NGA SHPËTIM ÇUÇKA

Vijon

18. Poema "Baladë e re për komisarin" (1964) që në titull e ngacmon përsëri lexuesin e sotëm. E para, sepse kjo fjalë (për atë që e njih dësi italishten apo frëngjishten) shoqërohet me kuptimin "shef", sidomos "shef policie". Por për një lexues që e njih të kaluarën tonë të para tridhjetë vjetëve, termi ka lidhje me një figurë të caktuar funksionari, të ngarkuar me punën politike në njësitë ushtarake. Ndokush mund të sjellë ndër mend edhe figurën e komisarit në aksionet e rinisë. Dhe fare të paktë mund të jenë ata që mbajnë në kujtesë figurën e komisarit të formacioneve partizane gjatë Luftës Nacionalçlirimtare.

Jo! Duket sikur këtu nuk ka asgjë interesante, madje shumëkujti kjo fjalë mund t'i shoqërohet në mendje me një shije të pakëndshme.

Jeta ka treguar me kohë që mënyra më e mirë për ta harruar historinë, mënyra më e mirë për ta fshirë kujtesën historike të një populli, mbetet ndotja e kuptimit të fjalëve, nxirja dhe nxjerrja nga përdorimi e vetë fjalës, praktikisht mallkimi i saj. Dhe, siç dihet, është thënë që herët – pra, edhe besuar – se në fillim ka qenë fjala. Pas saj kanë ardhur edhe gjërat e dukuritë. Rrjedhimisht, forca të caktuara në historinë e njerëzimit kanë luftuar kundër përparimit duke mallkuar fjalë të caktuara, nocione të caktuara. Sigurisht, edhe duke përndjekur ata njerëz, të cilët me anë të fjalëve dhe mendimeve të caktuara sillnin idenë e asaj rruge, që të shpinte drejt përparimit.

"Balada e re për komisarin" trajton pikërisht figurën e komisarit të njësie partizane. Dhe që në vargjet e hyrjes na vjen e fuqishme thirrma e poetit:

O romantikë e atëhershme,
Mua me vete rrëmbemë,
Në ditët e ashpura, të etshme,
Pas komisarit shpjmë,
Të flas për kuvendet e tij në shtëpitë,
Ku flaka lëpinet kusinë,
Të flas si dëgjonin të rinjtë
Dhe pleqtë si mbanin habinë...

O kohë e komisarëve,
mos më lërë
Të ndryshkem në mendime,
Më merr; më hidh në zheg e në erë
Të viteve plot gjëmime!...

Sot njerëzit e kanë të vështirë të përfytyrojnë, pa le t'u duket romantik, një mjedis të tillë, ku flaka e zjarrit në vatër bën dritë duke lëpirë njëkohësisht kusinë e varur mbi zjarr, ku është vënë gatessa e thjeshtë e një shtëpie të thjeshtë. Dhe merret lehtë me mend që një thirrme e tillë, nuk është fare e besueshme sot, kur njerëzit e kanë më të lehtë të besojnë te lloj-lloj piramidash të mendimit e të veprimit, në të vërtetë lloj-lloj piramidash të mashtrimit. Mashtrohen dhe përsëri besojnë te mashtrimet e radhës!...


Ja, kështu ka humbur në shekuj përvoja e brezave njerëzorë. Ka humbur me vullnetin dhe në interes të atyre shtresave, që nuk e dëshirojnë kurrsesi përparimin e gjithë shoqërisë, por vetëm mirëqenien e tyre. Kjo është gjithë e vërteta e shkaqeve dhe arsyeve se përse njerëzimi në drejtim të marrëdhënieve shoqërore ka ecur më ngadalë se kërmilli.

Dhe për shkak të vrasjes së komisarit poetit i dolën nga zemra vargjet:

Autori vijon në shtjellën e aspekteve të ndryshme, që lidhen me krijimtarinë e shkrimtarit të njohur dhe që do të sjellin dhe argumente të tjera në numrat që vijojnë... "Kambana e Dritëro Agollit u ka bërë thirrje të gjallëve", -shkruan autori

DRITËRO AGOLLI

Historia harrohet, nëse e mallkon atë



Në nga poetët e tjerë ndryshojmë...

Ndodhka kështu në jetë:
Më parë mësuam me plumb të qëllojmë,
Pastaj u bëmë poetë!

Në këtë poemë-baladë prej rreth 250 vargësh është gdhendur me anë të fjalës historia e dhembshme e luftës së një populli për lirinë e atdheut dhe flakjen e shfrytëzimit shoqëror; flakjen e mjerimit shumëshkullor.

Kjo poemë-baladë nuk kërkon asgjë nga ata lexues, që nuk janë mësuar të mendojnë dhe të gjykojnë pa paragjykime në kokë. Ajo nuk është një libër i thjeshtë për të mitur. Është një himn i gërshetuar me dhembe për heroizmin e njerëzve të drejtë, ëndrra e të cilëve nuk ka qenë mirëqenia vetjake por e mira e të gjithë bashkatdhetarëve të shtypur e të shfrytëzuar jetë e mot. Sa për miturinë njerëzore dhe luftën për dije Kanti ka shkruar diçka të hollë:

"Iluminizmi është dalja e njeriut nga mituria e tij fajtoze. Mituri është pafujzia për të përdorur arsyen tënde pa udhëheqjen e një jeti. Dhe ajo është fajtoze, kur ka për shkak jo mangësinë e aftësisë intelektuale, por mungesën e vendosmërisë dhe të guximit për ta përdorur atë pa udhëheqjen e një jeti. *Sapere aude*: guxo ta përdorësh arsyen; kjo është parrulla e iluminizmit".

Kambana e Dritëro Agollit u ka bërë thirrje të gjallëve.

19.

Një fshatar rreth 15 vjet më i moshuar se D. Agolli mbante mend se besimi i tij të feja ishte shembur gjatë viteve të luftës në rrethana në dukje të zakonshme, që nuk kishin të bënin me ndonjë kurs të veçantë mësimor, por me zbulimin në praktikë se ç'përmbante një seli besimi, ku atij i kishte qëlluar për vite me radhë, si edhe bashkëfshatarëve të tjerë, të falej duke mbështetur ballin përdhe.

Poema "Rebelimi i parë" nuk ka datë, por nga renditja në vëllimin poetik "Poezi" na krijon bindjen se është shkruar rreth vitit 1967.

Si mund të harrohet historia

Jeta ka treguar me kohë që mënyra më e mirë për ta harruar historinë, mënyra më e mirë për ta fshirë kujtesën historike të një populli, mbetet ndotja e kuptimit të fjalëve, nxirja dhe nxjerrja nga përdorimi e vetë fjalës, praktikisht mallkimi i saj. Dhe, siç dihet, është thënë që herët – pra, edhe besuar – se në fillim ka qenë fjala. Pas saj kanë ardhur edhe gjërat e dukuritë. Rrjedhimisht, forca të caktuara në historinë e njerëzimit kanë luftuar kundër përparimit duke mallkuar fjalë të caktuara, nocione të caktuara. Sigurisht, edhe duke përndjekur ata njerëz, të cilët me anë të fjalëve dhe mendimeve të caktuara sillnin idenë e asaj rruge, që të shpinte drejt përparimit.

Dhe titulli i saj është shumë domethënës. Është historia në vargje e thyerjes së besimit fetar në shpirtin e një të riu, të rritur si të gjithë parardhësit dhe bashkëkohësit në të tillë klimë nderimi ndaj babait të teqesë, ndaj njeriut të fese:

Dhe dridhmat më dridhnin kur dilte në arë.
Parmendën gjyshi linte plot temena,
Ulej në brazdë në gjunjët e vrarë:
Hejvallah,

hejvallah,
hejvallah!

Dhe mua më shtynte: shko puthi dorën,
Se nxeht babai e gruri s'na piqet.
Se nxeht babai e kokërr nuk korrin,
Se nxeht babai dhe plevica na digjet!

Dhe unë me vrap në brazdë pengohesha
Gjersa t'ia puthja dorën babait,
Me hundë në plisa rrëzohesha:
Hejvallah,

hejvallah,
hejvallah!

.....
Eh, rebelimi i parë ndaj zotit
E nxeht gjyshin e shkretët...
Kjo ndodhi qëmotit
Në brazdat e arës tek ngjismin qetë...
Aherë dhe nënën përfishiu rebelimi
Dhe mbajti me mua një krah,
Dhe s'foli më fjalë trishtimi:
Hejvallah,
hejvallah,
hejvallah!

Sa joserioze, në të vërtetë qesharake, tingëllojnë sot fjalët, fjalimet, shkrimet e studimet për lirinë e fjalës e të besimit, për sa e sa liri të tjera! "Harrohet" liria e mendimit, liria e gjykimit, liria e botëkuptimit (ç'vlerë ka liria e fjalës pa lirinë e botëkuptimit?). "Harrohet" e drejta e njerëzve për dije, për drituri, për ta parë jetën drejt, pa shtrembërime (ndryshe si mund t'u bëhet thirrje njerëzve të besojnë që e shtrembra është e drejtë dhe anasjellas?). Po sikur vetë jeta të jetë e shtrembër? Po kur në të vërtetë vetë jeta e tillë është, e shtrembër? Dhe ç'mbetet pastaj: t'u bëhet thirrje njerëzve që të besojnë se kjo jetë është e pandreqshme dhe se e mira është vetëm në një jetë përtej varrit? Dhe t'u vënë veshin disa njerëzve të caktuar vetëm e vetëm për arsyen se këta njerëz vishen ndryshe nga gjithë njerëzit e tjerë dhe e paragesin veten si të veçantë, krejt të veçantë, përderisa ditkan ca gjëra për jetën dhe përtejjetën, të tjerët – pavarësisht se ç'janë, ç'shoklla kanë mbaruar e ç'njohuri kanë fituar – nuk i dinë?

Kësaj i thonë rrugë e verbër, rrugë pa krye. Rrugë e verbër në mendime, pra, rrugë e verbër në jetë. Se verbëria në mendime lind nga verbëria në jetë, nga një jetë e verbër.

A e kemi të qartë vallë se ku ishim dhe ku arritëm?

20.

Përgjithësisht në krijimet e D. Agollit thelbi, sipas një shprehjeje të Gëtes te "Fausti", shquhet që në emër, domethënës që në titull. Poema "Toka ime, kënga ime" është një tjetër



..nga numri i shkuar

"Milosao" i këtij numri ishte relativisht e zakonshme. Shkrimi kryesor iu la njërit prej legjendave të fotos shqiptare Petrit Kumi. Studiuesi Qerim Vrioni në vazhdim e interpretimeve të tij që u ka bërë fotove të ndryshme, këtë herë i është kushtuar një fotoje historike, që mban si autor Kumin dhe përshkruan pritjen e bukur të portierit të Besës. Kjo foto ka marrë një çmim ndërkombëtar në Moskë në evenimentin e vitit 1961 të World Press Photo. Një vit më herët, më 1960 në Beograd, Petrit Kumi ishte nderuar me "Diplomë", për-foton "Brigjeve të Adriatikut"(1959) në

konkursin ndërkombëtar të talenteve të reja të fotografisë. Petrit Kumi, mbetet një nga figurat më të njohura të fotografetarisë shqiptare, ai mban titullin "Artist i Merituar" dhe vlerësimin "Mjeshtër i Madh" i Republikës së Shqipërisë, ndërsa sot në pension mbetet një njeri i këndshëm dhe bashkëbisedues interesant.
Redaktori nxori si shqetësim kthimin e nostalgjisë komuniste. "Mendojmë se përcjellja e shumë emrave të zakonshëm apo akronimeve urbane të asaj kohe është fare normal në kohët moderne. Ato kujtojnë jetën sociale të shumë njerëzve, por edhe socializmin e publikut në atë kohë. Aman është tejet i tepruar përdorimi i sloganeve të komunizmit dhe gjoja

përshatja me tepri thjesht për raste përfitimi. Vetëm të kujtosh parullat ende të mbetura të pafshira në Spaç e kujton sa e hidhur tingëllon për kurrizin e shumë njerëzve, që u masakruan në atë kohë", shkroi ai.
Krijimtaria e këtij numri i përkiste Roland Gjozës, me një tregim, që duhet thënë se kishte një rrefim shumë të kujdeshëm që anonte në pjesën ndjesore. Kurse poezia i takonte poetit slloven Gašper Malej, që prej vitit 2009, është edhe kryetar e redaktor ekzekutiv i KUD AAC Zrakogled - një shoqatë kulturore jofitimprurëse me qendër në Koper. Ajo nga viti 2011 boton serinë "Hella", kushtuar përkthimit të librave fiction të autorëve bash-

këkohorë të Mesdheut, të tillë si D. Dmçdaj, N. Milani, F. Ebejzer, Z. Zlati, J.J. Millas, J. Nikolaidis, D. Velikiq, N. Fabrio.
Shkrimi kushtuar Elsie kishte një parabolë të këndshme por pak patetike të Besim Fushës, ndërsa ashtu si edhe në numrat e shkuar, vazhdon shkrimi për Dritëro Agollin, që këtë herë ne vendosëm të dilim me argumentin e titullit "poezia e një poeti është biografia e tij".
Në përgjithësi ishte numër i zakonshëm. E përsërisim dhe jo aq mbresëlënëse sa do të donim. Layout megjithë vështirësinë kishte punuar mirë.

shfaqje e madhe e besimit poetik, botëkuptimor, thjesht jetik, të Dritëro Agollit, një shprehje e shkëlqyer e letërsisë së madhe, e cila është e fillë, kur mban parasysh jetën e pjesës më të madhe të njerëzve të një shoqërie, e asaj bashkësie të madhe dhe vendimtare në histori, e cila quhet popull.

Ndaj kur i drejtohet tokës, D. Agolli i drejtohet burimit kryesor të jetës së njeriut, të jetës së popullit. Dhe sot, kur me tokën bëhet batërdia, poema e D. Agollit është e barabartë me një varg shuplakash që bien mbi fytyrën e pushtetit. Ashtu sikurse përmban një varg qortimesh të rënda për ne bijtë e kësaj toke e të këtij vendi, që lejuam të bëhet batërdia me dheun mëmë dhe që shpesh morëm pjesë në batërdisjen e tokës.

Le të shikojmë si e nis poemën e tij për tokën Dritëro Agolli:

Tokë e dashur,
ka tridhjetë e pesë vjet që diçka
ke kërkuar nga unë,
Tridhjetë e pesë vjet,
që kur kam hedhur të parët
hapa.

Kur bija mbi ty e vrisja duar e gjunjë,
Ti thoshe: s'ka gjë, biro, vritu e mos u kthe
prapa!

Ç'bëra unë për ty? Lërova, mbolla e korra
E shumë u mundova të të krijha me krehër
fisnikërie:

Me duart e mia të vrava rrënjët e liga, t'i
nxora

E thitha nga ti avuj dashurie.
Edhe kur më mërztinin plugu, parmenda,
S'të shava, se ati im, pastë ndjesë,
Kurrë s'të shante e kurrë s'të thoshte fjalë
të rënda,

Po ulej në gjunjë, të puthte i mbytur në
djersë.

Lexusve të sotëm – pse jo, duke nisur nga
mosha e shkollës – nuk do t'u bënte keq të
njiheshin me këto vargje e plot të tjera si këto,
të shkruara nga D. Agolli për tokën, për dhe-
un. Ndoshta nesër qëndrimi i tyre ndaj tokës
do të ndryshonte. Ndoshta! Ose, të paktën, kjo
do t'u shërbente si një dëshmi reale (jo si sa e
sa gjenështra të shitura si dëshmi reale!) se si
ishte parë toka nga paraardhësit e tyre, se si
ishte trajtuar ajo. Pastaj le të bënim – nëse do
të piqeshin nga pikëpamja shoqërore e kur të
piqeshin – një krahasim me veten. Jam i bindur
se pendesë më të thellë se ajo, që do të
provinin pas këtij krahasimi, nuk do të ndi-
enin kurrë!
Shkruan D. Agolli:

Tokë e dashur, unë s'mund të të lija djerrë.
Dhe, në ica me revolucionin mes shiut dhe
debërës,
Dhe, në ndërrova ca vite parmendën me
malihëre,
E bëra këtë që ty të të mbaja pastaj në
pëllëmbë të dorës.

E çfarë s'kam bërë për ty, tokë e dashur?
Unë shkrepat i shtyva në këmbët e malit
me supa.

- Shtyhuni pak, or byrazerë!, - u thashë –
E hapni udhën të kalojë buka! –

E mbajta për çdo rast malihërin pranë
Dhe vezmen e mbushur nën kokë.
Se s'dua të merrresh nëpër këmbë prapë,

Të mbetesh djerrë, o tokë!
Vetëm ai, që ka thithur avuj ugari,
Kupton se ç'do të thotë djerrë!
Djerrë do të thotë trishtim fshatari,
Trishtim që zvarritet ferrë më ferrë...

E dinë vallë sot banorët e vendit tonë se
ç'do të thotë fjala "djerrë"? E dinë ata që sh-
kuan të punonin tokën në vende të tjera duke
lënë shkretët tokën e tyre? Po njerëzit e poli-
tikës e dinë? D. Agolli shkroi për këdo që di të
lexojë. Dhe për këdo që dëshiron të lexojë. Por
nuk shkroi për ata që nuk dinë a nuk duan të
lexojnë, nuk shkroi për ata që dinë të flasin
edhe pa lexuar asgjë.

Shkruan D. Agolli:

Tokë e dashur, ti diçka ke kërkuar nga unë:
"Ndryshomë, o biri im!", - më ke thirrur
nga grykat e maleve.


E gërxhe përmbysa e ngrita diga në lumë
E u vura plugjet zalleve.

Tokë e dashur; më ra shorti i bujkut e shorti
i poetit:

Lëroj arë me plug e lëroj kartë me pendë,
Dhe gati kam qenë përherë

Të vadit kërcëllin e grurit me djersë e gjak.
...Ndaj kur sytë të mbyll dikë në ndonjë
brazdë,

Do doja të më mbështillje me qilimat e



kaltër të tu

E të merrje me fyell një kaba të lashtë,
E t'u thoshe udhëtarëve: "Fle biri im këtu!
Fle këngëtar i ugarit
I brazdave dhe zogjve!..."

Mbyllet këtu poema "Toka ime, kënga
ime". Pamja sot e tokës shqiptare nuk ndjell
asnjë kënaqësi, asnjë gëzim. Sa shpërdorime,
sa keqpërdorime, sa shkatërrime! Ndoshta
prandaj asaj nuk i kushtim më asnjëri ndonjë
poemë. Ç'poemë të shkruhet? "Poema e
shkatërrimeve"? Dhe shoqëria jonë sot, meqë
nuk arrin të nxjerrë dikë që t'i kushtojë
frymëzimin e tij poetik temës së tokës, dikë
që t'i kushtojë asaj vargje dashurie në emër
të vetes, pale më të të gjithë banorëve, kjo
shoqëri, e cila ka lejuar në realitet një posh-
tërim të pashembullit të vetë tokës, arrin
natyrisht të nxjerrë disa njerëz që ngrenë
dorën mbi figurën e D. Agollit. A ka simbolikë
më të dhembshme dhe më poshtëruese për

Ja për kë shkroi Dritëro

E dinë vallë sot banorët e vendit tonë se
ç'do të thotë fjala "djerrë"? E dinë ata që sh-
kuan të punonin tokën në vende të tjera
duke lënë shkretët tokën e tyre? Po njerëzit
e politikës e dinë? D. Agolli shkroi për këdo
që di të lexojë. Dhe për këdo që dëshiron të
lexojë. Por nuk shkroi për ata që nuk dinë a
nuk duan të lexojnë, nuk shkroi për ata që
dinë të flasin edhe pa lexuar asgjë.

ne, që jetojmë në kohën, kur toka shpërdoro-
het e shkatërrohet dhe kur këngëtarit më i
madh i tokës në histori të Shqipërisë sulmo-
het?

21.
Marrëdhëniet shoqërore!... Temë e gjerë!
Temë e trajtuar nga studiues të shumë fush-
ave, për shekuj e shekuj. E trajtuar mbarë e
prapë, kryesisht si çështje teorike, si çështje
leksionesh, kumtesash, artikujsh. Rralëherë e
trajtuar si çështje praktike, si çështje që
prek drejtpërdrejt jetën e njerëzve, jetën e sho-
qërisë, dhe trajtimi i së cilës ndikon në qën-
drimin në vend të shoqërisë ose përparimin e
saj.

Poema "Baladë e ashpër" e vitit 1968 merr
dhe trajton poetikisht këtë temë të madhe
praktike, merr dhe trajton një anë tejet të
rëndësishme të kësaj teme: çështjen e dashu-
risë dhe të martesës me dashuri.

Sot tema të ditës janë bashkëjetesat mes
njerëzish të dy gjinive (por edhe të të njëjtës
gjinii). Sot nuk flitet më për dashurinë, nuk
flitet seriozisht për dashurinë. Ato që ndesh-
en faqeve të shtypit mund të quhen fare mirë
modë dashurikash, të cilat anojnë pothuaj
tërësisht nga marrëdhëniet seksuale, sepse
ky edhe është kryesisht drejtimi që u jepet
marrëdhënieve të dashurisë.

Sot shoqëria nuk interesohet për mar-
rëdhëniet shoqërore, veçse kur ato kalojnë
në vepër penale. Shoqëria në të vërtetë nuk
kujdeset as për lidhjet e njerëzve, as për
mbrojtjen e këtyre lidhjeve nga grackat dhe
pusitë e një jete pa bosh të pa drejtimit, ku ka
vetëm një metër, një normë, një kanun: fiti-
mi.

Shqipëria e femijërisë dhe e rinisë së D. Ag-
ollit i kishte trashëguar nga shekujt mar-
tesën me mblesëri, domethënë martesën si
kontratë ekonomike, si puqje interesash lën-
dorë, ku vullneti i njeriut të veçantë ishte
pothuaj i barabartë me zero.

Dhe vargjet e poemës "Baladë e ashpër"
ngrenë pikërisht këtë anë të mprehtë të
lidhjes me dy njerëzve me synimin për të kr-
ijuar familje:

Po për cilin të stolisin
vallë,
Me gërshtëre,
me këna
e bojë,
Me të kuq e me "flori" në ballë,
Me këpuçë e me fustan të hollë?
Ç'mund të thuash
vazjë e xha Agushit,
Dhëndrin tënd ti kurrë s'e ke parë!
Derdhu sofrën ti raki e rrushit,
Plas në vend gërnët e palare!

Ej, pa ty s'e nisim ne makinën,
Nuk të lëmë shtigjeve të liga,

Krushqit do t'i ndalim, kur të vijnë
Gërxheve me lisa e boriga,...

Ndofta kjo nuk është aq e hijshme,
Duhet jeta ta dërrmonte ndryshkun
Dhe ta shkundte egër e furishëm,
Siç shkund era nëpër lisa myshkun,...

Më vjen keq të shkruaj këto vargje,
Vargje me mërzi e dhembje thurur!
Xha Agushi i ngrysur me mustaqe,
Ti në vjersha duhej të ishe mburrur!
Po ti mbahesh prapë në botën tënde,
Botën s'do ta prishësh,

s'do ta ndërrosh!

Ç'e zhubros fustanë e nusërisë
Vajza më e bukur e Agushit?!

Neë dimë,
s'mund të rrih në kullë,

Kënga jonë hyn nëpër dritaret,
Të thërrret të vish në hekurudhë,
Të thërrret sirena në binarët.

Ka një lidhje ndërmjet temës së martesës si
hap tejet i rëndësishëm në jetën e njerëzve, pra,
edhe temës së dashurisë si kusht për realizimin e
një lidhjeje sa më të mirë mes tyre, dhe temës së
poemës "Rebelimi i parë". Pak më sipër prekëm
çështjen e së drejtës së fjalës dhe nënvizuan fak-
tin që sot kjo çështje nuk lidhet me çështjen e së
drejtës dhe lirisë së njerëzve për të pasur men-
dime, gjykim dhe botëkuptim, me çështjen e detyr-
imit të shoqërisë për t'i edukuar qytetarët më
afësinë e të menduarit shkencor, e të pajisurit të
tyre me një botëkuptim sa më të plotë e shkencor:
E drejta për të pasur mendime, gjykim dhe botëk-
uptim nuk trajtohet në teorinë e sotme shoqërore,
nuk është objekt i përcaktimeve ligjore, dhe në
realitetin shoqëror nuk ekziston. Rrjedhimisht,
njerëzit e zhveshur nga e drejta për mendim,
gjykim dhe botëkuptim, janë të zhveshur edhe nga
e drejta për të vendosur lirish e në mënyrë të
ndërgjegjshme për fatin e jetës së tyre të ardhme.

Këto ishin çështjet më prehtja jo vetëm për vitet
'60 të shekullit të kaluar. Në vitet '60 ajo gjë e re që
ndodhi për herë të parë në mënyrë mbarësho-
qërore në Shqipëri ishte se çështja e fatit të mar-
tesës u cilësua para së gjithash si çështje e vull-
netit të vetë njerëzve që hynin në lidhje marte-
sore. Dhe shoqëria i dha zgjidhje kësaj çështjeje
të drejta, të barabarta e të ndershme në cif.

Edhe këtë arritje të madhe të asaj epoke koha
e sotme e përfoli duke e parë çlirimin e personali-
teit njerëzor si blasfemi e si mashtrim. Koha e
sotme mund të mburret vetëm që s'oli dhe përha-
pi dukurinë e fellikur të shtitjes së femërës për qe-
fjet e njerëzve të shturur; domethënë të njerëzve
me shumë para. Në këtë mënyrë ajo mori mbi
vete vullën e turpit historik që nëpërkëmbi
dashurinë dhe familjen, që nëpërkëmbi fatin
e vajzave dhe femijëve.

Përsëri një poemë-pasqyrë e D. Agollit, që i
vihet kohës së sotme përpara syve dhe në këtë
mënyrë i bën krijimet e tij të pakëndshme, të
padëshirueshme, të pabotueshme, të papopu-
llarizueshme. Kjo është e vërteta. Çështje
tjetër; pastaj, se ç'arsye mund të nxirren për të
mbuluar arsyen e vërtetë. Dhe si gjithnjë, kur
nuk duan të dalin hapur; argumenti më i fortë i
përdorur është thjesht...!..heshja!

vizon

1-(lat.) Merr guximin të mësosh!

ARGUMENT

Varreza e Vuksanlekaj, mes shumë varreve të reja katolike, fsheh rreth 30 varre të konfiguruar çuditshëm dhe që nuk kanë fare lidhje me të tjerat. Një simbolikë shumë e pazakontë e gdhendur në gurë-vare e tyre na rrëfen një histori, e cila për historianët shqiptarë dhe ata malazezë ka qenë e pamundur për t'u ndriçuar deri më sot...

Magjia funebre e Vuksanlekajve

NGA BEN ANDONI

E habitshme është se sa pak janë të interesuar shqiptarët e Malit të Zi për Varrezat e Vuksanlekajve. Duhet të pyesësh shumë, anipse pas pak të mjafton që me njohuritë e përcipta dhe idenë e një kishe katolike aty afër të kesh mundësojnë të shkosh drejt e vetë. Flitet për udhën që lë kufirin shqiptar në Han të Hotit dhe vetëm gjashtë kilometra më tutje, në drejtimin për në Podgoricë, gjendet varreza e shumëpërfolur. Një banor ka kontribuar për udhën dhe rrethimin. Emri i është shkruar shëmtuar me një si tabelë.

Për fat, kjo varrezë deridiku e mbajtur e banorëve aktualë nuk të jep asnjë ide se në mesin e saj mbart varret misterioze. Në fakt fshati ku shkohet quhet Qye e Dolecit (në Vuksanlekaj) të Malësisë së Madhe. Na duhet të pyesim dy të rinj, që i hasim teksa shkëmbehemi se ku janë varret. Nuk i kemi daluar dot. Vërtetë nuk kemi parë varret e vjetra. "Aty janë", na pohojnë dhe tundin kokën në pohim. Kur mohojmë, djemtë na thonë se duhet thjesht të futemi më brenda.

Pak internexo

Ende nuk ka një studim për këto varre, që sipas një ideje mund t'u përkasin Bogomilëve, por disa studiues i lidhin ato me fundin e shekullit të XIX dhe fillimin e shekullit XX. "Nuk dihet me saktësi se sa të vjetër janë gurët e varreve këtu, por hamendë-



sohet se datojnë nga fillimi i shekullit të njëzetë, apo nga gjysma e dytë të shekullit të nëntëmbëdhjetë. Motivet e artit popullor në gurët e varreve, kuptohet, janë shumë më të vjetra", shkruan mes tyre Elsie.

Varrezat e fshatit Qye të Malësisë së Madhe, janë të konfiguruar në mënyrë shumë të ndryshme. Ashtu si dihet, në ritin katolik, prehjet e trupave bëhen në varreza familjare, që zgjidhen në formën e varreve sakrale, kurse në disa syresh mund të kundrosh dhe vendet gati për pjesëtarët e tjerë të familjeve. Një ide është se ato janë të vjetra 200-400 vjet, por disa specialistë hedhin hipoteza për vjetërsi më të madhe. Në fakt, s'janë më shumë se 30 varre që po humbasin gdhendjet e stilizuara dhe figuracionet në gurë-varret e larta, që shkojnë prej 1 deri 1.50 cm, e që mbajnë drejtimin e kthyer me kokë nga perëndimi. Gdhendja e tyre është në



mënyrë specifike dhe është e bërë në pjesën e përparme dhe të pasme të gurëve mbivarrorë, aman në disa raste edhe në pak pllaka mbuluese. Lajm i keq është se ato pobjerren vazhdimisht dhe janë dëmtuar pa masë prej kushteve atmosferike. Lajm i mirë është se aktiviteti njerëzor këtu është gati minimal sepse njerëzit pothuaj mungojnë fare dhe nuk mund t'i prekin.

Kur futemi brenda territorit të varrezave shkojmë direkt, sipas udhëzimit të djemve, drejt e tek pjesa e brendshme, ku na shfaqen varret. Mrekullia e dekorimeve e konfigurimit e tyre janë vërtetë tërheqëse për këdo që ka interesa kulturore. Interesi shkoi tek disa varre pa emra, që veçojnë krejtësisht, paçka se edhe shumë varre pranë janë kretjt pa emra. E veçantë mbetet pjesa e gdhendjeve të tyre. Simbolika e tyre është kaq shumë e jashtëzakonshme,



saqë studiuesve do t'u duhet shumë për t'i identifikuar. Aty ke të gdhendura simbole nga më të ndryshmet, gjarpërinj, lloje kryqesh, rozeta të ndryshme, hëna të plotë, femra të stolitura, parzmore, simbolika si kryqe, gjysmë-hëna, forma-dielli, ylli gjash-të cepësh, rrrathë ciklikë, trekëndëshi, katrorët, një lloj stapi barinjsh, detaje nga bota shtazore dhe bimore, por edhe figura humane që nga një fëmijë e pa kokë, nëna me foshnje, burri i moshuar, shpatë, një t'i japë gjarpri i lakuar që mbi kokë ka gjysmë hënën dhe diellin apo një rreth që në brendësi ka një lule me gjashtë petale - apo diku edhe tetë, kryqit kelti i formës së iksit, brirë e dhisë mbi kryqin që ka formë të rregullt në gjerësi dhe gjatësi.

Duhet një studiues i shenjave që mund t'i japë drejtim këtyre shenjave, porse një gjë është e saktë. Shumica presin dikë dhe askush nuk



dund të gjykojë. Janë të shumë studiuesit nga Shqipëria që i kanë vizituar dhe kanë folur për to, por pa kush ka drejtuar si duhet një logjikë për konceptimin e tyre dhe ndihmën për hedhjen dritë të historisë së tyre.

A ndodh ngaqë shqiptarët se kanë traditën e varrosjes dhe respektimit të duhur? Ky është një aspekt. Aspekti tjetër është se në Shqipëri por me sa duket dhe në Mal të Zi kemi mungesë realisht të studiuesve që njohin realitetet. Për hir të së vërtetës, varret e vjetra, që kanë mundur të shpëtojnë prej shumë shekujve ose dekadave realiteve tona, pasqyrojnë një lloj kulture, traditë dhe historisë sonë, që lenë ende shumë për të dëshiruar.

"Shqiptarët nuk kanë një kulturë të zhvilluar të varreve. Madje shumë të rralla janë varret origjinale të mbetura në Shqipëri nga koha para Luftës së Dytë

Botërore. Arsyet kryesore për këtë mungesë janë niveli i lartë i shkatërrimit dhe vetë-shkatërrimit që ka kapluar trevat shqiptare në shekuj, si dhe kalimi i shumicës së shqiptarëve në fenë islame gjatë kohës osmane. Megjithatë kalimi fetar ka qenë më shumë formal se sa nga ndjenja e zjarrtë, dhe besimi fetar - qoftë mysliman, qoftë i krishterë - kurrë nuk ka qenë i fortë në Shqipëri, shqiptarët myslimanë përgjithësisht i kanë respektuar zakonet islame të varrimit. Kjo do të thotë se të vdekurit varrosen shpejt, mundësisht brenda 24 orësh, dhe se varri shënohet vetëm me një tog dheu ose me një gur të pagdhendur dhe anonim, sepse tradita islamike përgjithësisht i ka shkurajuar gurët e mëdhenj të varreve", na vjen në ndihmë sërish Elsie. Pavarësisht kësaj, kjo varrezë në mjediset shqiptare të habit.

Duhet të sqarojmë se sistemi i varreve të të krishterëve është tradicionalisht më i përpunuar, por edhe mundësi më të madhe për ta identifikuar. Ndryshe ndodh në rastin e varreve myslimane. Ndërsa sa i përket të tre katër komuniteteve fetare në vend ka një lloj papërgjegjshmërie sa i përket artit funebër, por edhe kujdesit ndaj varreve. Gjë që nuk e justifikon indiferencën ndaj kësaj varreze në Vuksanlekaj që po bjerret nga dita në ditë. Humbja e saj do të jetë një humbje e madhe, sepse ende nuk kemi arritur ta identifikojmë as në dhe as malazezët.

PROVERBA

PROVERBA

NGA ALEKSANDAR QOTRIQ

Vazhdojmë atje ku ishim - qëndrojmë!
1. Kemi shikim të mirë. Së pari shohim atë që nuk ekziston.
2. Jemi shoqëri multikulturore. Ketu kanë sukses shumë kultura bujqësore.
3. Bola është bërë fshat global. Këtë e besoj sa herë shelis ne rrugët e dyteleve tona.
4. Nuk e di se me çfarë shpejtësie ecën rryma elektrike. Ne disa fshatra ende s'ka arritur.

Namik Dokle vjen me një cikël të përkthyer proverbash të një autori të njohur serb. Libri, që është sjellë në ditët e fundit i përkthyer nga Dokle, përcjell një thellësi mendimi, por edhe një përpjekje për ta bërë të njohur këtë letërsi në vend...

5. Deri sa Serbia të bëhet shtet normal, ne mund të bëhemi anormale.
6. Momentalisht jemi keq. Dhe kjo është konstantja jonë.
7. Te ne gjasat janë aq interesante saqë janë bërë të demshme.
8. Kjo është tragjikomedi. Ne kemi humbur, ata qeshin.
9. Fati ndjek trimat. Të tjerët i ndjekin truporjat.
10. Fatkeqesia asnjëherë nuk vjen vetëm.
11. E t'herasim ne.
12. Përralla juaj nuk pi ujë. Na pi gjakun neve.
13. Gjithë problemet mund të zgjidhen me dialog.
14. Me kusht që ju të thoni vetem : PO!

13. Le të flasim si njerëz të rritur. Fëmijët thotë të vërtetën.
14. Kur nuk e zgjidhim një çështje të nxehtë, na mbetet të mbrohemi nga hiri.
15. Gjithçka ka shkuar në të s'emës, ama të paktën gjithçka është në të njëjtin vend.
16.



Jemi të detyruar të durojmë edhe dy vjet, por në të tretin do të jetë edhe më keq.
17. Te ne edhe vetë alternativa nuk ka alternative.
18. Nuk ka hajdut në radhët tona. Ata gjithçka e kryejnë jashtë radhe.
19. Demokracia është qeverisje e shumicës.
20. Më të rëndësishëm janë numrat nga argumentet.
21. Pas ndryshimeve demokratike nuk mund të njohim demokracinë për të cilën jemi përpjekur.
22. Te ne sundon pluralizmi. Mundet kështu, por mundet edhe ashtu.
23. Thuaj që je më mirë! Që të mos behet më keq!
24. Nuk është diktaturë totale,

sepse një njeri gëzon të gjitha të drejtat.
24. Jo që nuk shihet dritë në fund të tunelit, por ne nuk shohim as tunelin.
25. Optimistët kërkojnë dritë në fund të tunelit.
26. Pesimistët nuk futen fare në tunel.
27. Dhe ne kemi kalë për hipizëm. Të tjerët garojnë me makina.
28. Kozmopolitit te ne e shohin si alien.
29. Anija jonë nuk lundron. Tashmë ka kurs të sigurt drejt fundit!
30. Janë shkatërruar të gjitha shpresat. Nuk është gjetur as kutia e zezë.
31. Atlantida jonë është mbytur në detin e aferave.
32. Nuk i besoj nekrologji, shkruajnë gjerat me të bukura.

Të sotmit fajesojnë të kaluarën për të sotmen.
E kaluara fajëson të sotmen për të ardhmen.
33. Jetojmë më mirë.
34. Në krahasim me çka na pret.
35. Dalja ekziston, por s'ka kthim prapa.
36. Më të mirët largohen nga vendi. Shteti gëzohet që ata na përfaqësojnë para botës.
37. Dy të tretat e të rinjve emigrojnë. Një e treta tashmë ka emigruar.
38. Në botë më denjësisht na përfaqësojnë ata që ne i kemi përzënë jashtë.
39. Rinia është gjenerata që ikën.
40. Gjithnjë e më pak të rinj bëjnë gat valixhet.
41. Nuk kanë ç'të marrin me vete.

L

LETËRSIA

NGA VASIL PREMÇI

Romani "Nomeja e largët" përjetoi fatin e një genie njerëzore; fëmijërinë si novelë me titullin "Katër orë larg shtëpisë" dhe më pas në gjininë e romanit, burrërinë ose moshën e pjekurisë. Botimi i tij nuk kaloi pa rënë në sy të kritikës letrare dhe kolegëve të autorit, Faik Ballanca, si atëherë, por edhe sot pas kaq vitesh. Por ajo që ndodh rëndom me romanet që shkaktojnë diskutime në botën letrare nuk u përjetua nga vetë autori ose më mirë të themi, ndodhi si atij bujkut të pafat, që edhe pse mbolli me kujdes e dashuri arën, në fund, nuk arrin të gëzojë të korrat e prodhimit të pritshëm...

Nuk mund të mos vemë në dukje faktin se, në vitin 1975, ky roman ju ktheu dy herë autorit nga Shtëpia Botuese "Naim Frashëri", si një roman i pabotueshëm për shkak se nuk mishëronte apo nuk u përgjigjej normave të realizmit socialist. Romani pa dritën e botimit në vitin 1989, shumë vite pas vdekjes tragjike të autorit.

Nisur nga këto rrethana, por ca më shumë edhe nga mënyra si është ndërtuar e konceptuar ai, nga idetë që kërkon të transmetojë nëpërmjet përmbajtjes dhe heronjve dhe në veçanti të jetës së personazhit më të spikatur të tij, Bendos, romani meritoi një vëmendje të veçantë. Sigurisht leximet dhe interpretimet e ndryshme të romanit kanë të bëjnë me formimin letrar-artistik të lexuesit, shijet dhe nivelin e tyre, por edhe me aftësitë dhe mjeshhtërinë letrare të Faik Ballancës e dëshmuar më parë në mjaft tregime dhe novela të spikatura, si bie fjala "Mbama pak pallton, çun!", "Kënga e fundit e Marko Boçarit", "Njerka" "Shtigje me helm", "Ifundit", etj.

Nga shkrimtarët dhe studiuesit e letërsisë janë dhënë vlerësime të larmishme, konvergimi i të cilave u përcjell lexuesve veçoritë e stilit letrar të Faik Ballancës dhe ngarkesën e përfytyrimit që e dallon në tërësi krijimtarinë e tij letrare.

Përkundur qëndrimin zyrtar të redaksisë së lartpërmendur, shkrimtari i mirënjohur Ismail Kadare ka shkruar:

Faik Ballanca

"Romani Nomeja e largët i Faik Ballancës më pëlqeu. Asnjë nga akuzat që i bënë redaksia nuk qëndrojnë. Ky është romani i tij i parë dhe çuditëse se si ka mundur të realizojë një strukturë kompozicionale të tillë, sa të vështirë aq edhe moderne".

Studiuesi i letërsisë Spiro Gjoni, në analizën që i bën novelës "Katër orë larg shtëpisë", botuar në monografinë për krijimtarinë letrare të Faik Ballancës, "Paradigmat e një krijimtarie", shprehet: "Nuk themi ndonjë gjë të re

Autori na sjell një vështrim të romanit "Nomeja e largët" të Ballancës. Nisur nga këto rrethana, por ca më shumë edhe nga mënyra si është ndërtuar e konceptuar ai, nga idetë që kërkon të transmetojë nëpërmjet përmbajtjes dhe heronjve dhe në veçanti të jetës së personazhit më të spikatur të tij, Bendos, romani meritoi një vëmendje të veçantë, shpjegon autori duke shtjelluar argumentin e tij...

"Nomeja e largët" i Faik Ballancës, një roman ekzistencialist

(kritika e ka shprehur dhe pranuar prej kohësh) nëse pohojmë faktin që edhe te novelat Ballanca ka në fokusin e tij temën e së shkuarës dhe temën bashkohore (të përqendruar kryesisht në problemet e sferës etiko morale), (faqe 72)

Kritikat që shoqëruan botimin e novelës "Katër orë larg shtëpisë" vinin në dukje se, "konflikti është thuarë inekzistent" ...konflikti është shumë i nëpërtësishëm gati të duket sikur ai nuk ekziston fare" (D.Dilaveri, Nëntori 1973/8 f.99).

Në librin e sipërcituar, Spiro Gjoni, shpreh mendimin se, konflikti në novelën "Katër orë larg shtëpisë", unë do të shtoja, edhe i rikonceptuar tashmë në romanin "Nomeja e largët", ekziston dhe shfaqet apo mishërohet të "një numër personazhesh" të romanit, "që, për arsye nga më të ndryshmet, ...manifestojnë kundërshtit reciproke, pakënaqësi apo përplasja nga më të thjeshtat deri tek më të ndërlikuarat qefmbetje, mërzitje, debate, acarime apo grindje të cilat natyrshëm janë pjesë e jetës." (faqe 83)

Ngjarjet e këtij romani zhvillohen fill pas Luftës së Dytë Botërore e cila la pas shkatërrime dhe vdekjen e miliona njerëzve. Romani ka në qendër jetën e përditshme të një grupi blegtorësh, njëri prej të cilëve është edhe Bendo, një ushtar i huaj i mbetur pas luftës në një fshat të Shqipërisë së jugut. Si çdo vepër artistike që ngrihet mbi një rrethanë mbizotëruese, romanin e "udhëheq" si filli i Arianës Tezeun, jeta e djeshme me episode tragjike, si ushtar armik dhe ajo e sotme, me përpjekjet e Bendos për t'u martuar. Ai kërkon të ndërtojë jetën e vet familjare duke u lidhur me Bardhën, një vajzë të cilës po ikte moshë, por edhe që vuante nga një cen fizik, sepse ishte e çalë.

Pra, personazhi Bendo, një ushtar i mbetur nga Lufta në ato troje, si një bimë e djegur nga shkrepetimat e Luftës, kërkon të ngrejë krye dhe të gjallojë duke u martuar me Bardhën, një vajzë nga fshati në të cilin zhvillohen ngjarjet. Nga biseda midis tyre nuk shfaqet ndonjë konflikt i ashpër e përfundimtar, përveç faktit që vajza ja ka lënë në dorë fatin e saj të atit. Pikërisht kjo linjë intimo-lirike është edhe çimentua që lidh dhe krijon një udhë disi të fshatit nga faja në të roman.

Edhe banorët e fshatit në tërësi nuk ja pranojnë këtë kërkesë Bendos, ndonëse nga ushtari i huaj Bendo, tani ka mbetur vetëm një njeri i shushatur, i heshtur dhe i vetmuar, që rri natë e ditë në stacionin malor me dhen. Me sa duket ai do të mbetet për ata përherë,



Faik Ballanca

pushtuesi i dikurshëm që erdhi t'i shuante me zjarr e hekur. Autori e mban të kaluarën e Bendos pothuajse në "një errësirë informative". As më shumë dhe as më pak se portreti i një ushtari armik, i mbetur pas luftës. Figura e tij engimatake e rrethojnë mjaft legjenda dhe hamendësime...Por në roman pulson dukshëm ideja e dashurisë së pafat e Bendos ndaj Bardhës...

Të gjitha veprat e mëdha letrare, njësoj si konstruksionet e ndërtesave mbahen nga një armaturë e qëndrueshme mbi të cilën ngrihen katet e tjera, pra, mbi një konflikt që zhvillohet nga faja në roman.

Meqenëse si në novelë ashtu edhe në roman, bën majë dhe mbetet e pandryshuar linja e dashurisë së Bendos me Bardhën, veçojmë se, në analizën e novelës "Katër orë larg shtëpisë", Spiro Gjoni shpreh: "...konflikti qëndror në novelë nuk është mes Bardhës dhe Bendos, por mes tij dhe fshatit (banorëve të tij) por edhe shokëve të kolektivit ku ai punon. Në vijim të studimit, S.Gjoni e pohon faktin e mungesës së konfliktit midis Bardhës e Bendos. "Por në tërësinë e veprës, nënvizon ai, konflikti ekziston, edhe pse pak si i fshehur". (faqe 89)

Përpjekjet për të mbështetur apo gjetur konfliktin në këtë vepër letrare të krijon përshlypjen sikur në këtë mënyrë dhe me këto argumente kërkohet gjilpëra në



kashtë. Ja njëri prej tyre:

"Në vend të një konflikti të hapur, që do t'i jepte veprës tjetër pamje, shkrimtari ka preferuar apo, më saktë, ka zgjedhur ta ruajë goftë edhe "inegzistent" këtë konflikt nëpërmjet mjeteve e mënyrave të tjera, të pëlqyera e të realizuara me sukses prej tij.

Unë mendoj se për të kuptuar mesazhin dhe natyrën e një romani të kësaj natyre, në dukje pa një konflikt të shfaqur në mënyrë tradicionale, duhet zbuluar kodin artistik e filozofik i veprës. Ndryshe, çdo studiues është i detyruar t'i vijë rrotull episodeve, dialogjeve ose ngjarjeve të romanit pa e gjetur e zbuluar atë, madje duke shfaqur herë pas here inkoherencia, herë duke pohuar që vepra nuk ka konflikt të hapur, dhe herë duke argumentuar se ai "mishërohet tek "një numër personazhesh" të romanit, "që, për arsye nga më të ndryshmet, ...manifestojnë kundërshtit reciproke, pakënaqësi apo përplasja nga më të thjeshtat deri tek më të ndërlikuarat qefmbetje, mërzitje, debate, acarime apo grindje të cilat natyrshëm janë pjesë e jetës." S.Gjoni, "Faik Ballanca-paradigmat e një krijimtarie". (faqe 83)

Sipas mendimit tim, kodin artistik e filozofik të këtij romani e përbën fakti i të qenit një roman i drejtimit ekzistencialist. Sikurse vumë në dukje më lart, thelbi i romanit ndërthet jetën e një ushtari ish-armik, Bendos. Megjithatë Lufta ka përfunduar prej kohësh, ekzistenca e tij e mëtejshme përcaktohet nga thelbi, pra, të qenit dikur ushtar armik.

Është me vend të kujtojmë se, shkrimtarët që "themeluan" drejtimin letrar të Romanit të Rishtruar para vetes pretendimin që ky drejtim i ri letrar duhej të udhëhiqej nga ideja e kapërcimit të intrigës dhe e përshkrimeve, madje dhe e vetë personazheve.

I vetmi përrua rrjedhës që i shpëton përrua faqet e Romanit të Ri duhet të jenë dialogjet e zgjedhu-

ra, të cilët janë edhe "buka e gjelbra" e këtij drejtimi.

Veprat letrare të këtij drejtimi letrar: të Xhojsit në Angli, të Prustit në Francë dhe të Kafkës në Pragë, shpërfaqin pikëpamjet se: "Bota nuk mund të njihet, e keqja është e plotfuqishme, ndër-sa vetmia e njeriut është e pas- shërueshme dhe e pakapërcyeshme." (Prust)

Në kohën kur u shetua dhe u shkrua romani, "Nomeja e largët" i Faik Ballancës, rryma filozofike e ekzistencializmit shijonte pranverën e vet të lulëzimit në Francë dhe në disa prej vendeve më të zhvilluara të Europës. Njohja e gjuhës frënge nga F. Ballanca dhe natyra e tij kërkimtare nuk lënë aspak dyshim për njohjen e letërsisë bashkëkohore frënge dhe të veprave të Zhan Pol Sartrit. I mbiquajtur shkrimtari dhe filozofi i identitetit dhe ekzistencës, Sartri, kishte botuar veprat filozofiko-letrare: "Imagjinata" (1936), "Përparësja e Egos" (1937), "Neveria" (1938), "Muri" (1939), "I imagjinuari" (1940), "Qenia dhe Hiçi" (1943), "Rrugët e lirisë" (1945), "Ekzistencializmi është një humanizëm" (1945), "Duart e pista" (1948), "Djali dhe zoti i mirë" (1951), "Kritika e arsyes dialektike" (1960), "Fjalët" (1964).

Madje kaq të popullarizuara u bënë pikëpamjet e tij ekzistencialiste, sa që pas botimit në vitin 1964, të librit autobiografik, "Fjalët", ju dha edhe Çmimi "Nobel" në fushën e letërsisë, të cilin ai e refuzoi.

Përgjithësisht temat mbizotëruese në filozofinë ekzistencialiste, por edhe të këtij drejtimi letrar, bëhen: Tensioni në mes të individit dhe shoqërisë, vdekja, asgjëja, angështia, paranoja, refuzimi i shkencës dhe shpjegimit të saj shkak-pasojë dhe paraqitja e autenticitetit si norma e vet-identifikimit e lidhur me idenë e vet-përcaktimit nëpërmjet lirisë, zgjedhjes dhe përkushtimit, si edhe theksimi i tipareve rrethnore të mendimit dhe arsyes.

Sipas filozofisë ekzistencialiste, njerëzit janë të zhytur në një mori situatash, ku u duhet të bëjnë zgjedhje. Disa zgjedhje janë të parëndësishme, të tjerat janë të rëndësishme, por zgjedhja është individuale dhe vendimet shpesh në përkufizimin e vetvetes. Njeriu krijon përkufizimin e vetvetes dhe me këtë formon thelbin e tij.

Sartri shkruan: "Natyra e realitetit për ekzistencialistët është subjektive dhe gjendet brenda individit. Bota fizike nuk ka ndonjë kuptim të trashëguar jashtë ekzistencës njerëzore. Zgjedhjet dhe standardet individuale janë më të rëndësishme se standardet e jashtëme. Ekzistenca vjen përpara çdo



Vijon në faqen 20

A

RETROSPEKTIVE

NGA FERIDE PAPLEKA

SCODRA¹

Tije vend i shenjtë,
Oyteli ku u lindi.
Të njoh dhe nuk të njoh.
Tij kujtim dhe harresë,
Hijë dhe dritë.
Shkodër,
Në netet e mia ti vjen,
E largët dhe heroike,
E ngrirë në pikën e vdekjes,
Në Rrethimin e Dytë
I shoh bijtë e tu duke kapërcyer detin,
Për t'i ikur roberisë.
I rishoh ëndrrat e tua të mbytura në histori.
Lexoj Marin Barletin,
Një nga të mbijetuarit e tu
Që si në një testament dashurie,
Kujton ditët e lumtura në Shkodër
Dhe flet për Gjergj Kastriotin,
A mos jam edhe unë,
Një nga të mbijetuarit
E këlth vendi tashmë të përmblytur?

ILUZION APO
E VERTETE

Këto peizazhe
Tjeter herë s'i kam parë,
Tërë fytyrat më duken të panjohura,
S'e kuptoj fare gjuhën që flasin,
Kam harruar cilin jam,
Nga vij, ku shkoj?
Diku
Në katakombet e këlthj shekulli mjeran,
Më janë ngatërruar vitet.
E unë heq zvarrë
Një jetë të paqenë,
Në një planet të hamendësuar.
Mbase është *Tion Uqbar Orbis Tertius*,
Ku më pret i perëndishmi Borges
Duke shfletuar "The Anglo-American Cyclopedic"²

LUMI I HERAKLITIT

Fushë e korrur,
Femijë që luajnë
Dhe bagëti që kullosin në kallamisht
Gjithcka është larë me shkëlqimin
E diellit perëndues.
Shlëpiteme duket si të përmblytur
në dritë e ngrohtësi.
Ngjyra e dheut të kodrave
Më kujton të kuqen e Onufrit.
Më tej malet e hirtë.
Shndërrohen dalngadale në argjend.

Autorja e njohur na ka propozuar këtë cikël, me një përzgjedhje krejtësisht të saj. Brishtësia dhe delikatesa e ndjenjës e vesh të gjithë këtë cikël poetik duke na dhënë një botë të gjerë dhe shumë kërkuese ndaj kanoneve estetike prej autores...



Këtë peizazh nuk do ta shoh më
Nesër diellin, kushedi, do ta kenë mbuluar retet;
dhe shpirti i mi...
oh, shpirti i mi,
ndoshta s'do ta ketë më këtë mrekullim.

Peshkopi, korrik 1994

MESIMI I ZOGUT

Një vogëlushe më tregoi një përrallë:
(Nuk e di në e kish lexuar gjekund),
për një zog që doli nga veza
dhe pasi shëlliti një çast mbi tokë,
u kthye i lemeritur
që të futet prapë atje ku ishte.
- Njerëzit janë shumë të keqinj,
kishë themë.

KERKIMI I SE
VERTETES

Mos është ende herët?
E kaluara dhe e tashmja më mashtrorin:
me çastet e tyre të pasigurisë,
me çastet e tyre të nguljes,
me shpresën e vakët që ngrysi ditët,
me gëzimet efemere,
që i kam harruar.
S'më mjafton e Vërteta e Kryqit,
as e Vërteta e Zjarrit,
as e Vërteta e Gjaku të derdhur lumë,
as e Vërteta ime - Kauzë e Humbur.
Dua të Vërtetën e të Vërtetave.
Kushedi, atë s'do ta gjej kurë.

SHI VERE

Mbi qytetin e zjarrtë bie shi
Shi i dendur si perde dimërore

Toka e tharë gëzon
Prapa qelqeve të dritares
Unë e shoh këtë shfaqje të natyrës
Rrugët zhduken
Ndërtesat marrin forma të turbullta,
Oyteli shtrëmbërohet
Dhe unë përlytyroj kohëra luftërash
Por jo vetëm të moçme
Shekulli XXI gjithcka e ka postmoderne,
Kuptohet edhe luftërat.

KUR JE 20 VJEÇ

Tim biri, Orionit
Kur je 20 vjeç
Të gjitha rrugët
Të duken të drejta e të arritshme.
Oieelli është përherë i yjezuar me ëndrra.
Lulet nuk i bjerrin asnjehere petalet.
Një balon i blertë të duket dielli
Apo mbase një portokall i kuq.
Një zog që këndon ditë e natë është dashuria.
Gjumi vjen pa trokitur.
Të gjitha fytyrat janë të këndshme.
Lojë fjalësh është trishtimi.
Efemerja është e pavdekshme.
Dhimbja është një planet i panjohur.
Një portë e hapur për mirësi është shpirti.
Realiteti është një ide poetike.
Shpëtimja e të gjithëve është bota.
Kur je 20 vjeç...

PARIS

Unë të kisha sjellë mundimshëm
Në ëndrrat e mia.
Në këtë qoshe të harruar të Ballkanit.
Ti ishe llaharishit i bukur.
I tejdukshëm si kristal.
I hollë si një fije e re bari.
Të ndriste balli nga mendimet,
Në zemër të buronte miresia e botës.

Herë-herë të merrja në duar si lodër
Dhe flisja me ty në gjuhën sanskrite,
Në Champs Elysées degjoja "Nocturnes"
Të Claude Debussy-se,
Jeanne d'Arc qëndronte ende mbi kalë
Prapa portës Saint Honoré
Me një pellg të kuq gjaku në supin e majtë.
Dhe Proust që nga "Père Lachaise" më thosh
'Eja !'
Për t'i sjellë një ditë dhjetori të vitit '93
Një trëndafil të kuq mbi varr.
Tani jam këtu
Si Eva në Eden
Nga t'ia nis nuk e di.

Paris, dhjetor 1993

PEIZAZH NE
POGRADEC

Dita po mbaron
Copezat e saj të fundit zhyten në liqen
Të trembura nga nata.
Papritmas qielli çel lule të bardha,
Si të ishte zemër e dashuruar
Pasqyra gjigante e liqenit
Shndërrohet në lëndinë qiellore
për t'u zgjuar në mëngjes
në krahe kalterie.

TI ISHE QIELLOR

Ti ishe qjellor,
M'u desh të behesha me flatra për të të mbërritur,
Koha pas meje rrëshqiste si trëndafil i reres,
Ditët e mia i ngjanin Spirales me ëndrra
Që e turbulluan Gëten.
Duke ardhur drejt teje,
Sy burrash të tjerë më kanë vështruar,
Sepse çdo grua është një Tokë e Premtuar,
Por mua të tërë më dukeshin Zola pa qjell.

ÇASTE

Ndonjëherë,
Në mes të natës,
Zgjohem e lemerisur.
Një makth me mberthen:
Zëri yt hyjnor.
A është arratisur ai nga shpirti i mi,
Apo ende aty banon?

RREFIMI

Sa e gjatë ishte java!
Dhe horizontet plot mjegull qenë,
Njerëzit e njohur.
Çtëra zbrazëtit!
Por unë jetoja tjetër kohë,
Në një vend të largët,
Midis trendafilave të Bengalit.
- Që të parë nga lartësia e kaltra,
Shfaqen me forma zjarresh të veckel-.

Me imazhin tënd në sy
Dhe me zërin tënd të skallitur në shpirt,
Duke shtrënguar zemrën,
Zemrën time të brishtë
Që si një zog kreuji i përgjakur
Endërron fluturimin e mbramë.

FAQE
AUTOBIOGRAFIKE

Cila jam unë?!
Jam koha ime
E copëtuar në vite, muaj dhe javë,
Në ditë dhe net
Dhe në çaste tragjike fare të vogla,
Si ora 12, 25 e 22 Janarit '96,
Kur vdiq im atë.
Jam syri i tij lules,
Atë të Henë të zymtë,
Për të cilën më thonë se shkelqente nga dielli,
Por nuk dua ta besoj.
Jam rregëlima e tij e mbramë.
Jam apokalipti i tij.
Sot s'jam gjë tjetër.

22 korrik 1996

NE STRUGE

Dielli u lind
Dhe hëna nuk do të ikë
Unë magjepsëm nga qielli nator
Peshpërimat e mia të lumtura
Fluturojnë në ajër
Dhe përshkëlqojnë hapësirat
Si pellumba të bardhë.
Pastaj unë bëhem valë
Përsëritëse e përmalluar
Vajtim shekullor
Në ujën e mermerit të *Dritin të Zi*
Dhe kapem te ura në mes të qytetit
Duke soditur kohën e Heraklitit
Që rrjedh si uji.

25 korrik 2009

ENDERRIM

C'është kjo pamje e mjegullt
që u dhurohet syve të mi
në kete ditë të kaltër
dhe e zhbën përmasën e vërtetë të gjërave?
Oyteli i Ohrit shtrihet gjer tutje në lindje
I heshtur dhe mosperfillës
Si një galaktikë e largët.
Me kujtesën time imagjinare
shoh një hartë me gjurmë vijash,
të fshehura nga historia,
në kohë të tjera, në të tjera stinë.
Dikur ketu i thuej bukës buke,
dhe ujit ujë.

Ohër, 30 korrik 2009

→ Vijon nga faqja 19

përcaktimi i asaj që jemi."

Ja përse "nuk gjendet" në roman edhe konflikti i hapur tradicional ballë për ballë individëve e palëve. Atë lexuesi duhet ta gjejë e ta përjetojë brenda Bendoris, heroit "problematik" të romanit, por edhe në alternimin e episodëve të së shkuarës dhe episodëve të realitetit në të cilin zhvillohen ngjarjet.

Në esenë e tij "Ekzistencializmi është humanizëm", Sartri shkruan: "Gëzimi më i madh i njeriut është të ekzistojë për këdo, veçanërisht për një person ose për një grup njerëzish që në jetë mar-

"Nomeja e largët" i Faik Ballancës, një roman ekzistencialist

rin emrin familje."

Këtë ngjizet e zë filli edhe romani "Nomeja e largët" ose këtu gjendet "kodi" i natyrës së tij ekzistencialiste, pra kur Bendoja mendon natën e ditë të krijojë edhe ai një familje.

Në roman babai i Bardhës refuzon t'ia japë vajzën një njeriu të humbur dhe pa kujtesë njerëzore si Bendoja. Por Bendoris i është fiksuar në kokë martesë me Bardhën edhe pse ajo është e çalë. Me sa shihet, autori, F.Ballanca, nuk "shqetësohet" dhe aq për mungesën në romani të konfliktit të hapur e tradicional që kalon të

gjitha fazat e tij, sepse ai e njoh mirë mendimin e Sartrit të shprehur në esenë "Ekzistencializmi është humanizëm":

"Ti përgjigju për atë që të takon, ekzistoj jo për humanizëm, por për një arsye më të madhe se kaq, për të jetuar dhe për të përballuar atë përgjegjësi që të takon. E gjitha kjo është humanizmi të cilin ti ke për detyrë ta bësh, sepse çdokush e di se ti nuk do të dëshiroje këputjen e hallkave që ndodhen sipër teje. Ekzistenca e tyre mundëson dhe tënden. Ky është humanizmi yt, të ekzistosh për të bërë të mundur ekzistencën e

hallkave që ndodhen pas teje. Sigurohu të ekzistosh pra." (Po aty)

Ballanca shpërfaq një ndeshmëri të lartë artistike dhe ka djitur të mbajë një ekuilibër midis "mungesës" së konfliktit të hapur, pra planit dramatik dhe intensitetit lirik që e plotëson më së miri të parin, nëpërmjet përsiatjeve të personazheve të romanit, por edhe përshkrimeve të qëmtuara të peizazheve të natyrës, të cilat janë aq realiste saqë duket sikur i sheh me sytë e tu dhe i prek me dorë.

Në faqet e tij, ndihet një plazhim apo mënyrë të shkruari e cila ngërthen me mjeshtëri me

njëra tjetër episode tragjike tronditëse, që i japin atij një frymëmarrje të veçantë.

Mendoj se, edhe "shkrija" apo qendrimi i autorit pas kapitujve "Gjithmëseçili tregon një histori", dëshmon për linjën e formës ekzistencialiste të romanit.

Dhe, sikurse nënvizon Umberto Eco, në librin e vet *Si shkruaj*, vepra letrare "duhet të shkaktojë kënaqësi gjatë rrëfimit", lexuesi e pëlgen romanin "Nomeja e largët" edhe pse i duhet "të udhëtojë" nëpër faqet e tij, me ngadalë e kujdes, jo vetëm për shkak të sendërtimit të veçantë të tij, por edhe për shkak të mesazheve të fshehta filozofike me të cilat ai është ushqyer.

Opinioni / i Ditës

Revolucioni i ndritur ose zgjimi i madh kombëtar!

Nga Arian Galdini

(vijon nga faqja 1)

..., duke rikthyer foton e Ismail Qemalit në çdo zyrë të shtetit.

Jo se Ismail Qemali nuk e meriton, porse qëllimi i Edi Ramës ishte paradoksalisht meskin e kontraktor në të njëjtën kohë.

Njeriu që flet çdo ditë për shtetbërjen, u fsheh pas fotos së Ismail Qemalit, sepse nuk donte ta respektonte shtetin e tij, duke mosnderuar institucionin e Presidentit të Republikës, cilido të jetë ai.

Fshehja tek e shkuara apo krahasimi me të shkuarën është bërë simptoma më e dukshme e pafuqisë dhe padëshirës së udhëheqësve tanë politikë për t'u shkëputur e shëruar nga sëmundja e kompleksit të ditës së parë të shtetbërjes. Ata janë të sëmurë kronikë, të vetëinfektuar me vullnet të lirë dhe infektues të zellshëm të kujtdo rreth e pas tyre.

Nga ana tjetër, kur janë në opozitë, udhëheqësit tanë vuajnë nga kompleksi i revolucionit personal.

Pothuajse të gjitha opozitat, në këto 27 vitet e fundit, sapo kanë kuptuar që nuk kanë fituar zgjedhjet e nuk do të jenë në pushtet, ia kanë nisur të flasin për revolucion.

Cilido të ketë qenë lideri i radhës i opozitës, nuk i ka shpëtuar gjuhës fundbotëse dhe mesianike me thirrje për revolucion e përmbysje me çdo kusht të pushtetit diabolik, të cilit i ka ardhur dita marrjes në dorë të frenave të punëve të shtetit e qeverisjes.

Lideri i opozitës në Shqipëri duket si i magjepsur nga sprova për të pasur edhe ai revolucionin e tij.

Por që të prodhohet revolucion, duhet të shpalozet djallit.

Asnjë lider opozite në vendin tonë, kurrë, në asnjë rast, nuk ka zgjedhur rrugën e gjatë, rrugën që të çon e s' të kthen.

Të gjithë, pa asnjë përjashtim kanë zgjedhur rrugën e shkurtër.

Nuk shkojnë vetë të vrasin kuçedren, por sjellin djallin këtu.

Të zgjedhësh rrugën që të çon e s' të kthen, do të thotë të rëndësh kah sakrificë e vetëmohimi, për çka e beson të vlerë e të rëndësishme.

Në këtë rrugë nuk merr të tjerë me vete, por ti vendos veten tënde në dispozicion të të tjerëve. Nuk flet për djallin, por ushqen me mishin e pulpës tënde shqiptonjen që të mban në krahë ndërsa fluturon për të të çuar në përballjen me kuçedren.



Kurse ajo rruga që të çon e të kthen, është e thjeshtë fare.

Mjafton që ti të flasësh pafund për të keqen e t'u thuash njerëzve se mbretëria e djallit ka pllakosur.

Mbill depression, dëshpërim, dekurajim dhe shpresë që, kështu do të krijohet edhe ushtria e revolucionit tënd.

Me këtë reflektim, nuk po dua fare të them se Edi Rama nuk është djalli që ne opozita kemi shpallur. Jo aspak.

Edi Rama është një e keqe e pamëdyshtë që pushtetin e ka si vegël dëfrimi e pasurimi pa frerë. Edi Rama është Zoti i radhës në

krye të punëve të katrahurës.

Sot, me këtë reflektim, në fakt, nuk po merrem me Edi Ramën dhe Lulzim Bashën, si njerëz e udhëheqës konkretë.

Sot e kam reflektim, me veten time, për veten time, me shoqërinë tonë, për shoqërinë tonë, e për si ne e kuptojmë e përtejtojmë qeverisjen dhe opozitarizmin.

Dua të them, se kemi mbjellë kaq shumë depression e dekurajim në këtë vendin tonë me kaq shumë skandale e ligësi, të cilët burimin e kanë të kompleksi i pushtetarit si

shtetbërës dhe i opozitarit si revolucionar, sa që nuk po lëmë asnjë shans për t'u zhvilluar ndonjë bimë a oaz urtësie në këtë vend.

Të gjithë ne që shkruajmë, flasim e veprojmë, të gjithë ne që kemi zë, ndikim e përgjegjësi publike, të gjithë pa përjashtim, duke më përfshirë mua të parin, jemi bërë ose të dorëzuar ose të depresionuar.

Kur jemi dorëzuar, marrim anën e njërës prej palëve, ose qëndrojmë larg palëve, sepse kështu dhe vetëm kështu i bëjmë mirë vetes dhe botës sonë të vockël personale e familjare.

Kur jemi të depresionuar, nuk lëmë rast pa bërë garë se kush gjen fjalët e hiperbolat më hidhnaqe e koniciane, për të përshkruar çdo keqshkuarje e paudhësi në këtë vend.

Gara jonë e dorëzimit dhe depresionimit, janë bërë si holokausti i shpresës dhe besimit ndër ne, tek të gjithë ne.

A e keni vënë re se ne ndjekim, lexojmë, vlerësojmë, klikojmë, pëlqejmë kryesisht e madje dërmueshëm, dëfruesit e depresionuar ose mendjendriturit e dorëzuar.

Jemi aq cinikë e të ligësht me veten e njëri-tjetrit, sa që njerëzit e mirë, aktet e mira, shembujt e

mirë, lajmet e mira, i klasifikojmë si shtirje, hipokrizi ose si të parëndësishme ose të pavlera fare e të lehta.

E gjitha kjo ka ardhur si reaksion zinxhir, ngase udhëheqësit pushtetarë nën kompleksin e shtetbërjes dhe udhëheqësit opozitarë nën kompleksin e revolucionbërjes, e kanë helmuar në atë pikë këtë shoqëri, sa shpesh të duket e kotë të ndërrosh në këtë vend e për këtë vend. Udhëheqësit dhe matrica e tyre politike, sociale e kulturore kanë degraduar më pas edhe të gjitha hallkat e mendjendriturve, intelektualëve, profesionistëve, artistëve, gazetarëve, etj., etj., duke i katandisur këta, ose në të dorëzuar ose në të depresionuar.

Janë pothuajse të njëjtat gjëndra fëlligështie që përdoren prej 2 dekadash ndër ne, për të shpërthyer qelbin e çdo debati që na ka përfshirë e ndarë, duke filluar nga debatet e dasitë politike, deri tek ato fetare, kulturore, për dekonstruktimin e heronjve, personaliteteve, ngjarjeve e çështjeve tona kombëtare, apo mbi përkatësitë krahinore, e gjithfarë temash të kësollojshme.

Janë të njëjtët njerëz që paguhen tejet majmësisht për të shkalluar çdo pikë reference e çoroditur çdo mendje.

Kjo është edhe arsyeja pse doja t'i hidhja në eter këto përsiatje, sepse ne kemi kaq shumë nevojë për një revolucion të ndritur.

Jo revolucion pushteti, por revolucion mendjhapës, çlirues energjish pozitive.

Ky helm masiv, dorëzonjës e depresues, duhet mundur nga një zgjim i madh.

Një shpirt i ri i inkurajimit, mirësisë, vlerave dhe besimit duhet domosdoshmërisht të ngjizet, rritet e ngadhënjëjës mes nesh.

Asnjë pushtet shteti e asnjë opozitarizëm revolucionar, nuk mund ta mbjellë dot këtë frymë të inkurajimit.

Zgjim i madh mund ta sjellin vetëm guximtarët që dinë të maten me veten e tyre, me makthet e tyre më të këqija, e paskëtaj të shembullizojnë me fjalë, akte dhe vepra të mbara.

Më shumë sesa udhëheqës që mbajnë fjalime të bukura e që dinë të flasin zhdërvjellët, kësaj shoqërie e këtij kombi i duhen udhëheqës nëpërmjet shembullit të tyre personal.

Revolucioni i ndritur apo zgjimi i madh është e vetmja zgjidhje.

Përndryshe, helmi do të na mbyset, dorëzojë, depresionojë apo largojë.

BLUE TOOTH
TRASHETHEME MADE IN ALBANIA
te reja nga jeta ipave
GEE TË SHITURA FALAS ME

Dje në "Deutsche Welle"

Të arratisesh nga Katalonia

Nga Barbara Wesel

(vijon nga faqja 1)

... (siç e paraqitën në një shaka) në kryeqytetin e Belgjikës dhe të BE.

Të tjerë e shohin me shpiti Carles Puigdemont-in si hero përherë në arrati të serisë "Tim dhe Struppi", aq më tepër që tipari rinor dhe naiv i figurës për të qeshur përshtatet shumë mirë me katalanin.

Pas mbeten mbështetës të zhgënjyer, shokë të zemëruar të partisë dhe një ekonomi që ka humbur sigurinë. Dhe një rajon i qeverisur përkohësisht që nga Madridi, i cili megjithatë sillet dukshëm në mënyrë pragmatike me "sundimin e huaj". Ndoshta Carles Puigdemont e mbivlerësoi potencialin e nxitjes së bashkatdhetarëve të tij, që marrin lehtë flakë. Të demonstrosh kur është mot i mirë është zbatimëse, por që të sakrifikosh mirëqenien dhe një vend pune për një ëndërr nacionaliste, kur jeton rehat dhe mjaft autonom në Spanjë, kjo tingëllon qesharake vetëm ta shkruash.

Kryekatalani sidoqoftë duhet ta kishte ditur që bindjet e mëdha kërkojnë edhe gjeste të mëdha nga udhëheqësit. Sido që të jetë, pjesë e tyre do të ishte vajta me kokë lart para gjyqit, duke kënduar këngë katalanase të lirisë. Ajo që lë përshytyje shumë të keqe, është që t'i lësh ministrat e tu të mbajnë përgjegjësi dhe vetë t'ia mbatsh natën.

TEATËR POLITIK

Krahasimet që Carles Puigdemont bën me diktaturën e Francos mund t'i quash thjesht qesharake



ose të paturpshme, varësisht nga pozicioni. Thirrja e vazhdueshme për demokraci tingëllon bosh, kur udhëheqësit vetë i shkelin rregullat e saj.

Në Rusi, në Turqi dhe diku tjetër njerëzit ndodhen në burg për hir të politikës ose të profesionit që kanë. Përballë këtyre fateve, të vjen rëndë kur shikon kopshtin e femijëve të politikanëve në Katalonjë.

Këta luftëtarë heroikë për pavarësi duket se thërrasin gjithmonë: "Na pëlqen shumë që të jemi të shpëtyrur!"

PA VEND NË EVROPË

Për të ardhur rëndë është edhe se si u tregon ai mbështetësve të tij gjithmonë përrallën e ndihmës europiane, pa qenë në gjendje për të ofruar rezultate. Sepse as BE, as Belgjika si vend jovullnetar

mikpritës nuk duan t'i japin dorën një udhëheqësi secesionist. Katalanin ata e kanë pritur kaq me padurim sa presin shpërthimin e murtajës ose të kolerës. Po të kenë fat belgët, drejtësia nuk e kundërshton dorëzimin e Carles Puigdemont-it. Kështu ndoshta mund të frenohen edhe dëshirat për shkëputje të flamandët e vet.

HOROSKOPI

DASHI

Hëna bëhet mike gjatë mëngjesit të sotëm. Edhe Merkuri, nga sot në shenjë të Zjarrit, do ju mbështesë në aktivitetet tuaja. Më në fund një e diel për çlodhje totale. Kaloni kohë me kë të doni, do ishte mirë nëse do udhëtoni.

DEMI

Pak të lodhur tani që edhe Hëna nuk është më në shenjë tuaj. Për fat të mirë Merkuri tërhiqet nga shenja e kundërt dhe nuk ju shqetëson më. Punët e shtëpisë ose shumë gjëra për të përfunduar ju frenojnë pak në argëtimin e të dielës.

BINJAKET

Të përkëdhelur nga Hëna që nga mëngjesi i sotëm hyn në shenjë tuaj. Sa keq që Merkuri sot kalon kundër, kini kujdes komunikimin me të tjerët. Nëse partneri ju kërkon një sqarim, është momenti që t'ia bëni qejfin dhe të fokusoheni në idealet e përbashkëta.

GAFORJA

Hëna tashmë në shenjë do ju ndihmojë të shprehni emocionet e forta. Jeni pak në ankth pa e kuptuar arsyen, në kërkim të kompensimit të ëmbël dhe me kalorë. Bëni mirë t'i përkushtoheni aktiviteteve çlodhëse që do ju rikthejnë gjallërinë e munguar.

LUANI

E diel e bukur, ideale për t'u shkëputur nga rutina e përditshme, ndoshta një shëtitje në mal do ishte aktiviteti i duhur. Merkuri nga sot në trekëndësh ju tregon rrugën e duhur. I jashtëzakonshëm shpirti i iniciativës, idetë e reja nuk ju mungojnë.

VIrgJERESHA

Hënë e lodhshme, dhe sikur të mos mjaftonte kjo, edhe Merkuri mbështetës nga sot lëviz nga shenja tuaj. Kritika dhe atmosferë e tensionuar në familje. Organizimi juaj metodik nuk shkon me të bërituratur dhe debatet e shumta.

PESHORJA

Merkuri nga sot është në shenjë tuaj bashkë me Hënë në trekëndësh. Dashuria, flirtet dhe miqësia ju japin nxitjen e duhur. Jeni gatë për një ekskurSION me një grup të ngushtë miqsh, do zbatimeni shumë së bashku!

AKREPI

Nuk jeni në humor, sidomos këtë të diel. Do humbini miqësinë e Merkurit që kalon në shenjë pasardhëse dhe Hëna ju ngadalëson rutinën. Frymëzime të reja do ju lindin nga zemra, janë efekti i emocioneve të fshehura.

SHIGJETARI

Një lajm i mirë për ju që dashuronit udhëtimet dhe jetën shoqërore, pikërisht sot Merkuri kalon në shenjë tuaj, me premtimin e mundësive të reja. Hëna ndërkohë lëviz në drejtimin e kundërt, kështu që të paktën për sot, emocionet do caktojnë rregullat.

BRICJAPI

Hëna flet qartë, angazhimet dhe shëndeti do jenë argumentet e ditës, sidomos nëse dikush në shtëpi ju kërkon ndihmë. Keni shumë pak hapësirë për argëtim këtë të diel, por të qenit i dobishëm për të tjerët do t'ju bëjë të ndjeheni mirë.

UJORI

Ndjeheni optimist këtë të diel. Nëse keni partner dhe është i duhuri, mbajeni afër duke lënë mënjënjë grindjet e zakonshme. Larg rutinës së përditshme do ndjeheni të rilindur, duke zbuluar anën më autentike dhe më entuziaste të zemrës suaj.

PESHQIT

Sot Merkuri kalon në kuadraturë duke ju ngjallur dëshirën për udhëtime, edhe pse për momentin nuk keni asnjë mundësi. As Hëna nuk ju ndihmon, në familje tendenca juaj për të shpëtuar nga problemet do kritikohet shumë.


AGJENCIA E LAJMEVE MË E KLIKUAR NË HAPËSIRËN SHQIPTARE. LAJMET MË TË FUNDIT ME VIDEO DHE FOTO NGA VENDNGJARJA. ANALIZA DHE TEMATIKA TË NDRYSHME, GJITHÇKA ME NJË KLIKIM.

MERRNI NE KOHE REALE LAJMET E FUNDIT NE APARATIN TUAJ

INSTALONI APLIKACIONIN E BALKANWEB NE MOBILE DHE TABLET

KERKONI NE APPLE STORE DHE GOOGLE PLAY OSE DUKE SKANUAR QR CODE APPLE DHE ANDROID

Fjalëkryqi (1)



HORIZONTAL

1. Salacrou dramaturg
6. Blair e Ekzorcisti.
9. I bylbylit ai i Mjedës.
10. Inicialet e Morricones
12. Gjysmë vektor.
13. Një port përballë Xhibutit.
14. Në mes të Salt dhe City.
16. Janë stacionet e beduinëve.
19. Një pjesë e taktikës.
20. Janë tifoze partie.
22. Janë firmat mashtruese.
23. Përpunojnë naftë.
27. Janë konservatorë.
28. Është derri.
30. Një monedhë maqedonase.
31. Kufizojnë ambiente.
33. Inicialet e Gould aktor.
34. Fillojnë jetën.
36. Janë dëshmorët.

39. U shkrua nga Garcia Lorca.
44. Janë baballarët.
45. Tregon çmimin dhe modelin.
47. Është ujëvara.
48. Një mund të jetë mbi xhiro.

VERTIKAL

1. Film i James Cameron.
2. Jeronim de i Milosaos.
3. Është doktori me bluzë të bardhë.
4. Agjenci Informacioni Ndërkombëtare.
5. Janë si jerm.
6. Fillojnë lejen.
7. Klikohet me mouse
8. Një vegël.
11. Luftohet me kinina.
12. Janë cilësi.
15. Janë reaksionet në epruveta
17. Një sportist që kërcën me shkop.
18. Janë tek në zhele
20. Është kullë zhamie.
21. Bëhet një për zakon.
22. Gruaja e Fantozzi-t
24. Gjysmë afërsi.
25. Janë ndriçues.
26. Nuk duhet shkelur një i tillë.
29. U shkel për herë të oarë nga Neil Armstrong.
30. Një fjalë për gjoja.
32. Garbo e kinemasë.
35. Braktisi Didonën.
36. Me të bëjnë një thikë.
37. Mund të jetë gjaku.
38. Janë dhoma.
40. Ai dhe ajo.
41. Ushtria republikane irlandeze.
42. Agjenci Transporti Korçë.
43. Me stpon në box.
46. Inicialet e Moravia-s.


Fjalëkryqi (2)

HORIZONTAL


1. Ishte babai i parë.
6. I ndërmarrim progresistët.
14. Thyhet një me kohën më të mirë.
16. U braktis nga Helena.
17. Seritë pa zë.
18. Kryeqyteti i Kinës.
20. Ramazotti këngëtar.
26. Janë sherre në shtyp.
27. Inicialet e Clapton.
28. Është shuma e brinjëve të drejtëndëshit.
30. Një letrar është tregimi.
32. Fillojnë nazet.
33. Matet pa kufij.
36. Inicialet e Kokoschka piktor
37. Kufiojnë mendimet.
38. Bergman që qe aktore.
40. Është shpërbilimi në para.

VERTIKAL


44. Është i keq.
45. Mund të kthehet në mllaf.
46. Një pije piratësh.
48. Janë në fazë.
49. Fillojnë lejen.
50. U shkrua nga Theodore Dreiser.
53. Një... italiane.
54. Një verë në Paris.
55. Janë vende ku prehehen martirë.
56. Italia në Internet
1. Wenger trainer.
2. Stefan i interpretuar nga Horst Tappert
3. Një është edhe Bujar Lako
4. Fillojnë mobilizimin.
5. Institucione Rajonale Polake.
7. Një rapper i famshëm.
8. Kështu thirret Ronaldo, bomber i brazilian
9. Ndezur në aparatë.
10. Një film i ribërë.
11. Ekstre në model.
12. Dy asa.
13. Është fytyra kamionit.
15. Mund të bëhet me medalje trimërie.
19. Mund të jenë të rastit.
22. E ka simbolin T.
23. Është dëm, qeder.
24. Inicialet e Tappert.
26. Një pjesë e pejsazhit.
28. Ndahet në barazim.
29. Janë kandilë deti
31. Hayëorth që qe aktore
34. Është enë për të skuqur.
35. Emri i Zoia.
39. Gjysma e globit.
41. Janë në skaje.
42. Kryqyteti i Letonisë.
43. Eva... Isabel Allende-s
47. Një stacion i famshëm orbital
51. Inicialet e Lennon.
52. Diftong në duet.



Gjeni ndryshimin



Dy figurat kanë ndryshime nga njëra-tjetra



Përgjigja, ja cilat janë ndryshimet e figurave

SUDOKU

		4	6			5	3		
		6				2	7		
	8		1	2					
			7				9		
9	3						5	6	
	4				6				
				6	2		1		
1	9					6			
2	3				7	9			

Plotësoni vendet bosh në mënyrë që çdo kolonë të ketë numrat nga 1-9

Përgjigje e sudokut të numrit të kaluar

5	7	6	4	8	9	1	3	2	
9	1	2	3	6	5	8	4	7	
3	8	4	2	7	1	9	6	5	
4	6	9	8	2	7	5	1	3	
2	3	8	5	1	6	7	9	4	
1	5	7	9	4	3	6	2	8	
7	2	5	6	9	4	3	8	1	
6	4	3	1	5	8	2	7	9	
8	9	1	7	3	2	4	5	6	

Argëtim filozofik

- "Lumturia nuk gjendet tek lumturia në vetvete, por tek ndjekja e saj. Lumturia nuk është një stacion tek i cili do të arrih. Lumturia është udhëtimi".
Fyodor Dostoevsky

- "Të fuqishëm nuk janë ata që gjithmonë fitojnë, por ata që pavarësisht se sa herë dështojnë, kurrë nuk reshin së përpjekuri".
Liam Pryne

KRIPTOSKEME

KRIPTOSKEME
Përgjigja e numrit të djeshëm

H	A	C	I	S	T	P	A	3	11	11	15	9	14	3
2	8	2	9	2	6	15	9	2				17	11	
6		6	5	8	2	6		8	2	8	2	14		
	11	4	12	2	7		6	2	11	2		3		
8	2	9	4	6	3		6	9	15	9	3			
	9	8		3	2	12		4	7	3	2	14		
4	6	2	6		4		6	3	14	17				
8	5	13	19		4	9	3		3	15	6			
3	7		6	19	12	3		4	12		11	4		
6	3	9	2	13	4	6		9	3	12	2	6		
4	13		6	3	6	2	13	3	11	4		4		
6	2	15			4	9		11	15	9	2	6		

D	E	N	A	N	C	U	E	S	I	T	C			
O	D	A	T	H					T	R	U	P		
G														
K	A	M	E	R	I	E	R	E	T	U				
K	O	R	I	B	A	N	T	E	T	S	R			
C	M	Z	A	N	O	R			I	T	A			
O	L	A	G	A					O	N	B			
S	D	O							T	E	N	D	A	
T	I	N	K	A					I	A	R	I	A	N
U	N	R	E	D	I	P	I	L	O					
H	A	P	A	T	A	L	I	N	E	R				
I	S	P	O	T	G	A	Z	E	T	E				

PËRGJIGJET E FJALËKRYQVE TË NUMRIT TË KALUAR

FJALËKRYQI (1)

A	R	K	S	I	K	E	N	D	E	T					
T	R	U	P		N	M	K		Q	E	N	I			
A		P	A	R	T	I	A	K	E		E	M			
A		M	A	R	C	E	L	P	R	O	U	S	T		
A		J	A	D	R	I	E	N		R	U	B			
		R	E	A	L		M	O	L		P	I	P	P	O
		G	R	E	M	I	N	E		T	A	P	A	T	
		D	U	E	L		L	E	T		I	H	E	R	A
		E	L	H	A	R		K	A	H	M	A	N		
		S	A	A	D	I		T	E	N	D	E	R	K	I
		I		E	R	A		T	A	P	A	P	A		

FJALËKRYQI (2)

M	I	Z	A	T		E	K	I	P	E	T			
P	A	R	I	M	E	T		A	M	I	T	A		
A	M	I	N		T	E	M	A	I	K	E			
K	I	S		K	O	M	U	N	I	T	A	R	E	
E	A		P	A	R	A	L	E	L	I	E	P		
T		D	A	N		A	T	M	E		I			
A	K	O	M	A		S	T	A	F	E	T	A	T	
T	A	M	I	L		P	I	R	A	T	I	E	T	
P	A	R	E	T	I	E	T		L	E	T			
G	O	T		T	I	N	A		A	D	E	T	I	
K	E	S		P	A		P	L	A	N	T	I		
A	N	T	I	P	A	T	I	K	E		T	K	E	

Thënie të mençura

- Vdekja do jetë shumë e bukur nëse di të komunikosh me të. Është një shpërbërje, bie prapë në burimin e qënies për tu glodhur e për tu rinovuar. Do të thotë, të zhdukesh në burimin e ekzistencës dhe të bashkohesh me Zotin – dhe mund të rilindësh prapë, deri sa të bëhesh i Zgjuar.
- Është më mirë t'i meritoni nderet dhe të mos i gëzoni ato, se sa t'i gëzoni dhe të mos i meritoni. (Mark Tueni)
- Bota është një anije mbi të cilën jemi të gjithë pasagjerë: nuk duhet të lejojmë që ajo të mbytet. (Mikhail Gorbacov)

www.gsh.al www.gsh.al www.gsh.al www.gsh.al www.gsh.al www.gsh.al

GAZETA SHQIPTARE

GSH.AL

- Na merrni!
- Na shkruani!
- Na lexoni!

GSH

www.gsh.al

GAZETA SHQIPTARE

Publika si profesori dhe bashkëpunuesit si tërësi

KRIZA POLITIKE, SOT TAKIMI RAMA-BASHA

Kreut i PD, 4 orë mbledhje me deputetët, diskutim me Majlinda Bregu dhe Josefina Topollin. Pasat, thirrje për zgjedhje kompetencave. Kancelari

Agron Duka: Ju rrëfej darkën në Mullët me Fatos Nanon

Flet kreut të PD-së. Pse në takime me mikun të shokëzimit, diskutim...

Sherri për katërbë, Rosa Lali: Do t'i jap kastrovece Rezart Veselshijai

"Portokallëse" ndahet nga e fejuara

Tashmë edhe lundroni!

